

20222363426

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

L I G J I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE (*)

Pjesa e pare

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e Ligjit

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen të drejtat dhe detyrimet e konsumatorëve dhe të tregtarëve në marrëdhëniet konsumatore, mënyrat dhe procedurat e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve, avancimin e njohurive të konsumatorëve për të drejtat e tyre dhe mënyrat dhe procedurat e mbrojtjes së tyre, të drejtat dhe detyrimet e shoqatave dhe lidhjeve, fushëveprimi i të cilave është realizimi i qëllimeve të mbrojtjes së

të drejtave të konsumatorëve, të drejtat dhe detyrimet e organeve kompetente, trupave dhe bartësve të tjerë të mbrojtjes së drejtave të konsumatorëve, si dhe çështje të tjera me rëndësi për pozitën dhe mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

Të drejtat e konsumatorëve

Neni 2

(1) Konsumatorët i kanë të drejtat vijuese:

1) e drejta e përmbushjes së nevojave themelore, që paraqet qasje ndaj mallrave dhe shërbime themelore dhe të domosdoshme, si ushqim, veshje, mbathje, banim, mbrojtje shëndetësore, arsim dhe higjienë;

* Me këtë ligj kryhet harmonizimi me:

- 1) Direktivën e Këshillit 85/374/EEC të 25 korrikut 1985 mbi përafrimin e ligjeve dhe rregulloreve të tjera të Shteteve Anëtare mbi përgjegjësinë për produktet me defekt (CELEX Nr. 31985L0374);
- 2) Direktivën e Këshillit 93/13/EEC të 5 Prillit 1993 mbi kushtet e padrejta në kontratat e konsumatorëve (CELEX Nr. 31993L0013);
- 3) Direktivat 98/6/EC të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 16 shkurtit 1998 për mbrojtjen e konsumatorëve në shënimin e çmimeve të mallrave që u ofrohen konsumatorëve (CELEX nr. 31998L0006);
- 4) Direktivën 1999/34/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 10 majit 1999 që ndryshon dhe plotëson Direktivën e Këshillit 85/374/KEE të datës 25 korrik 1985 për përafrimin e ligjeve dhe rregulloreve të tjera të shteteve anëtare për përgjegjësia për produktet me defekt (CELEX Nr. 31999L0034);
- 5) Direktivën 2005/29/KE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 majit 2005 mbi praktikata e padrejta tregtare nga subjektet e biznesit ndaj konsumatorëve në tregun e brendshëm dhe që ndryshon Direktivën 84/450/KEE të Këshillit, Direktivat 97/7/KE, 98/27/KE dhe 2002/65/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregulloren (KE) nr. 2006/2004 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (CELEX Nr. 32005L0029);
- 6) Direktivën 2006/123/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 12 dhjetorit 2006 për shërbimet në tregun e brendshëm (CELEX Nr. 32006L0123);
- 7) Direktivën 2008/122/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 14 janarit 2009 për mbrojtjen e konsumatorëve në lidhje me disa aspekte të kontratave për përdorimin me kohë të pasurive të paluajtshme, për produktet e pushimeve afatgjata, për rishitje dhe këmbim (CELEX) Nr. 32008L0122);
- 8) Direktivën 2009/22/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 23 prillit 2009 për urdhrat për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve (CELEX nr. 32009L0022);
- 9) Direktivën 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 tetorit 2011 për të drejtat e konsumatorit që ndryshon Direktivën 93/13/KEE të Këshillit dhe Direktivën 1999/44/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit dhe shfuqizon Direktivën e Këshillit 85/577/KEE dhe Direktivën 97/7/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (CELEX nr. 32011L0083);
- 10) Rregullativën (BE) nr. 910/2014 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 23 korrikut 2014 për identifikimin elektronik dhe shërbimet konfidenciale për transakcionet elektronike në tregun e brendshëm dhe shfuqizimin e Direktivës 1999/93/EC (CELEX nr. 32014R0910);
- 11) Direktivën 2015/2302 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 25 nëntorit 2015 për paketat e udhëtimit dhe aranzhimet e lidhura me udhëtimin, që ndryshon Rregullativën (KE) nr. 2006/2004 dhe Direktivën 2011/83/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe shfuqizimin e Direktivës së Këshillit 90/314/EEC të Këshillit (CELEX Nr. 32015L2302);
- 12) Direktivën (BE) 2019/770 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 20 majit 2019 për disa aspekte që lidhen me kontratat për furnizimin me përmbajtje dixhitale dhe shërbime dixhitale (CELEX Nr. 32019L0770);
- 13) Direktivën (BE) 2019/771 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 20 majit 2019 mbi disa aspekte në lidhje me kontratat për shitjen e mallrave që ndryshon Direktivën 2009/22/EC dhe shfuqizon Direktivën 1999/44/KE (CELEX Nr. 32019L0771) dhe
- 14) Direktivën (BE) 2019/2161 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të 27 nëntorit 2019 që ndryshon dhe plotëson Direktivën e Këshillit 93/13/EEC dhe Direktivat 98/6/EC, 2005/29/EC dhe 2011/83 / BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit në lidhje me zbatimin më të mirë të mbrojtjes dhe modernizimit të rregullave të Bashkimit për mbrojtjen e konsumatorëve (CELEX Nr. 32019L2161).

2) e drejta e sigurisë, që paraqet mbrojtje të mallrave dhe shërbimeve që janë të dëmshme për jetën, shëndetin, pasurinë ose mjedisin jetësor, si dhe nga mallrat posedimi ose përdorimi i të cilave janë të ndaluara;

3) e drejta e informimit, që paraqet të kesh në dispozicion të dhëna dhe informacioneve të sakta që janë të domosdoshme për zgjedhjen e arsyeshme të mallrave dhe shërbimeve të ofruara, respektivisht për miratimin e vendimit të informuar;

4) e drejta e zgjedhjes, që paraqet mundësi për të përzgjedhur ndërmjet më shumë mallrave dhe shërbimeve sipas çmimeve të pranueshme dhe me cilësi përkatëse;

5) e drejta e pjesëmarrjes, që paraqet përfaqësim të interesave të konsumatorëve në proceset e miratimit dhe zbatimit të politikave për mbrojtjen e konsumatorëve, si dhe mundësi të përfaqësimit në proceset e miratimit dhe zbatimit të politikave për mbrojtjen e konsumatorëve përmes shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve;

6) e drejta e mbrojtjes juridike, që paraqet mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në përputhje me procedurën e parashikuar me ligje në rast të shkeljes së të drejtave të tij, duke përfshirë edhe kompensimin e dëmit që i është shkaktuar konsumatorit;

7) e drejta e edukimit, që paraqet përvetësim të njohurive dhe shkathtësive themelore të domosdoshme për përzgjedhje të drejtë dhe të sigurt të mallrave dhe shërbimeve, si dhe njohurive për të drejtat dhe detyrimet themelore të konsumatorëve dhe mënyrat e realizimit të tyre dhe

8) e drejta e mjedisit të shëndoshë dhe të qëndrueshëm që paraqet jetë dhe punë në mjedis që nuk është i dëmshëm për jetën, shëndetin dhe mirëqenien e gjeneratave të tanishme dhe të ardhshme, si dhe e informimit me kohë dhe të plotë për gjendjen e mjedisit jetësor.

(2) Konsumatori nuk mund të heqë dorë nga të drejtat e tij të përcaktuara me këtë ligj.

(3) Gjatë zbatimit të dispozitave të këtij ligji duhet doemos të merret parasysh pozita e konsumatorit si palë më e dobët ekonomike, e veçanërisht pozita e konsumatorëve të rrezikuar.

Përkufizime

Neni 3

Terme dhe shprehje të caktuara të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin vijues:

1) "**Ambalazhi**" është mbështjellës i jashtëm i mallit me të cilin i njëjti mbrohet nga ndikime të caktuara të jashtme gjatë transportit, vendosjes në treg, ofrimit në shitje ose shitjes (si p.sh. i kthyeshëm ose i pakthyeshëm, "eko-", degraduese dhe/ose jodegraduese etj.)

2) "**Fletë e garancisë**" është deklaratë tregtare e garancisë nga tregtari ose prodhuesi, në të cilën janë përfshirë detyrimet dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë tregtari dhe prodhuesi, të dy si garantues ndaj konsumatorit;

3) "**Hapësirat afariste**" janë hapësira të patundshme për shitje me pakicë ku tregtari ushtron veprimtarinë e vet në bazë të vazhdueshme, si dhe hapësira të tundshme për shitje me pakicë ku tregtari ushtron veprimtarinë e vet në bazë të zakonshme, ndërsa janë: dyqanet, standet, kamionët, pa marrë parasysh nëse veprimtaria ushtrohet në mënyrë sezonale, si dhe standet e tregjeve dhe panairove, etj.

4) "**Përmbajtja digjitale**" me të dhënat që janë prodhuar dhe realizuar në formë digjitale;

5) "**Shërbimi digjital**" është:

a) shërbim që i mundëson konsumatorit të krijojë, përpunojë, magazinojë ose t'u qaset të dhënave në formë digjitale ose

b) shërbim që mundëson shpërndarjen ose çfarëdo ndërveprimi tjetër me të dhën në formë digjitale, të vendosura ose krijuara nga konsumatori ose shfrytëzues të tjerë të atij shërbimi;

6) "**Mjedis digjital**" është hardueri, softueri dhe çfarëdo qoftë lidhje e rrjetit që e shfrytëzon konsumatori për qasje ose përdorim të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital;

7) **"Kontrata jashtë hapësirave afariste të tregtarit"** është kontrata mes konsumatorit dhe tregtarit:

a) e lidhur me praninë e njëkohshme fizike të tregtarit dhe konsumatorit në vend që nuk është hapësirë afariste e tregtarit;

b) për të cilën oferta për lidhjen e saj bëhet nga konsumatori me prani të njëkohshme fizike të tregtarit dhe konsumatorit në vend që nuk është hapësirë afariste e tregtarit;

c) e lidhur në hapësirat afariste të tregtarit ose përmes mjetit për komunikim në distancë, e menjëherë pas qasjes personale dhe individuale drejt konsumatorit në vend që nuk është hapësirë afariste e tregtarit me praninë e njëkohshme fizike të tregtarit dhe konsumatorit ose;

ç) e lidhur gjatë ekskursionit të organizuar nga tregtari me qëllim ose veprim të promocionit ose shitjes së mallrave ose shërbimeve të konsumatorit;

8) **"Kontrata për shitje"** është kontrata me të cilën tregtari i kalon ose zotohet t'ia kalojë konsumatorit të drejtën e pronësisë ndaj mallrave të caktuara, e konsumatori paguan ose detyrohet të paguajë çmim të caktuar për këtë, duke përfshirë edhe kontratën që ka të bëjë edhe me mallrat edhe me shërbimet;

9) **"Kontrata për shërbime"** është kontrata që tregtari ia jep ose zotohet t'ia ofrojë konsumatorit një shërbim të caktuar, e për këtë konsumatori i paguan ose detyrohet t'i paguajë çmim (kompensim) të caktuar, përveç kontratës për shitje;

10) **"Kontrata në distancë"** është kontrata e lidhur ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit në kuadër të shitjes së organizuar në distancë ose të sistemit për ofrimin e shërbimeve, pa praninë e njëkohshme fizike të tregtarit dhe konsumatorit, me përdorimin ekskluziv të një ose më shumë mjeteve të komunikimit në distancë, e deri në kohën e lidhjes së kontratës dhe duke përfshirë edhe kohën e lidhjes së kontratës;

11) **"Kontrata për shfrytëzim me afat të paluajtshmërisë"**, sipas këtij ligji është kontrata e vlefshme për më shumë se një vit me të cilën tregtari detyrohet t'i sigurojë konsumatorit të drejtën e shfrytëzimit të një ose më shumë bujtive për akomodim, ndërsa konsumatori është i detyruar për këtë t'i japë kompensim tregtarit;

12) **"Kontrata për produktin afatgjatë për pushim"**, sipas këtij ligji është kontrata me vlefshmëri prej më shumë se një vit me të cilën tregtari detyrohet t'i sigurojë konsumatorit kryesisht të drejtën e zbritjeve ose përfitimeve të tjera në aspektin e akomodimit, veçmas ose së bashku me shërbimet e udhëtimit ose shërbimet tjera, e konsumatori detyrohet t'i jap kompensim për këtë tregtarit;

13) **"Kontrata e rishitjes"**, sipas këtij ligji është kontrata me të cilën tregtari detyrohet t'i ofrojë ndihmë konsumatorit gjatë blerjes ose shitjes së përdorimit me afat të paluajtshmërisë ose produktit afatgjatë për pushim, e konsumatori është i detyruar t'i jap kompensim për këtë tregtarit;

14) **"Kontrata e shkëmbimit"**, në përputhje me këtë ligji është kontrata me të cilën tregtari detyrohet t'i sigurojë konsumatorit përfshirjen në sistem (skemë) shkëmbimi në kuadër të të cilit konsumatorit i mundësohet qasje në bujtinë ose shërbime të tjera si zëvendësim i mundësimit të gëzimit të përkohshëm të së drejtave që për konsumatorin rezultojnë nga kontrata për përdorim me afat të paluajtshmërisë me subjekte të tjera, e konsumatori është i detyruar t'i jap kompensim për këtë tregtarit;

15) **"Çmimi për njësi"** është çmimi për një kilogram, për një litër, për një metër, për një metër katror ose një metër kub mall, si dhe njësi tjetër sasive që përdoret përgjithësisht dhe zakonisht në shtet gjatë vendosjes së mallrave të caktuara në treg, duke përfshirë edhe tatimin e vlerës së shtuar dhe të gjitha taksat tjera publike;

16) **"Çmimi i përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital"** janë para ose paraqitje digjitale e vlerës që është borxh si zëvendësim të furnizimit me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital;

17) **"Ofertë e përbashkët"** është oferta që jepet kur furnizimi i mallrave ose shërbimeve është i varur ose lidhet me furnizimin e ndonjë malli dhe/ose shërbimi tjetër;

18) **"Çrregullim i rëndësishëm i sjelljes në treg të konsumatorit mesatar"** është përdorimi i praktikës tregtare me qëllim që të pengojë ndjeshëm aftësinë e konsumatorit për të marrë vendim të informuar, duke bërë që konsumatori të marrë vendim tregu që përndryshe nuk do ta merrte;

19) **"Integritim"** është lidhja dhe përfshirja e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital me komponentët e mjedisit digjital të konsumatorit, me qëllim që përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital të përdoren në përputhje me kërkesat e konformitetit në përputhje me këtë ligj;

20) **"Interoperabilitet"** është aftësi e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital për të funksionuar me harduer ose softuer të ndryshëm nga ai në të cilin zakonisht përdoren përmbajtja digjitale ose shërbimet digjitale të llojit të njëjtë;

21) **"Ankand publik"** është mënyra e shitjes ku tregtari ua ofron mallrat ose shërbimet konsumatorëve që janë të pranishëm ose kanë mundësinë e prezencës personale në të, e përmes ofertës transparente dhe konkurruese që e udhëheqë drejtuesi i ankandit, me ç'rast ofertuesi i suksesshëm është i detyruar të blejë mallrat ose shërbimet;

22) **"Shërbime publike"** janë shërbimet që lidhen me furnizimin me ujë, energji elektrike, gaz dhe ngrohje qendrore përmes rrjetit përkatës të shpërndarjes, furnizimi me gaz gjatë shërbimit publik dhe me energji elektrike gjatë shërbimit universal, ofrimi i shërbimeve publike elektronike të komunikimit duke përfshirë edhe shërbimin universal, shërbimet e trajtimit të ujërave të zeza, shërbimet e menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjen e pastërtisë publike, shërbimet e pastrimit të oxhaqeve, shërbimet postare, shërbimet e transportit të udhëtarëve në transportin publik, shërbimet e parkimit në parkingjet publike, shërbimet e menaxhimit të objekteve ndërtimore nga drejtori, si dhe shërbime të tjera me karakter ekonomik të përcaktuara me rregullore si shërbime publike, përkatësisht si shërbime me interes publik;

23) **"Kodi i sjelljes"** është kontratë ose përmbledhje e rregullave që nuk janë të imponuara me një rregull dhe me të cilat rregullohet sjellja e tregtarëve që kanë rënë dakord të jenë të detyruar me Kodin në raport me një ose më shumë praktika të veçanta tregtare ose sektorë afaristë;

24) **"Interesat kolektive dhe të drejtat e konsumatorëve"** janë interesat dhe të drejtat e konsumatorëve, që paraqesin përmbledhje të thjeshtë të interesave individuale dhe të drejtave të personave interesat dhe të drejtat e të cilëve janë shkelur (të ashtuquajturat interesa dhe të drejta grupe);

25) **"Konformiteti"** është aftësi e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital për të funksionuar me harduer ose softuer me të cilat zakonisht përdoren përmbajtjet digjitale ose shërbimet digjitale të llojit të njëjtë, pa pasur nevojë për konvertimin digjital ose shërbimin digjital;

26) **"Të dhënat personale"** janë të dhëna personale të përkufizuara në rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale;

27) **"Hapësira e shitjeve onlajn"** është shërbim që shfrytëzon softuer, duke përfshirë edhe ueb faqen ose një pjesë të ueb faqes ose aplikacionit, të drejtuar nga tregtari ose një person i përcaktuar prej tij, i cili u mundëson konsumatorëve të lidhin kontrata në distancë me tregtarë ose konsumatorë të tjerë;

28) **"Organet e mbikëqyrjes së tregut"** janë Inspektorati Shtetëror i Tregut, Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor, Inspektorati Shtetëror i Punës, Inspektorati Shtetëror për Inspektimin Teknik, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor dhe organe të tjera të administratës shtetërore ose inspektorë që ushtrojnë mbikëqyrje të tregut në përputhje me ligjin, si dhe organe dhe organizata të tjera dhe trupa të pavarura rregullatore që ushtrojnë mbikëqyrje të tregut;

29) "**Organizator i hapësirës së shitjes onlajn**" është tregtari që u siguron konsumatorëve hapësirë për shitje onlajn;

30) "**Bartësi i kodit të sjelljes**" nënkupton subjekt ose organ, duke përfshirë tregtarin ose grup tregtarësh, që është përgjegjës për përpilimin dhe revidimin e kodit të sjelljes dhe/ose për ndjekjen e respektimit të kodit nga ata që kanë rënë dakord të jenë të detyruar me kodin;

31) "**Trupat e autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve**" janë shoqata, fondacione, institucione ose organizata të tjera që janë themeluar në përputhje me ligjin, të cilat në kuadër të veprimtarisë së tyre të regjistruar merren me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe kanë autorizim për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve në përputhje me këtë ligj, me ç'rast mund të iniciojnë procedurë për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve kundër personit fizik ose juridik, që me ushtrimin e një veprimtarie të caktuar ose në përgjithësi me veprimin ose lëshimin i shkel më rëndë ose i rrezikon seriozisht interesat dhe të drejtat kolektive të konsumatorëve;

32) "**Vendim tregu**" është vendimi i marrë nga konsumatori për atë nëse, si dhe në çfarë kushtesh do ta blejë mallin, nëse do të paguajë çmimin për të njëjtin plotësisht apo pjesërisht, nëse do ta mbajë mallin apo të njëjtin do ta ketë në dispozicion, nëse do të ushtrojë të drejtë të caktuar kontraktuale në raport me mallin, si dhe nëse do të vendosë të veprojë apo do të përmbahet nga ndërmarrja e veprimeve përkatëse;

33) "**Thirrje për blerje**" është njoftimi tregtar në të cilin janë përmendur shenjat e mallit dhe çmimit, në mënyrën që është e përshtatshme me mjetet e përdorura për reklamimin tregtar dhe si rrjedhojë konsumatorit i mundësohet të bëjë blerje;

34) "**Konsumator**" është çdo person fizik që furnizon mallra ose shfrytëzon shërbime për qëllimet që nuk bëjnë pjesë në kuadër të veprimtarisë së tij tregtare, afariste, zejtare ose profesionale;

35) "**Kontrata konsumatore**" është marrëdhënie e kontraktuar konsumatore e lidhur ndërmjet një konsumatori dhe një tregtari;

36) "**Marrëdhënie konsumatore**" është çdo marrëdhënie civile-juridike, palët e së cilës janë konsumator dhe tregtar, duke përfshirë marrëdhëniet kontraktuale me qëllime të dyfishta, pra marrëdhëniet kontraktuale të lidhura pjesërisht dhe për qëllime tregtare, e kur qëllimet tregtare janë aq të kufizuara saqë nuk mbizotëron në kontekstin e përgjithshëm të marrëdhënies kontraktuale;

37) "**Kundërshtimi i konsumatorit**" është çdo parashtresë ose ankesë me të cilën konsumatori raporton shkeljen e të drejtave që i ka sipas këtij ligji, një rregulle tjetër ose kontrate, që ia dorëzon tregtarit;

38) "**Ndikim i tepruar**" është shfrytëzimi i një pozicioni epërsie në raport me konsumatorin në atë mënyrë që ushtrohet presion, madje edhe pa përdorimin e forcës fizike ose kërcënimit për shfrytëzimin e saj, në mënyrën që kufizon aftësinë e konsumatorit për të marrë vendim të informuar;

39) "**Çmimi i shitjes**" është çmimi përfundimtar për njësi mallrash ose për sasi të caktuar të mallit, duke përfshirë edhe tatimin e vlerës së shtuar dhe të gjitha detyrimet tjera publike;

40) "**Nxitje të shitjes**" janë format e veçanta të vendosjes në treg, kur mallrat ose shërbimet ofrohen nën kushte më të favorshme në raport me ofertën paraprake ose të rregullt, respektivisht me çmime të ulura ose favore të tjera çmimesh, me kushte të veçanta të shitjes, dërgesë ose favore të tjera, duke premtuar shpërblim ose pjesëmarrje në lojë shpërbllyese, me dhurata shoqëruese, si dhe me çfarëdo favoresh të tjera;

41) "**Vëmendje profesionale**" është vëmendja e një eksperti të mirë, si standard i shkathtësive dhe kujdesit të veçantë që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga tregtari në marrëdhëniet me konsumatorin, në përputhje me praktikat e ndershme të tregut dhe/ose parimin e ndërgjegjes dhe ndershmërisë në fushën përkatëse të veprimit të tregtarit;

42) "**Produkt**" është malli ose sendi, pavarësisht nga shkalla e përpunimit të tyre, të dedikuar për t'iu ofruar konsumatorëve;

43) "**Prodhues**" është personi fizik ose juridik i cili ka përpunuar produktin e përfunduar, personi fizik ose juridik që ka prodhuar mallra të konsumit, subjekti që ka importuar mallra të konsumit në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe personi që, duke shënuar produktin me emrin e tij, ndërmarrje, emër, markë tregtare ose shenjë tjetër për dallimin e produktit, paraqitet si prodhues;

44) "**Renditja**" është pozicionim relativ që u jepet produkteve siç është paraqitur, organizuar ose komunikuar nga tregtari, pavarësisht mjeteve teknologjike që përdoren për këtë paraqitje, organizim ose njoftim;

45) "**Konsumator i rrezikuar**" është konsumatori i cili për shkak të pozitës së tij ekonomike ose shoqërore, kushteve të posaçme të jetesës, nevojave të veçanta ose mundësive të tjera të vështira personale dhe rrethanave familjare furnizon mallra ose shërbime në kushte veçanërisht të vështira ose nuk është në gjendje t'i blejë ato, si dhe konsumatori i cili për shkak të të metave fizike ose mendore, pleqërisë ose mendjemprehtësisë sillet në atë mënyrë që tregtari mund ta kishte parashikuar në mënyrë të arsyeshme;

46) "**Profesion i rregulluar**" është veprimtari profesionale ose grup i veprimeve profesionale ku qasja deri te të njëjtat, ushtrimi i tyre ose mënyrat e ushtrimit të tyre janë të kushtëzuara drejtpërdrejt ose tërthorazi me posedimin e kualifikimeve të veçanta profesionale;

47) "**Kontrata dytësore**" është kontrata me të cilën tregtari detyrohet t'i ofrojë konsumatorit mallra ose shërbime që lidhen me kontrata për përdorimin me afat të paluajtshmërisë, me kontrata për produkt afatgjatë për pushim, me kontrata në distancë ose kontrata jashtë hapësirave afariste të tregtarit, që konsumatorit ia realizon ose ushtron vetë tregtari ose ndonjë palë e tretë, e në bazë të kontratës së veçantë ndërmjet këtij subjekti të tretë dhe tregtarit;

48) "**Mall**" është çdo send i prekshëm i tundshëm, me përjashtim të mallrave që shiten në procedurë përmbartimi ose ndryshe sipas autorizimit të përcaktuar me ligj, si dhe uji, gazi dhe energjia elektrike që ofrohen për shitje në vëllim ose sasi të përcaktuar saktësisht;

49) "**Mall në gjendje refusi**" nënkupton mallrat që nuk janë të paketuara paraprakisht dhe që maten në prani të konsumatorit;

50) "**Mall me elemente digjitale**" është çdo send i prekshëm i lëvizshëm që përfshin ose është i ndërlidhur me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital në mënyrë të tillë që mungesa e asaj përmbajtjeje digjitale ose e shërbimeve digjitale do të pengonte mallin të ushtrijë funksionet e tij;

51) "**Mall i përpunuar sipas specifikimit të konsumatorit**" është mall që nuk është i përfunduar, por është përpunuar në përputhje me zgjedhjen individuale ose vendimin e konsumatorit;

52) "**Bartësi i përhershëm**" është mjet që që i mundëson konsumatorit ose tregtarit të ruajë informacionet që i janë dërguar personalisht, në mënyrë të tillë që të njëjtat të mund të qasen më vonë për një periudhë kohore përkatëse për qëllimet për të cilat janë dedikuar informacionet dhe që lejon shumimin e pandryshuar të informacioneve që ruhen;

53) "**Tregtar**" është personi fizik ose juridik që furnizon mallra ose jep shërbime, përkatësisht i ofron të njëjtat, duke përfshirë edhe përmes subjekteve të tjera që veprojnë në emër të tij ose për llogari të tij, për qëllimet e veprimtarisë së tij tregtare, afariste, zejtare ose profesionale, pa marrë parasysh nëse është në pronësi publike ose private;

54) "**Garancia tregtare**" është detyrim me të cilin tregtari ose prodhuesi, të dy si garantues ndaj konsumatorit, krahas përgjegjësisë së tregtarit në lidhje me garancinë tregtare për konformitetin e mallrave në kuptim të rregullave të zbatueshme për konformitetin e mallit të konsumit, obligohen konsumatorit t'ia kthejnë çmimin e paguar ose ta zëvendësojnë, riparojnë ose servisojnë mallin në çfarëdo mënyre, e kur malli nuk përputhet me specifikimin ose çfarëdo kërkesë tjetër që kanë të bëjnë me konformitetin, ndërsa janë përcaktuar në fletën e garancisë ose në reklamimin përkatës të disponueshëme përpara ose në momentin e lidhjes së kontratës;

55) "**Praktikë tregtare**" është kryerja, moskryerja, rrjedhë ose mënyrë e veprimit ose përfaqësimit, si dhe njoftim tregtar, duke përfshirë edhe reklamimin dhe vendosjen e mallrave në treg, nga tregtari, që lidhen drejtpërdrejt me promocionin, shitjen ose furnizimin e mallrave për konsumatorët;

56) "**Qëndrueshmëri**" është aftësia e produktit për të ruajtur funksionet dhe performancat e nevojshme nëpërmjet përdorimit normal;

57) "**Shërbim**" është ushtrimi i veprimtarisë që është dedikuar për t'u ofruar konsumatorëve;

58) "**Shërbim financiar**" është shërbim që ka natyrën e shërbimit bankar, kreditor ose sigurimit, si dhe shërbim të pensionit personal, investimit ose pagesës dhe;

59) "**Funksionalitet**" është aftësia e mallit, përkatësisht e përmbajtjes digjitale ose e shërbimit digjital për të ushtruar funksionet e saj duke marrë parasysh dedikimin e tij.

Zbatimi i këtij ligji dhe raporti ndaj ligjeve të tjera

Neni 4

(1) Zbatimi i dispozitave të këtij ligji nuk ndikon në të drejtat që i kanë konsumatorët në bazë të ligjeve të tjera.

(2) Çdo dispozitë kontraktuale ose kontrata me të cilën përjashtohen ose reduktohen të drejtat e konsumatorit të përcaktuara me këtë ligj ose me të cilën konsumatori heq dorë nga të njëjtat është e pavlefshme.

(3) Nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe, për marrëdhëniet me konsumatorin do të zbatohen dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore.

(4) Nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe, në procedurën e mbikëqyrjes inspektuese do të zbatohen dispozitat e Ligjit të Mbikëqyrjes Inspektuese.

Zbatimi i rregullave ndërnacionale

Neni 5

Dispozitat e kontratave ndërnacionale dhe kontratave për mbrojtjen e konsumatorëve që i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë së Veriut do të zbatohen drejtpërdrejt në rastet kur ofrojnë mbrojtje më të madhe të konsumatorëve.

Pjesa e dytë

VEPRIMI I TREGTARËVE NË MARRËDHËNIET KONSUMATORE

KREU 1

DETYRIMET E PËRGJITHSHME TË TREGTARËVE NË MARRËDHËNIET KONSUMATORE

Kapitulli 1

DETYRIME PËR INFORMIM DHE DETYRIME TË TJERA TË TREGTARËVE NË MARRËDHËNIET KONSUMATORE

Detyrim i përgjithshëm për informimin e konsumatorëve

Neni 6

(1) Tregtari është i detyruar t'i japë konsumatorit në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme, e me anë të ambalazhit, varëses, ngjitëses, udhëzimit, deklaratat, deklaratës, certifikatës dhe/ose dokumentit tjetër përkatës, së paku informacionet vijuese të sakta, të plota dhe të dobishme për:

1) shenjat, cilësinë, mënyrat e përdorimit dhe funksionalitetin e mallrave ose shërbimeve;

2) ndikimi i mallrave ose shërbimeve të caktuara në mjedisin jetësor dhe në jetën, shëndetin dhe mirëqenien e njeriut, si dhe në masat mbrojtëse, në përputhje me rregullat dhe standardet në fuqi; dhe

3) emri ose emërtimi, adresa gjeografike dhe të dhënat tjera të rëndësishme për përcaktimin e identitetit të tregtarit.

(2) Tregtari është i detyruar që informacionet nga paragrafi (1) i këtij neni t'ia japë konsumatorit të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj, gjë që nuk përjashton mundësinë e përdorimit të njëkohshëm edhe të gjuhëve të tjera, si në shenja ose piktogramet që janë lehtësisht të kuptueshme për konsumatorin.

(3) Në rast dyshimi nëse tregtari ka vepruar sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni, barra e dëshimit bie mbi tregtarin.

(4) Tregtari mund ta njoftojë personalisht ose me shkrim, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion, konsumatorin ose konsumatorin potencial që ka shprehur interes për të blerë një produkt, për karakteristikat kryesore të produktit, mënyrën e përdorimit dhe mirëmbajtjes, avancimet teknologjike dhe/ose karakteristikat e versioneve të ardhshme të produktit.

(5) Në mënyrë që t'i informojë konsumatorët për karakteristikat kryesore të produktit dhe në përputhje me politikën e tij afariste ose praktikën tregtare, tregtari mund:

- të demonstrojë shfrytëzimin e produktit në pikën e shitjes dhe/ose
- t'ia dorëzojë produktin konsumatorit të interesuar për shkak të provës falas, testim ose forma të tjera të aranzhimeve për provë para blerjes, me kusht që konsumatori të jetë i njoftuar paraprakisht me kushtet e aranzhimit të tillë.

(6) Dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni nuk i përjashtojnë detyrimet për shënimin e mallrave ose shërbimeve të përcaktuara me rregulla të veçanta.

Detyrimi i tregtarit për të vënë në dukje kushtet për shitjen e mallit dhe për ofrimin e shërbimeve

Neni 7

(1) Tregtari është i detyruar që në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme t'i theksojë kushtet e përgjithshme për shitjen e mallrave dhe për ofrimin e shërbimeve në hapësirat afariste të tij.

(2) Kushtet e veçanta për shitjen e mallrave dhe për ofrimin e shërbimeve, tregtari është i detyruar t'i theksojë qartë, dukshëm dhe lexueshëm në mënyrë që konsumatori të mund të vërejë lehtësisht se ato kanë të bëjnë vetëm me mallra ose shërbime të caktuara.

(3) Kur kushtet e veçanta për shitjen e mallrave dhe për ofrimin e shërbimeve kanë të bëjnë me grupe të caktuara të konsumatorëve, tregtari është i detyruar që të njëjtat t'i theksojë në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme në mënyrë që konsumatori të vërejë lehtësisht se ato kanë të bëjnë vetëm me grupe të caktuara të konsumatorëve.

(4) Kur kushtet e veçanta për shitjen e mallrave dhe për ofrimin e shërbimeve kanë të bëjnë me mënyrat dhe mjetet e pagesës, tregtari është i detyruar të njëjtat t'i theksojë qartë, dukshëm dhe lexueshëm në mënyrë që konsumatori të mund t'i vërejë dhe identifikojë lehtësisht mënyrat dhe mjetet e pagesës në dispozicion.

Ambalazhi

Neni 8

(1) Tregtari është i detyruar që mallrat t'i vendosë në treg në ambalazh që është përkatës me formën, madhësinë, vëllimin, sasinë dhe veçoritë e mallrave, në mënyrë që nuk mund të krijojë konfuzion te konsumatori për ndonjë nga këto shenja në mallin.

(2) Ambalazhi nuk duhet të jetë i dëmshëm për jetën, shëndetin dhe mirëqenien e njerëzve.

(3) Kur malli është në gjendje refusi, tregtari është i detyruar t'i sigurojë konsumatorit paketimin e tij në ambalazh përkatës.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni, konsumatori nuk është i detyruar të paguajë çmimin e ambalazhit, përveç kur kjo nuk është theksuar shprehimisht paraprakisht ose është shënuar qartë, dukshëm dhe lexueshëm në hapsëriat afariste të tregtarit.

(5) Në rastet kur malli, me kërkesë të konsumatorit, mbështillet ose paketohet në mënyrë të veçantë, duke përfshirë edhe dekorimet e veçanta, konsumatori nuk është i detyruar të paguajë çmimin për këtë, përveç nëse kjo nuk i është thënë shprehimit më parë ose është shënuar qartë, dukshëm dhe lexueshëm në hapsëriat afariste të tregtarit.

(6) Me kërkesë të konsumatorit, tregtari është i detyruar ta mbajë ambalazhin.

(7) Tregtari është i detyruar të kthejë dorëzaninë për ambalazhin gjatë kthimit të ambalazhit me llogari të bashkangjitur me të cilën e ka blerë mallin dhe ka paguar dorëzaninë.

Ndalim i shitjeve të kushtëzuara dhe ofrim i shërbimeve

Neni 9

(1) Është e ndaluar që tregtari t'i kushtëzojë konsumatorët gjatë shitjes së mallrave ose në ofrimin e shërbimeve, me furnizimin e çfarëdo mallrave dhe/ose shërbimeve tjera nga ai ose nga ndonjë subjekt i tretë.

(2) Çdo kontratë në kundërshtim me ndalimin nga paragrafi (1) i këtij neni është e pavlefshme.

(3) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e numrit maksimal të mallrave të llojit të njëjtë të furnizuara nga konsumatori gjatë marrëdhënieve konsumatore.

Zëvendësim me mall tjetër

Neni 10

(1) Tregtari ka për obligim me kërkesë të konsumatorit i cili ka blerë mall, e që nuk është i përshtatshëm në raport me formën, madhësinë, modelin, ngjyrën, numrin ose për arsye të tjera, të njëjtin ta zëvendësojë me mall që ka cilësi përkatëse, përveç në rastin e mallit të përpiluar me porosi të konsumatorit.

(2) Tregtari është i detyruar të bëjë zëvendësimin e mallit nga paragrafi (1) i këtij neni, në afat prej 15 ditësh nga dita kur konsumatori i është dorëzuar malli.

(3) Zëvendësimi i mallit me cilësi përkatëse do të bëhet nëse malli nuk është përdorur, nëse i ruhet pamja e tij, veçoritë e përdorimit, vulat dhe shenjat e fabrikës, si dhe fatura që i është lëshuar konsumatorit së bashku me mallin.

(4) Nëse në momentin e parashtrimit të kërkesës nga konsumatori tregtari nuk ka mall përkatës, në kuptimin e mallit që do t'u përshtatet nevojave të tij, konsumatori ka të drejtë, sipas zgjedhjes së vet, të kërkojë:

1) të ndërpresë kontratën dhe të kërkojë kthimin e vlerës së paguar

2) të zëvendësojë mallin me mall tjetër përkatës, e kur tregtari do të ketë në dispozicion mall të tillë.

(5) Tregtari është i detyruar që ta njoftojë konsumatorin që ka kërkuar zëvendësimin e mallit se ka në dispozicion mall të tillë në afat që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës për ndërrimin e mallit.

Kapitulli 2
DETYRIMET E TREGTARËVE GJATË SHËNIMIT TË ÇMIMEVE

Dispozita të përgjithshme për shënimin e çmimeve

Neni 11

(1) Tregtari është i detyruar të shënojë mallrat me çmimin e shitjes dhe çmimin e njësisë për mallrat, në mënyrë të padyshimtë, të dukshme, të lexueshme dhe të qartë, me qëllim të informimit më të mirë të konsumatorit dhe për lehtësimin e krahasueshmërisë së çmimeve.

(2) Tregtari është i detyruar që çmimet e shërbimeve t'i shënojë në mënyrë që çmimet që shënohen në mallim të shënohen në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, me përshtatje përkatëse.

Valuta e çmimit

Neni 12

Çmimi i mallrave dhe shërbimeve duhet të shënohet në denarë, përveç nëse me ligj tjetër nuk parashikohet ndryshe.

Mënyrat e shënimit të çmimit

Neni 13

(1) Çmimi i shitjes, respektivisht çmim për njësi duhet të shënohet në vetë mallin, gjegjësisht në ambalazhin e tij, kur kjo është e mundshme.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni është i lejuar çmimi i shitjes, respektivisht çmimi i njësisë të shënohet më poshtë, mbi ose pranë vendit ku është ekspozuar malli, me referencë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme të mallit përkatës, e në mënyrë që nuk shkakton konfuzion te konsumatori për atë se me cilin mall ka të bëjë çmimi përkatës.

(3) Tregtari është i detyruar të shënojë çmimin në mënyrë që malli dhe shenjat e tyre të mos dëmtohen.

(4) Tregtari është i detyruar t'u përmbahet çmimeve të shënuara të shitjes, respektivisht çmimeve për njësi.

(5) Kur malli vendoset në treg me ç'rast bëhet ulje e çmimit, tregtari mund ta shënojë mallin në mënyrë përkatës me më së shumti dy çmime duke e shënuar çmimin e ri pranë çmimit të mëparshëm të shlyer në mënyrë të dukshme.

(6) Kur në hapësirat afariste të tregtarit bëhet edhe shitja me pakicë, krahas shitjes me shumicë, tregtari është i detyruar që në mënyrë të padyshimtë, të dukshme, të lexueshme dhe të qartë të shënojë fillimisht çmimin me pakicë, e më pas edhe çmimin e shitjes me shumicë të mallit.

Shënimi i çmimit me lista të çmimeve dhe lista tarifore

Neni 14

(1) Përveç mënyrës së shënimit të çmimeve të përcaktuara me nenin 13 të këtij ligji, lejohet që shënimi i çmimeve të bëhet edhe me lista të çmimeve ose lista të tarifave.

(2) Kur shënimi i çmimeve të shërbimeve bëhet vetëm përmes listave të çmimeve ose tarifave, i njëjti duhet të jetë në mënyrë të padyshimtë, të dukshme, të lexueshme dhe të qartë.

(3) Me kërkesë të konsumatorit, tregtari është i detyruar t'i vë në dispozicion listat e çmimeve ose listat e tarifave.

Llojet e shënimit të çmimit

Neni 15

(1) Çmimi për njësi duhet të shënohet edhe kur mallrat shiten si produkt i vetëm ose individualisht si pjesë e produktit të vetëm.

(2) Nuk është e nevojshme të shënohet çmimi për njësi kur është i njëjtë me çmimin e shitjes.

(3) Kur në përputhje me rregullat e veçanta është e nevojshme të shënohet masa neto dhe masa neto e materies së thatë për mallra të caktuara të paketuara paraprakisht, mjafton të shënohet çmimi për njësi për masën neto të materies së thatë.

(4) Te mallrat në gjendje refusi shënohet vetëm çmimi për njësi.

Zbatimi përkatës për qëllimet e reklamimit

Neni 16

(1) Dispozitat e neneve 11, 12, 13, 14 dhe 15 të këtij ligji zbatohen edhe gjatë reklamimit të mallrave.

(2) Kur gjatë reklamimit të mallit është përmendur çmimi i shitjes i mallit, duhet të përmendet edhe çmimi i tyre për njësi.

(3) Dispozita nga paragrafi (2) i këtij neni ka të bëjë edhe kur zbatohet njësia e kohës për shërbimin e kryer.

Përfundime

Neni 17

(1) Obligimi i tregtarit për shënimin e çmimeve, në përputhje me nenet 11, 12, 13, 14 dhe 15 të këtij ligji, nuk zbatohet në rastet kur gjatë ushtrimit të shërbimit të caktuar konsumatori furnizon mall të caktuar, në rastet e shitjes në ankand, si dhe në rastet e shitjes së veprave artistike dhe antikitetet.

(2) Tregtari nuk është i detyruar të shënojë mallin me çmim për njësi për mallrat për të cilat shënimin i tillë nuk është i dobishëm duke marrë parasysh natyrën ose dedikimin e mallit ose kur kjo do të mund të shkaktonte konfuzion te konsumatori.

(3) Lista e mallrave për të cilat nuk është i nevojshëm shënimin e çmimit për njësi në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, si dhe Listën e mallrave joushqimore ose kategoritë e tyre për të cilat, pavarësisht nga paragrafi (2) i këtij neni, tregtari është i detyruar të shënojë çmimin për njësi të cilin e përcakton ministri i Ekonomisë.

Kapitulli 3

DETYRIME TË TREGTARËVE GJATË NXITJEVE SHITËSE

Pjesa 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR NXITJEN E SHITJES

Kushte të nxitjeve të shitjeve

Neni 18

Tregtari është i detyruar t'i zbatojë nxitjet e shitjes për mallrat dhe shërbimet në mënyrë që të njëjtat:

1) të jenë me afat të vlefshmërisë dhe shpeshësisë, në përputhje me këtë ligj, e në raport me ofertën e rregullt të tregtarit dhe

2) t'i referohen sasisë së mallrave ose disponueshmërisë së shërbimeve që janë të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e një numri të madh të konsumatorëve.

Detyrim për informim gjatë nxitjes së shitjes

Neni 19

(1) Tregtari është i detyruar gjatë realizimit të promocionit të shitjes së mallrave dhe shërbimeve t'i përmendë informacionet vijuese:

- 1) përcaktimin e llojit dhe mënyrës së nxitjes;
- 2) përcaktimin e saktë dhe të qartë të mallrave ose shërbimeve me të cilat ka të bëjë;
- 3) afati i kohëzgjatjes së nxitjes, me shënimin e datës së fillimit të tij;
- 4) të gjitha kushtet eventuale të veçanta të ndërlidhura me realizimin e të drejtave që rezultojnë nga nxitja dhe

5) kur është e zbatueshme, shpenzimet e përgjithshme që ndërlidhen me marrjen ose marrjen përsipër të mallit, duke përfshirë dorëzimin, si dhe përkujtim për shpenzimet dhe kompensimet tjera që janë në kurriz të konsumatorit.

(2) Në rastet kur nxitja e shitjes ka të bëjë me uljen e çmimit ose formë tjetër të lehtësimit në çmim, nxitja e shitjes, krahas të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të përmbajë edhe të dhëna për krahasim; respektivisht shfaqjen e çmimit të shitjes, respektivisht çmimit për njësi në raport me çmimin paraprak të shitjes, respektivisht çmimin paraprak për njësi.

(3) Në rastet kur nxitja e shitjes ka të bëjë me uljen e çmimit ose formë tjetër të lehtësimit të çmimit, tregtari mund të shënojë mallin përkatës me më së shumti dy çmime, me përmendjen e çmimit të ri krahas çmimit të mëparshëm të shlyer në mënyrë të dukshme.

(4) Tregtari është i detyruar gjatë lëshimit të vauçerëve, kuponëve dhe dokumenteve tjera shitëse, krahas të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni, të përmendë edhe informacione për lëshuesin e tyre, si dhe për vlerën në para ose lartësinë e zbritjes.

Pjesa 2

FORMA TË VEÇANTA TË VENDOSJES NË TREG

Dispozita të përgjithshme

Neni 20

(1) Si forma të veçanta të vendosjes në treg konsiderohen rastet e nxitjes së shitjes kur mallrat dhe shërbimet vendosen në treg me çmime që janë më të ulëta sesa çmimet sipas të cilave mallrat ose shërbimet përkatëse vendosen rregullisht në treg.

(2) Forma të veçanta të vendosjes në treg në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni janë: shitja totale, shitja aksionale (aksion), shitje promovionale (promocion), ulje sezonale, vendosje në treg të mallrave të cilave u skadon afati i përdorimit.

(3) Tregtari është i detyruar gjatë zbatimit të formave të veçanta të vendosjes në treg të mallrave ose shërbimeve që janë më të ulëta sesa çmimet me të cilat mallrat dhe shërbimet përkatëse vendosen rregullisht në treg, format e e veçanta t'i shënojë me emrat e përmendur në paragrafin (2) të këtij neni.

Mënyrat e shënimit të çmimeve

Neni 21

(1) Tregtari është i detyruar t'i shënojë mallrat ose shërbimet me çmimin paraprak të shitjes dhe çmimin e zbritur të shitjes për tërë kohëzgjatjen e formës së veçantë të vendosjes në treg në përputhje me nenin 20 paragrafi (2) të këtij ligji.

(2) Kur tregtari zbaton forma të veçanta të vendosjes në treg që janë vijuese, çdo formë e veçantë e radhës e vendosjes në treg konsiderohet e mëvetësishme.

(3) Gjatë zbatimit të formave të veçanta të vendosjes në treg, lejohet që zbritja e çmimeve të bëhet vetëm në një nga mënyrat vijuese:

1) me shënimin e çmimit të ri krahas çmimit paraprak të shitjes, të shlyer, por ende të dukshëm;

2) me shënimin e çmimit të ri dhe paraprak të shitjes me fjalët "çmim i ri" dhe "çmim i vjetër", në mënyrë përkatëse ose

3) me përmendjen e përqindjes së zbritjes së çmimit, e gjatë shënimit të njëhershëm të çmimit të ri pranë çmimit paraprak të shlyer, por ende të dukshëm.

(4) çmim paraprak i shitjes do të konsiderohet çmimi më i ulët që tregtari e ka shënuar së paku 30 ditë para fillimit të shënimit të formës së veçantë të vendosjes në treg.

(5) Dispozitat e paragrafit (4) të këtij neni nuk kanë të bëjnë me rastet kur tregtarit gjatë vlefshmërisë së formës së veçantë të vendosjes në treg do të marrë dërgesë të re të mallrave që janë të përfshira tashmë në formën e veçantë të vendosjen në treg.

(6) Tregtari është i detyruar, para fillimit të zbatimit të formës së veçantë të vendosjes në treg të bëjë evidentimin e çmimit paraprak të shitjes dhe çmimin e zbritur, në përputhje me Ligjin e Tregtisë.

(7) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen për kontratat në distancë dhe kontratat jashtë hapësirës afariste të tregtarit, si dhe në rastet kur forma e veçantë e vendosjes në treg zgjatë më pak se tri ditë.

Detyrimet në lidhje me mallrat ose shërbimet

Neni 22

(1) Gjatë zbatimit të formave të veçanta të vendosjes në treg, tregtari është i detyruar të ndajë fizikisht mallrat e përfshirë në njërën nga format e veçanta të vendosjes në treg, me përjashtim të rasteve kur tregtari e ka shënuar qartë mallin që përfshihet me ndonjë nga format e veçanta të vendosjes në treg.

(2) Tregtari është i detyruar që në format e veçanta të vendosjes në treg, të theksojë qartë, dukshëm dhe lexueshëm për cilën formë të veçantë të vendosjes në treg bëhet fjalë.

(3) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohet kur forma e veçantë e vendosjes në treg ka të bëjë me një gamë të tërë të mallrave ose shërbimeve që i ofron tregtari.

Shitja totale

Neni 23

(1) Shitja totale, si formë e veçantë e vendosjes në treg të mallrave ose shërbimeve, lejohet vetëm në një nga rastet vijuese:

1) ndërprerje të punës së tregtarit;

2) ndërprerje të punës së tregtarit në hapësirat e tij të deriatëhershme afariste;

3) ndërprerje të vendosjes në treg të mallrave ose shërbimeve të caktuara nga lënda e veprimtarisë së tregtarit ose

4) gjatë ushtrimit të intervenimeve komplekse ndërtimore në hapësirat afariste të tregtarit.

(2) Shitja totale nga paragrafi (1) pikat 2) dhe 3) të këtij neni lejohet vetëm me kusht që tregtari të mos vazhdojë me ofrimin e mallrave ose shërbimeve në hapësirat e tij të deriatëhershme afariste, respektivisht vendosje në treg të mallrave dhe shërbimeve të caktuara në afat jo më të shkurtër se gjashtë muaj nga data e përfundimit të shitjes totale.

Shitja aksionale (aksion)

Neni 24

(1) Shitja aksionale (aksion), si formë e veçantë e vendosjes në treg të numrit të kufizuar të mallrave ose shërbimeve, në raport me të gjitha mallrat ose shërbimet që i ofron tregtari, do të zbatohet në afat të kohëzgjatjes jo më të gjatë se 30 ditë.

(2) Mallrat ose shërbimet e vendosura në shitjen aksionale duhet të jenë të shënuara në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme me fjalët "aksion" ose "shitje aksionale".

(3) Gjatë reklamimit së shitjes aksionale, tregtari është i detyruar të përmendë kohëzgjatjen e saj.

Shitja promociionale (promocion)

Neni 25

(1) Shitja promociionale (promocioni), si formë e veçantë e vendosjes në treg të numrit të kufizuar të mallrave ose shërbimeve të reja, në lidhje me të gjitha mallrat ose shërbimet ekzistuese që i ofron tregtari, do të zbatohet në afat të kohëzgjatjes jo më të gjatë se tetë ditë.

(2) Mallrat ose shërbimet e vendosura në shitjen promociionale duhet të jenë të shënuara në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme me fjalët "promocion" ose "shitje promociionale".

(3) Gjatë reklamimit të shitjes promociionale, tregtari është i detyruar të përmendë kohëzgjatjen e saj.

Zbritje sezonale

Neni 26

Zbritja sezonale, si formë e veçantë e vendosjes në treg të mallrave apo shërbimeve, zbatohet pas përfundimit të sezonit përkatës, në periudhat vijuese:

1) zbritje sezonale verore në periudhën ndërmjet 25 gushtit dhe 25 shtatorit të vitit rrjedhës dhe

2) zbritje sezonale dimërore në periudhën nga 25 dhjetori i vitit rrjedhës deri më 25 janar të vitit të ardhshëm.

Vendosja në treg e mallrave me defekt ose gabim

Neni 27

(1) Kur tregtari vendos në treg mallrat me defekt ose gabim, është i detyruar t'i ndajë fizikisht nga mallrat tjera, si dhe t'i shënojë në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme si mall me defekt ose gabim.

(2) Kur natyra e mallrave e kërkon këtë, tregtari është i detyruar të shënojë qartë, dukshëm dhe lexueshëm edhe llojin edhe natyrën e defektit ose gabimit.

Vendosja në treg e mallrave të cilave u skadon afati i përdorimit

Neni 28

Tregtari është i detyruar gjatë vendosjes në treg të mallrave që u ka skaduar afati i përdorimit t'i ndajë fizikisht këto mallra, si dhe të shënojë qartë, dukshëm dhe lexueshëm se të njëjtave u ka skaduar afati i përdorimit, me ç'rast zbatohen rregullat që kanë të bëjnë me shënimin e datave të përdorimit.

Кapитulli 4

DETYRIME TË TREGTARËVE GJATË OFERTAVE TË PËRBASHKËTA TË MALLRAVE OSE SHËRBIMEVE

Kushtet për lejimin e ofertës së përbashkët

Neni 29

Oferta e përbashkët është e lejueshme nëse:

- 1) secili nga mallrat ose shërbimet mund të furnizohet veçmas me çmimin e tyre të rregullt në hapësirat e njëjta afariste të tregtarit dhe
- 2) konsumatori është i informuar qartë për mundësinë e furnizimit të veçantë dhe për çmimin e rregullt të secilit prej mallrave ose shërbimeve.

Oferta të tjera të përbashkëta

Neni 30

Është e lejuar që falas, së bashku me ndonjë mall ose shërbim tjetër, të ofrohen:

- 1) mallrat ndihmëse, dytësore ose shoqëruese të mallit kryesor, e që janë përshtatur në mënyrë të veçantë për këtë mall nga prodhuesi i tij dhe që realizohen njëkohësisht dhe së bashku me mallin kryesor për qëllimet e zgjerimit ose përmirësimit të përdorimit të mallit kryesor;
- 2) paketime, mbështjellës ose kontejnerë që përdoren për mbrojtjen dhe paketimin e mallit, duke marrë parasysh natyrën dhe vlerën e tyre;
- 3) dhurata të imta ose shërbime të vogla që konsiderohen të zakonshme në praktikën tregtare, si dhe dorëzim, vendosje, montim, bashkimin, formësimin, kontrollin dhe mirëmbajtja e mallrave që vendosen në treg;
- 4) mostra dhe ekzemplarë të siguruar nga prodhuesi ose shitësi me shumicë i mallrave kryesore, me kusht që ato të ofrohen në një sasi, vëllim ose masë që është jashtëzakonisht thelbësore për vlerësimin e veçorive ose cilësisë së mallit kryesor; dhe
- 5) vauçerë, kupona, kartela të ndryshme ose dokumente të tjera të shitjes nga tregtari për uljen e çmimit ose përfitime të tjera të çmimit.

Кapитulli 5

DETYRIME TË TREGTARIT NË ASPEKTIN E NJOFTIMIT PËR MËNYRAT E PAGESËS, LLOGARISË DHE DETYRIMEVE TË TJERA GJATË PAGESËS

Detyrim për njoftim për mënyrat dhe mjetet e pagesës

Neni 31

Tregtari është i detyruar të informojë konsumatorin, para se i njëjti të bëhet i detyruar në marrëdhënien konsumatore, për mënyrat dhe mjetet e pagesës në dispozicion.

Llogaria

Neni 32

- (1) Tregtari për produktin e shitur, respektivisht shërbimin e kryer duhet t'i lëshojë konsumatorit llogari fiskale, respektivisht fletëpagesë ose faturë të shkruar në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme qartë, nëse me rregull tjetër nuk është përcaktuar ndryshe.
- (2) Tregtari duhet t'ia mundësojë konsumatorit kontrollin e saktësisë së vlerës së përlllogaritur në raport me cilësinë dhe sasinë e produktit të blerë, respektivisht shërbimit të kryer.

(3) Për lëshimin e llogarisë nga paragrafit (1) i këtij neni nuk lejohet të arkëtohet në mënyrë plotësuese.

Dispozita të veçanta për arkëtimin e riparimit dhe/ose mirëmbajtjes së mallrave dhe pagesat plotësuese

Neni 33

(1) Për shërbimet e kryera në riparimin dhe/ose mirëmbajtjen e mallrave vlera e të cilave është më e lartë se 5.000,00 denarë, tregtari është i detyruar t'i dorëzojë konsumatorit ofertë në formë të shkruar, në letër ose në bartës tjetër të përhershëm, me përshkrim të gjërave, materialeve dhe pjesëve të nevojshme.

(2) Kur gjatë riparimit dhe/ose mirëmbajtjes së mallrave do të shfaqet nevoja për gjëra plotësuese, materiale ose pjesë të nevojshme, tregtari është i detyruar të veprojë në përputhje me dispozitat e këtij ligji që kanë të bëjnë me pagesat plotësuese.

(3) Bara e dëshmimit për dorëzimin e ofertës nga paragrafi (1) i këtij neni bie mbi tregtarin.

Pagesa e paradhënies

Neni 34

(1) Kur tregtari kërkon ose i kushtëzon shprehimisht furnizimin e mallrave dhe shërbimeve me paradhënie të pjesëshme ose të përgjithshme, pa marrë parasysh nëse i njëjti është i njëhershëm ose në këste, është i detyruar t'i zbatojë shërbimet pas pranimit të paradhënies.

(2) Kur afati për realizimin e mallrave ose për zbatimin e shërbimeve është më i gjatë se 30 ditë, tregtari është i detyruar t'i paguajë kamata të paradhënies sipas normës për kamatës ndëshkuese ligjore për përcaktuar në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore që vlen për kontratat në të cilat së paku njëri person nuk është tregtar, ndërsa për kohën nga pranimi i paradhënies deri në ditën e realizimit të mallrave ose të realizimit të shërbimeve në përputhje me rregullat me çka rregullohen shpenzimet për marrëdhëniet detyrimore.

(3) Nëse tregtari nuk ia paguan konsumatorit kamatat nga paragrafi (2) i këtij neni gjatë realizimit të mallrave ose zbatimit të shërbimeve, konsumatori është i autorizuar të refuzojë realizimin e mallrave ose zbatimin e shërbimeve deri në pagesën e kamatave të paradhënies.

(4) Kur tregtari nuk do ta përmbushë kontratën, është i detyruar që konsumatorit t'ia kthejë paradhënien e pranuar të rritur për kamatat e paradhënies sipas normës për kamatë ndëshkuese ligjore të përcaktuar në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore që vlen për kontratat në të cilat së paku një person nuk është tregtar, ndërsa për kohën nga pranimi i paradhënies deri në ditën e kthimit të saj.

(5) Tregtari është i detyruar t'ia paguajë konsumatorit vlerat nga paragrafi (4) i këtij neni në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e ndërprerjes së kontratës.

(6) Pas skadimit të afateve nga paragrafet (2) dhe (5) të këtij neni, kamatat e borxhit kapitalizohen me vlerën e paradhënies.

Pagesa përmes bankës, postës ose bartësit tjetër të qarkullimit pagesor

Neni 35

Nëse tregtari e ka njoftuar konsumatorin se pagesa do të mund të bëhet përmes bankës, postës ose bartësit tjetër të qarkullimit pagesor, konsiderohet se pagesa është kryer kur banka, posta ose bartës tjetër i qarkullimit pagesor do ta pranojë fletëurdhëresën për pagesë që është bërë e parevokueshme ose, nga ana tjetër, pagesa e vlerës së borxhit, ka qenë nga konsumatori ose ndonjë subjekt i tretë i cili vepron në emër dhe/ose për llogari të konsumatorit.

Njoftime ose paralajmërime për vonesë gjatë pagesës

Neni 36

(1) Është e ndaluar që tregtari të bëjë arkëtim për çdo njoftim ose paralajmërim për konsumatorin për shkak të mospagesës së detyrimeve të tij të mbërritura në para.

(2) Është e ndaluar që tregtari të autorizojë subjekt tjetër që t'i drejtohet konsumatorit, personalisht atij ose anëtarëve të amvisërisë së tij, përmes telefonit, faks-pajisjes, postës, postës elektronike ose mjet tjetër për komunikim në distancë, e për shkak të realizimit të kërkesave të tij në raport me konsumatorin, pa pëlqim të shkruar të shqiptuar paraprakisht nga konsumatori.

(3) Konsumatori mund të revokojë në çdo kohë pëlqimin e shprehur të shkruar nga paragrafi (2) i këtij neni në formë të shkruar në letër ose bartës tjetër të përhershëm.

(4) Dispozita nga paragrafi (2) i këtij neni nuk ka të bëjë me të autorizuarit e tregtarit, kur të njëjtët janë të autorizuar për të ndërmarrë veprime procesi.

Kapitulli 6

DETYRIME TË TREGTARËVE PËR DORËZIMIN E DOKUMENTEVE DHE DETYRIME TË NDËRLIDHURA

Dispozita të përgjithshme për dorëzimin e dokumenteve të nevojshme dhe të përcaktuara

Neni 37

(1) Tregtari është i detyruar gjatë realizimit të mallit ose zbatimit të shërbimit t'ia dorëzojë dhe t'ia bëjë të ditura konsumatorit dokumentet që i ka përpiluar prodhuesi, importuesi ose shitësi me shumicë për shkak të shfrytëzimit më të lehtë dhe të sigurt të mallrave ose shërbimeve (deklaratë, certifikatë, fletë garancie, deklaratë për konformitet, udhëzues teknik, udhëzues për bashkim, formësimi dhe/ose montim, udhëzues për shfrytëzim, listë e serviseve të autorizuarra dhe ose dokument tjetër përkatës).

(2) Tregtari është i detyruar që dokumentet nga paragrafi (1) i këtij neni t'ia sigurojë konsumatorit të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj, që nuk përjashton mundësinë e përdorimit të njëhershëm edhe të gjuhëve të tjera, si dhe të shenjave ose piktogrameve që janë lehtë të kuptueshme për konsumatorin.

(3) Tregtari është i detyruar t'u përmbahet detyrimeve të përmendura në dokumentet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Dispozita të veçanta për deklaratën

Neni 38

(1) Tregtari është i detyruar të vendosë në treg mallra dhe, ku është e zbatueshme, shërbime me deklaratë.

(2) Nëse me rregulla të veçanta nuk është e përcaktuar ndryshe, deklarata duhet t'i përmbajë së paku të dhënat si vijon:

- 1) emri i mallit, respektivisht emri me të cilin malli vendoset në treg;
- 2) përbërja e mallit;
- 3) mënyra e mirëmbajtjes së mallit;
- 4) mënyra e përdorimit të mallit;
- 5) data e prodhimit dhe afati i përdorimit, nëse malli është i tillë sipas natyrës së tij;

6) emri ose emërtimi dhe selia e prodhuesit, respektivisht tregtarit nëse ky ka shenjën e vet dalluese të mallit, ndërsa për mallrat e importuara edhe emra ose emërtim dhe seli të importuesit, si dhe të vendit të origjinës;

7) paralajmërim për rrezik të mundshëm gjatë përdorimit të mallit, nëse ekziston rrezik i tillë;

8) deklaratë e prodhuesit për ekzistimin e veçorive të ndryshuara të mallit, si dhe të përbërësve, pjesëve dhe shtesave të tij, respektivisht për çfarë ndryshimesh bëhet fjalë dhe

9) deklaratë për konformitetin e mallit me kushtet e përcaktuara të lëshuar nga prodhuesi.

(3) Krahas të dhënave nga paragrafi (2) i këtij neni deklarata duhet të përmbajë edhe të dhëna të përcaktuara me rregulla të veçanta.

(4) Në raport me mallrat e importuara, për të dhënat e përmendura në deklaratën është përgjegjës importuesi.

(5) si titull i mallit, respektivisht emër me të cilin malli vendoset në treg konsiderohen shenja ose përshkrimi i mallit dhe, aty ku është përkatëse, përdorimin dhe mirëmbajtjen e tij, që janë mjaftë të qarta dhe të sakta në mënyrë që t'i mundësojnë konsumatorit të dallojë mallin përkatës dhe të njëjtin ta dallojë nga mallrat tjera të ngjashme me të cilat do të mund ta zëvendësojë.

(6) Për mallrat në gjendje refusi dhe mallrat me madhësi dhe vëllim të vogël, deklarata duhet të jetë e theksuar në mënyrë të qartë, të dukshme dhe lexueshme në ambalazhin në të cilin malli vendoset në treg ose paketohet, respektivisht në lidhësen e mallit, respektivisht vendin ku malli vendoset në treg.

Qasje deri te servisi dhe pjesët reserve

Neni 39

(1) Tregtari është i detyruar që konsumatorit t'i sigurojë servis për mallrat që ia ka realizuar, nga ana e tij ose nga ana e një subjekti të tretë, e në bazë të kontratës së posaçme mes këtij subjekti të tretë dhe tregtarit.

(2) Tregtari është i detyruar që të sigurojë qasje deri te shërbimet e servisit, ndërsa së bashku me prodhuesin edhe deri te pjesët rezerve për mallin, për së paku pesë vite duke llogaritur nga dita e prodhimit të tij, por jo më pak se dy vite nga dita e dërgimit të tij te konsumatori.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij nenin nuk kanë të bëjnë me mallrat e përdorura.

Kapitulli 7

PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN E SHKAKTUAR NGA PRODUKTI ME DEFEKT

Dispozita e përgjithshme

Neni 40

Prodhuesi i cili do të lëshojë në treg produkt përgjigjet për dëmin e shkaktuar nga parregullsia e atij produkti, pa marrë parasysh fajin e tij.

Vëllimi i zbatimit

Neni 41

(1) Dispozitat për përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga produkti me defekt në përputhje me nenin 40 të këtij ligji zbatohen në përgjegjësinë për dëmin material të shkaktuar me:

1) vdekjen ose lëndimin e trupit dhe

2) shkatërrimin ose dëmtimin e sendit të ndryshëm nga vetë produkti me defekt, nëse bëhet fjalë për:

- a) lloj të tillë të sendit që zakonisht është i dedikuar për përdorim personal ose konsum dhe
- b) nëse ky send është përdorur nga i dëmtuari kryesisht për përdorim personal ose konsum.

(2) I dëmtuari ka të drejtën e kompensimit të dëmit material në përputhje me paragrafin (1) pika 2) e këtij neni, sipas dispozitave për përgjegjësi për dëmin nga produkti me defekt, vetëm për dëmin që tejkalon 500 euro në kundërvlerë denari sipas kursit mesatar të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) I dëmtuari ka të drejtën e kompensimit të dëmit jomaterial të shkaktuar nga produkti me defekt në përputhje me dispozitat nga Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore.

(4) Ndaj vlerës së kompensimit të dëmit material të shkaktuar nga vdekja ose lëndimi i trupit zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat nga Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore për kompensimin e dëmit material në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit.

(5) Ndaj dëmit të shkaktuar nga aksidenti bërthamor zbatohen dispozitat e përgjithshme nga Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar, respektivisht dispozitat nga marrëveshjet përkatëse ndërnacionale dhe marrëveshjet e ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(6) Për përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga produkti me defekt përveç dispozitave të këtij neni dhe neneve 40, 42, 43, 44, 45, 46, 47 dhe 48 të këtij ligji zbatohen edhe dispozitat e përgjithshme nga Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore për përgjegjësi për dëmin e shkaktuar kontraktual dhe jashtëkontraktual.

Dëshmimi i defektit të produktit

Neni 42

I dëmtuari duhet të dëshmojë defektin e produktit, dëmin e shkaktuar, si dhe lidhjen shkakore-pësore (kauzale) mes parregullsisë së produktit dhe dëmit të shkaktuar.

Produkt me defekt

Neni 43

(1) Produkti është me defekt kur nuk e jep sigurinë që nga produktet e tilla pritet realisht, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, duke përfshirë:

- a) prezantimin e produktit;
- b) dedikimi për të cilin ishte e arsyeshme të pritet se produkti do të ishte shfrytëzuar dhe
- c) data e lëshimit të produktit në treg.

(2) Produkti i vendosur në treg nuk konsiderohet me defekt nëse në mënyrë vijuese është lëshuar në treg produkt i llojit të njëjtë me veçori të përmirësuara.

Prodhuesi

Neni 44

(1) Si prodhues në kuptimin e dispozitave për përgjegjësi për dëmin e shkaktuar nga produkti me defekt konsiderohet edhe personi fizik që ka përpunuar produkt të përfunduar, subjekti që ka prodhuar dhe përpunuar çfarëdo lënde të parë ose çfarëdo pjese përbërëse të përfshirë në produktin e përfunduar, si dhe çfarëdo subjekti që duke e shënuar produktin në emër të tij, ndërmarrje, emërtim, markë tregtare ose çfarëdo shenje tjetër për dallimin e produktit, prezantohet si prodhues.

(2) Pa marrë parasysh përgjegjësinë e prodhuesit, në kuptim të paragrafit (1) të këtij neni, si prodhues konsiderohet edhe subjekti që në territorin e shtetit e ka importuar produktin për shkak të shitjes, dhënies me qira, lizingut ose për çfarëdo lloji tjetër të vendosjes së produktit në treg.

(3) Nëse nuk është e mundshme të përcaktohet se kush është prodhuesi, i tillë konsiderohet çdo person fizik dhe juridik që bën furnizim të produktit ose të njëjtin e vendosë në treg, përveç nëse në afat të arsyeshëm nuk e njofton të dëmtuarin për atë se kush është prodhuesi ose kush është subjekti që e ka furnizuar produktin.

(4) Dispozita nga paragrafi (3) i këtij neni zbatohet për produktet e importuara dhe kur nuk mund të përcaktohet se cili subjekt e ka importuar produktin, po edhe atëherë kur emri, ndërmarrja ose emërtimi i prodhuesit janë përmendur në produktin.

Përgjegjësi solidare për dëmin nga produkti me defekt

Neni 45

(1) Kur dy ose më shumë persona janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga produkti me defekt, përgjegjësia e tyre është solidare.

(2) Çdo kontratë në kundërshtim me dispozitën e paragrafit (1) të këtij neni është e pavlefshme.

(3) Në raport me marrëdhëniet regresive të debitorëve solidarë, zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore për përgjegjësinë objektive për dëmin.

Lirim nga përgjegjësia për dëmin

Neni 46

(1) Prodhuesi lirohet nga përgjegjësia për dëmin nëse dëshmon se:

1) nuk e ka lëshuar produktin në treg ose
2) duke marrë parasysh rrethanat e rastit, ka gjasa që defekti që ka shkaktuar dëmin të mos ketë ekzistuar kur ai e ka lëshuar produktin në treg ose se defekti është shfaqur më vonë ose

3) produktin nuk e ka përpunuar për shitje ose çfarëdo lloji tjetër të shpërndarjes me qëllim ekonomik, e as nuk e ka prodhuar apo shpërndarë gjatë veprimtarive të tij afariste ose

4) defekti i produktit është për shkak se produktit është prodhuar dhe lëshuar në treg, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në rregullat e veçanta për këto produkte ose

5) gjendja e shkencës dhe e njohurisë teknike, në momentin e vendosjes së produktit në treg, nuk kanë mundësuar zbulimin e defektit ose

6) në rastin e prodhuesit të pjesës përbërëse, defekti mund t'i përshkruhet dizajnit të produktit në të cilin është instaluar ajo pjesë përbërëse ose udhëzimet e dhëna nga prodhuesi i produktit.

(2) Përgjegjësia për dëmin e prodhuesit ulet ose prodhuesi lirohet nga përgjegjësia nëse dëshmon se, duke marrë të gjitha rrethanat në rastin, dëmi është shkaktuar vetëm për shkak të fajit të personit të dëmtuar ose personit për të cilin i dëmtuari përgjigjet, që prodhuesi nuk ka mundur t'i parashikojë dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i evitojë ose mënjanojë.

(3) Prodhuesi lirohet pjesërisht nga përgjegjësia për dëmin nëse dëshmon se, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, për dëmin e shkaktuar krahas parregullsisë së produktit kanë kontribuar që faji i të dëmtuarit ose i personit për të cilin përgjigjet i dëmtuari, që prodhuesi nuk ka mundur t'i parashikojë dhe pasojat e të cilit nuk ka mundur t'i evitojë ose mënjanojë.

(4) Kur për shkaktimin e dëmit krahas defektit të produktit ka kontribuar edhe person i tretë, i njëjti do t'i përgjigjet të dëmtuarit në mënyrë solidare me prodhuesin, ndërsa në marrëdhënien e tyre regresive zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat nga Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore për përgjegjësinë objektive për dëmin.

Ndalimi i përjashtimit kontraktual ose kufizimit të përgjegjësisë

Neni 47

(1) Përgjegjësia e prodhuesit në raport me të dëmtuarin në përputhje me këtë ligj nuk mund të përjashtohet ose të kufizohet paraprakisht në mënyrë kontraktuale.

(2) Çdo kontratë në kundërshtim me dispozitën e paragrafit (1) të këtij Neni është e pavlefshme.

Afatet për realizimin e të drejtave

Neni 48

(1) Kërkesa për kompensim të dëmit të shkaktuar nga produkti me defekt vjetërohet në afat prej tre viteve nga dita kur i dëmtuari ka mësuar ose në mënyrë të arsyeshme është dashur të mësojë për dëmin, për defektin e produktit dhe për subjektin që është prodhues.

(2) Kërkesa për kompensim të dëmit të shkaktuar nga produkt me defekt pushon me skadimin e afatit prej dhjetë viteve, llogaritur nga vendosja e tij në treg, përveç nëse para skadimit të këtij afati është ndërprerë vjetërsimi për shkak të ngritjes së procedurës para gjykatës ose organit tjetër kompetent për shkak të përcaktimit ose realizimit të kërkesës për kompensim të dëmit.

(3) Lidhur me ndërprerjen dhe për ngecjen e vjetërsisë së afateve nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse edhe dispozitat nga Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore.

Kreu 2

DETYRIME PËR INFORMIM DHE DETYRIME TË TJERA TË TREGTARËVE GJATË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE

Kapitulli 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR SHËRBIMET

Ndalimi i diskriminimit gjatë përdorimit të shërbimeve

Neni 49

(1) Konsumatori ka të drejtë të jetë përdorues i shërbimeve pavarësisht nga shtetësia e vet, si dhe vendbanimi ose vendqëndrimi i vet.

(2) Kushtet e përgjithshme për qasje deri te shërbimet që tregtari i vendos në dispozicion të opinionit më të gjerë nuk guxojnë të përfshijnë dispozita diskriminuese në raport me shtetësinë, vendbanimin ose vendqëndrimin e konsumatorit, me përjashtim të dallimeve në kushtet për qasje kur të njëjtat janë të arsyetuara drejtpërdrejt nga kriteret objektive.

Detyrim për informimin e konsumatorëve për shërbimet

Neni 50

(1) Tregtari është i detyruar t'i vendosë në dispozicion konsumatorit informacionet vijuese:

1) emri, emërtimi, respektivisht ndërmarrja, statusi juridik dhe forma e tregtarit, adresa e tij gjeografike në shtet ku është themeluar në aspektin afarist, si dhe hollësitë që mundësojnë kontakt të shpejtë dhe të drejtpërdrejt me tregtarin, duke përfshirë edhe mjetet për komunikim elektronik;

2) kur tregtari është i regjistruar në regjistër tregtar ose regjistër tjetër të rregulluar me rregulla të veçanta, regjistër në të cilin është evidentuar tregtari, si dhe numri i tij i regjistrimit ose të dhënë tjetër përkatëse për identifikim në regjistrin;

3) kur veprimtaria e tregtarit është lëndë e regjimit për lëshimin e lejeve, hollësitë për organin ose trupin përkatës mbikëqyrës;

4) kur tregtari ushtron veprimtari që është e ekspozuar ndaj vlerës së shtuar, numër të vetëm tatimor të subjektit në përputhje me Ligjin e Tatimit të Vlerës së Shtuar;

5) kur tregtari është ushtrues i profesionit të rregulluar, hollësitë për cilindo trup profesional ose subjekti tjetër përkatës të cilin është regjistruar tregtari, si dhe emri profesional dhe shteti në të cilin i është dhënë ky emërtim;

6) kushtet dhe dispozitat e përgjithshme që tregtari i përdorë, nëse ka të tilla;

7) dispozitat kontraktuale që tregtari i ka përdorur për të përcaktuar të drejtën e zbatueshme dhe/ose për të përcaktuar gjykatën kompetente, nëse ka të tilla;

8) ekzistimi i garancive tregtare pas shitjes që nuk janë vendosur me rregull, nëse ka të tilla;

9) çmimin e shërbimit, kur i njëjti është përcaktuar paraprakisht nga tregtari për llojin përkatës të shërbimit;

10) shenjat kryesore të shërbimit, nëse këto nuk janë lehtësisht të dukshme nga rrethanat e rastit;

11) kur tregtari ofron shërbim publik, kriteret për përvetësimin e statusit të konsumatorit të rrezikuar, si dhe benefitet e posaçme të dedikuara për konsumatorë të rrezikuar dhe mënyrën e realizimit të tyre dhe

12) sigurimet ose garancitë tregtare në dispozicion, e veçanërisht detajet që mundësojnë kontakt me siguruesin ose garantuesin dhe vlefshmërinë e tyre territoriale.

(2) Tregtari është i detyruar që konsumatorit t'ia sigurojë informacionet nga paragrafi (1) i këtij neni, në mënyrat vijuese:

1) tregtari ia vë në dispozicion konsumatorit informacionet sipas iniciativës personale;

2) informacionet janë lehtësisht të arritshme për konsumatorin në vendin e ushtrimit të shërbimit ose në vendin e lidhjes së kontratës;

3) konsumatori mund t'u qaset lehtësisht informacioneve në mënyrë elektronike, e përmes adresës që ia ka dhënë tregtari ose.

4) informacionet janë pjesë e materialeve informative që tregtari ia jep konsumatorit dhe që përmbajnë përshkrim të hollësishëm të shërbimeve që i njëjti i ofron.

(3) Me kërkesë të konsumatorit, tregtari është i detyruar t'i japë konsumatorit informacionet plotësuese në vijim:

1) kur çmimi i shërbimit nuk është përcaktuar paraprakisht nga tregtari për llojin përkatës të shërbimit, çmimin e shërbimit ose, kur nuk është e mundur të përcaktohet çmimi i saktë, mënyra e përlllogaritjes së tij, në atë mënyrë që i mundësohet konsumatorit ta kontrollojë ose nga ana tjetër, vlerësim të mjaftueshëm të saktë të çmimit;

2) lidhur me profesionet e rregulluara, udhëzim të rregullave të profesionit të zbatueshme në shtetin ku tregtari është themeluar në aspektin afarist, si dhe mënyrën e qasjes deri te të njëjtat;

3) informacionet për aktivitetet multidisiplinare dhe partneritetet e tregtarit që lidhen drejtpërdrejt me shërbimin konkret dhe për masat që janë ndërmarrë në mënyrë që të shmangët konflikt i interesave, me atë që këto informacione mund të jenë pjesë e materialeve informative që përmbajnë përshkrim të hollësishëm të shërbimeve që i jep tregtari;

4) çfarëdo kode të sjelljes që zbatohen te tregtari, si dhe adresën në të cilën ato janë të arritshme përmes mjeteve elektronike, e me një shenjë të gjuhës ose gjuhëve në të cilat ato janë të arritshme; dhe

5) kur ndaj tregtarit zbatohet kod i caktuar i sjelljes ose nga ana tjetër tregtari është anëtar i shoqatës së tregtarëve ose trupit profesional që mundëson zgjidhje jashtëgjyqësore të kontesteve eventuale, informacione në këtë aspekt, me atë që tregtari ka për obligim të tregojë mënyrat për qasje deri te informacionet e detajuara për shenjat dhe kushtet për përdorimin e mjeteve përkatëse për zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontesteve eventuale.

(4) Tregtari është i detyruar që informacionet nga paragrafët (1), (2) dhe (3) i këtij neni t'ia vërë në dispozicion ose t'ia njoftojë konsumatorit, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, në kohë të mjaftueshme para lidhjes së kontratës ose, kur nuk lidhet kontrata në formë të shkruar, përpara ushtrimit të shërbimit.

(5) Në kuptim të këtij ligji, konsiderohet se tregtari është i themeluar në aspektin afarist atje ku me të vërtetë ushtron aktivitetin ekonomik, e jo në kuptim të lirisë së themelimit afarist, për periudhë të papërcaktuar kohore dhe përmes infrastrukturës së qëndrueshme dhe prej ku aktiviteti afarist në fakt bëhet.

(6) Në raport me detyrimin për informim parakontraktual të konsumatorëve të kontratat për shërbime, krahas dispozitave nga paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni, zbatohen edhe dispozitat nga Ligji për shërbime që kanë të bëjnë me detyrimin për informim parakontraktual të kontratat për shërbime.

Aktivite plotësuese për sigurimin e cilësisë së shërbimeve

Neni 51

(1) Ministria e Ekonomisë ndërmerr aktivitete plotësuese për nxitjen e tregtarëve që ofrojnë shërbime dhe dhomat/shoqatat e tyre që vullnetarisht të ndërmarrin aktivitete për sigurimin e cilësisë së shërbimeve, përmes:

1) certifikimit ose vlerësimit të veprimtarive të tyre nga trupa të pavarur ose organe të akredituara në fushën përkatëse;

2) përpilimit të kartës personale për cilësi ose pjesëmarrje në kartën e cilësisë ose shënimet e përpiluara nga trupat profesional në nivel të Bashkimit Europian.

(2) Ministria e Ekonomisë u siguron tregtarëve dhe konsumatorëve informacione lehtësisht të arritshme për rëndësinë e shenjave të caktuara dhe kriteret për zbatimin e shenjave, si dhe për simbolet tjera për cilësi lidhur me shërbimet.

(3) Ministria e Ekonomisë, në bashkëpunim me Komisionin Europian, ndërmerr aktivitete plotësuese për të nxitur trupa profesionale, si dhe dhomat ekonomike, shoqatat zejtare dhe shoqatat e konsumatorëve nga Republika e Maqedonisë së Veriut, që të bashkëpunojnë në nivel të Bashkimit Europian. në mënyrë që të avancohet cilësia e sigurimit të shërbimeve veçanërisht me lehtësimin e vlerësimit të kompetencës së ndonjë tregtari.

(4) Ministria e Ekonomisë, në bashkëpunim me Komisionin Europian, ndërmerr aktivitete plotësuese për të nxitur zhvillimin e vlerësimit të pavarur, veçanërisht nga shoqatat e konsumatorëve, në raport me cilësinë dhe mangësitë e sigurimit të shërbimeve, e veçanërisht për zhvillim në nivel të Bashkimit Europian në studime krahasuese ose testime dhe njoftim të rezultateve.

(5) Ministria e Ekonomisë, në bashkëpunim me Komisionin Europian, nxitë zhvillimin e standardeve vullnetare europiane, me qëllim që të lehtësojë konformitetin e shërbimeve të siguruara nga tregtarët në vende të caktuara anëtare të Bashkimit Europian, informimin e konsumatorëve dhe cilësinë e sigurimit të shërbimeve.

Kapitulli 2

DETYRIME TË TREGTARËVE QË OFROJNË SHËRBIME PUBLIKE

Vëllimi i zbatimit të dispozitave për shërbimet publike

Neni 52

(1) Si tregtar, në kuptimin e këtij kapitulli, duhet të konsiderohen edhe kompanitë publike, si dhe të gjithë ofruesit tjerë të shërbimeve publike, duke përfshirë edhe çdo subjekt që vepron në emër dhe/ose në llogari të tregtarit.

(2) Dispozitat nga nenet 49, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65 dhe 66 të këtij ligji zbatohen në shërbimet publike pa marrë parasysh nëse të njëjtat ofrohen mbi bazë kontraktuale ose jo, përveçse kur dispozita përkatëse shprehimisht ka të bëjë me shërbimet publike të cilat jepen mbi bazë kontraktuale.

E drejta e qasjes në shërbimin public

Neni 53

(1) Tregtari është i detyruar t'u sigurojë konsumatorëve qasje në shërbimet publike që i ofron, në kushte jodiskriminuese, të njohura dhe kontraktuara dhe/ose të përcaktuara paraprakisht.

(2) Tregtari që ofron shërbime publike përmes rrjetit shpërndarës është i detyruar t'u mundësojë konsumatorëve të lidhen drejt rrjetit përkatës të shpërndarjes, shfrytëzimin e lidhjeve dhe rrjetit, si dhe ofrimin e shërbimeve në kushte jodiskriminuese, të njohura dhe kontraktuara dhe/ose të përcaktuara paraprakisht.

Detyrimi për ofrim të sigurt, të rregullt, cilësor, me kohë dhe të pandërprerë të shërbimeve publike

Neni 54

(1) Tregtari është i detyruar t'i ofrojë shërbimet publike në mënyrë të sigurt, të rregullt, cilësore, me kohë dhe pandërprerë, e në përputhje me rregullat dhe standardet e veçanta të profesionit.

(2) Autoritetet e mbikëqyrjes së tregut janë të detyruara të ushtrojnë mbikëqyrje të tregtarëve dhe të ndërmarrin veprime dhe masa të duhura për në mënyrë që këta në mënyrë të sigurt, të rregullt, cilësore, me kohë dhe të vazhdueshme t'i ushtrojnë shërbimet publike dhe t'u ofrojnë konsumatorëve qasje në shërbimet publike, duke përfshirë edhe qasjen në rrjet përkatës shpërndarës.

(3) Në rastet kur ofrimi i shërbimeve publike nuk është i sigurt, i rregullt, cilësor, me kohë dhe i pandërprerë, konsumatori ka të drejtë për kompensim të dëmit sipas Ligjit të marrëdhënieve detyrimore, pa marrë parasysh mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve të tjera juridike që i ka në dispozicion.

Lexim i pajisjeve matëse

Neni 55

Është i ndaluar çdo arkëtim i shërbimit për leximin e pajisjeve përkatëse matëse.

Njoftimi me kushtet dhe dispozitat e përgjithshme me kushtet dhe dispozitat për shfrytëzimin e shërbimeve publike

Neni 56

(1) Tregtari është i detyruar që kushtet dhe dispozitat e përgjithshme, si dhe kushtet dhe dispozitat për shfrytëzimin e shërbimeve publike t'ua vendosë në dispozicion konsumatorëve para vendosjes së marrëdhënieve konsumatore, si dhe të njëjtat t'i publikojë në faqen e vet të internetit.

(2) Për çdo ndryshim të kushteve dhe dispozitave të përgjithshme, si dhe të kushteve dhe dispozitave për shfrytëzimin e shërbimeve publik, tregtari është i detyruar që ta njoftojë publikisht konsumatorin, me letër ose në bartës tjetër të përhershëm, më së voni një muaj para fillimit të zbatimit të tyre.

(3) Ndryshimet e kushteve dhe dispozitave të përgjithshme, si dhe të kushteve dhe dispozitave për shfrytëzimin e shërbimeve publike, kur konsumatori është tashmë në marrëdhënie konsumatore, nuk janë detyruese për konsumatorin, në rregullat e veçanta.

(4) Në kushtet dhe dispozitat e përgjithshme, si dhe në kushtet dhe dispozitat për shfrytëzimin e shërbimeve publike që kanë dispozita të padrejta kontraktuale, zbatohen dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore dhe dispozitat për dispozita të padrejta kontraktuale nga ky ligj.

Çmimet për shërbimet publike

Neni 57

Çmimet për shërbimet publike, kur sipas natyrës së shërbimit publik kjo është e mundshme, tregtari është i detyruar t'i përlllogarisë sipas konsumit gjatë një periudhe të caktuar kohore, e me zbatimin e sistemin përkatës tarifor.

Detyrime të veçanta lidhur me ndryshimin e çmimeve të shërbimeve publike

Neni 58

(1) Tregtari është i detyruar të njoftojë konsumatorin për ndryshimin e çmimeve, në letër ose bartës tjetër të përhershëm, më së voni një muaj para fillimit të zbatimit të çmimeve të reja.

(2) Tregtari është i detyruar t'i njoftojë publikisht konsumatorët për ndryshimin në metodologjinë e formimit të çmimeve, me letër ose bartës tjetër të përhershëm, më së voni një muaj para fillimit të zbatimit të metodologjisë së re.

(3) Kur ndryshimi i çmimeve ose metodologjisë së formimit të çmimeve i nënshtrohet pëlqimit paraprak nga organi ose trupi kompetent shtetëror, tregtari është i detyruar t'i njoftojë publikisht konsumatorët për këto ndryshime, me letër ose bartës tjetër të përhershëm, më së voni një muaj para fillimit të zbatimit të tyre.

(4) Dispozitat nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni zbatohen vetëm në rastet kur me rregullat në fushën përkatëse është parashikuar shprehimisht se ndryshimet e çmimeve zbatohen edhe me marrëdhëniet ekzistuese konsumatore.

Llogaria për shërbimet e kryera publike

Neni 59

(1) Gjatë dorëzimit të llogarisë për shërbimet e kryera publike, tregtari është i detyruar t'i respektojë përlllogaritjen dhe çmimet e rregulluara me rregulla të veçanta.

(2) Tregtari është i detyruar t'i dorëzojë llogaritë pa vonesë dhe në afate në të cilat konsumatorit i mundësohet t'i ndjekë konsumin e realizuar dhe huamarrjen për periudhë të përlllogaritjes që nuk mund të jetë më e gjatë se 30 ditë.

(3) Përveç të dhënave të përcaktuara në nenin 32 të këtij ligji, tregtari është i detyruar t'i lëshojë dhe dorëzojë konsumatorit llogari në të cilën janë përfshirë edhe të dhënat që i mundësojnë konsumatorit:

1) të kontrollojë dhe ndjekë shumën e detyrimeve të mbërritura të papaguara në para;

2) të realizojë ekspertizë në konsumin rrjedhës, e për shkak të kontrollit të konsumin të përgjithshëm në raport me cilësinë e dhënë të shërbimit publik;

3) të përcaktojë se cilat nga shërbimet që i jep tregtari janë pa pagesë, kur kjo është përkatëse, e me shënimin se të njëjtat janë pa pagesë dhe

4) të njoftohet me të drejtën për të parashtruar kundërshtim konsumator ndaj shërbimeve publike, si dhe për mënyrat në dispozicion për të parashtruar kundërshtim konsumator ndaj shërbimeve publike në përputhje me këtë ligj.

(4) Tregtari është i detyruar t'i sigurojë dhe dorëzojë konsumatorit, pa kompensim dhe me kërkesë të tij, specifikim të hollësishëm të llogarisë.

(5) Tregtari është i detyruar t'i sigurojë dhe dorëzojë konsumatorit, pa kompensim dhe me kërkesë të tij, pasqyrë të borxheve të tij të mbërritura dhe të papaguara ndaj tregtarit, me shënim të qartë, të dukshëm dhe të lexueshëm të shumave që janë borxh në emër të kryegjësë dhe në emër të kamatës ndëshkuese ligjore, në mënyrë përkatëse, si dhe me shënim të qartë, të dukshëm dhe të lexueshëm të statusit të tyre (kontestuese, të faturuara, të paditura, respektivisht nëse për të njëjtat është dorëzuar propozim për lëshimin e fletëpagese noteriale dhe/ose kërkesë për përbarim, etj.).

(6) Është e ndaluar që tregtari të përlllogarisë dhe arkëtojë kamata ndëshkuese ligjore në rastet kur llogaria nuk i është dorëzuar konsumatorit së paku tetë ditë para mbërritjes së saj për arkëtim përveçse kur në përputhje me Ligjin e Shërbimeve Postare, llogaria i është dërguar në mënyrë të rregullt konsumatorit së paku tetë ditë kalendarike para mbërritjes së saj, me ç'rast përgjegjësia është dëshmim i tregtarit.

(7) Është e ndaluar që tregtari të përlllogarisë dhe arkëtojë kompensime plotësuese për pagesa të vonuara, përveç kamatave ndëshkuese ligjore me normë të përcaktuar me Ligjin e marrëdhënieve detyrimore.

Përmbajtja e llogarisë për shërbime publike në raport me detyrimet e mbërritura të papaguara në para dhe detyrimet tjera të tregtarit

Neni 60

(1) Ndalohet që tregtari të bëjë arkëtim për çfarëdo njoftimi ose paralajmërimi të konsumatorit për shkak të mospagesës së detyrimeve të tij të mbërritura në para.

(2) Tregtari që ofron shërbime publike është i detyruar në llogarinë e dorëzuar, ta theksojë në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme, shumën e detyrimeve të mbërritura të papaguara në para që i ka borxh konsumatori për periudhat e kaluara të përlllogaritura.

(3) Shumat nga paragrafi (2) i këtij neni që, në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore, janë të vjetëruara në momentin e përpilimit të llogarisë, tregtari i cili ofron shërbime publike është i detyruar t'i theksojë ndaras nga ato që nuk janë të vjetëruara.

(4) Ndalohet që tregtari i cili jep shërbime publike ta theksojë në llogarinë e dërguar shumën e detyrimeve të mbërritura të papaguar në para që i ka borxh konsumatori për periudhat e kaluara të përlllogaritura, e që në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore janë vjetëruar në momentin e përpilimit të llogarisë, nëse konsumatori ka dorëzuar kundërshtim për vjetërsim në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore.

(5) Tregtari që ofron shërbime publike e ka të ndaluar të fillojë procedurë përbarimi në aspektin e detyrimeve të kontestuara të mbërritura të papaguara në para që i ka borxh konsumatori, e deri në përfundimin e procedurës për zgjidhje gjyqësore ose jashtëgjyqësore të detyrimeve të kontestuara në para.

E drejta e ndërprerjes së kontratës për shërbim public

Neni 61

(1) Konsumatori është i autorizuar që ta ndërpresë kontratën për shërbime publike nëse nuk është dakord me ndryshimin e çmimeve, me ndryshimet e metodologjisë së formimit të çmimeve ose me çfarëdo ndryshimi të dispozitave të përgjithshme në kontratën, si dhe të kushteve dhe rregullave për shfrytëzimin e shërbimeve publike.

(2) Konsumatori është i autorizuar ta ndërpresë kontratën kur tregtari nuk e respekton detyrimin për ofrimin e sigurt, të rregullt, cilësor, me kohë dhe të pandërprerë të shërbimeve publike.

(3) Konsumatori është i detyruar t'ia paguajë tregtarit shërbimet publike të dhëna para ndërprerjes së kontratës, me ç'rast konsumatori mund t'i shfrytëzojë mjetet përkatëse juridike që i ka në dispozicion.

E drejta e ndërrimit të tregtarit që ofron shërbim

Neni 62

(1) Tregtari është i detyruar t'i mundësojë konsumatorit me kërkesë të tij vendosje të marrëdhënies konsumatore me tregtar tjerët që ofron shërbime publike të llojit të njëjtë, ndërsa pa pagesë të çfarëdo kompensimi ose shpenzime të tjera plotësuese.

(2) Tregtari është i detyruar që konsumatorit t'ia mundësojë hyrjen në marrëdhënie konsumatore me tregtar tjetër në afat që nuk është më i gjatë se një muaj nga dita kur konsumatori e ka njoftuar tregtarin për këtë synim të tij, përveç nëse ndryshe nuk është përcaktuar shprehimisht me rregull të veçantë.

(3) Në rastet kur marrëdhënia konsumatore është në kohë të caktuar, tregtari është i detyruar që datën e skadimit të marrëdhënies ta theksojë në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme në çdo llogari.

Dispozitat e përgjithshme për ndërprerje të ofrimit të shërbimit publik dhe/ose përjashtim nga rrjeti shpërndarës

Neni 63

(1) Tregtari është i autorizuar të ndërpresë ofrimin e shërbimit publik dhe/ose të përjashtojë konsumatorin nga rrjeti përkatës i shpërndarjes vetëm në qoftë se konsumatori nuk përmbush detyrimet e tij të mbërritura ndaj tregtarit në afat prej tre muajve nga mbërritja e detyrimit.

(2) Sidoqoftë, tregtari është i detyruar për këtë ta njoftojë paraprakisht konsumatorin, me ç'rast:

1) do ta paralajmërojë për detyrimet e tij nga marrëdhënia konsumatore dhe

2) do ta ftojë që t'i përmbushë detyrimet e tij të mbetura në afat që nuk mund të jetë më i shkurtër se një muaj nga dorëzimi i njoftimit.

(3) Gjatë njoftimit nga paragrafi (2) i këtij neni, tregtari duhet të marrë parasysh afatin kohor nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Kur konsumatori do t'i përmbush detyrimet e tij të mbërritura, tregtari është i detyruar pa kompensim ta lidhë ose të fillojë dhe të vazhdojë të ushtrojë shërbime publike në afat prej dy ditëve pas pagesës së kryer.

(5) Ndalohet që tregtari të kushtëzojë bashkimin ose fillimin dhe vazhdimin e ushtrimit të shërbimeve publike me pagesën e kërkesave të vjetëruara që i ka ndaj konsumatorit.

(6) Ndalohet që tregtari të ndërpresë ofrimin e shërbimit publik dhe/ose të përjashtojë konsumatorin nga rrjeti përkatës i shpërndarjes në rastet e furnizimit me ujë, energji elektrike, ngrohje qendrore ose gaz për nevojat e ngrohjes gjatë sezonit të ngrohjes, kur në amvisërinë jeton konsumator i rrezikuar.

Dispozita të veçanta për ndërprerjen e shërbimit publik dhe/ose përjashtim nga rrjeti i shpërndarjes

Neni 64

(1) Në raste kur është nisur procedurë gjyqësore ose jashtëgjyqësore për llogari të kontestuar, me ç'rast konsumatori në mënyrë të rregullt i përmbushë detyrimet nga llogaritë e radhës të pakontestuar, është e ndaluar që tregtari ta ndërpresë dhënieën e shërbimit publik dhe/ose të përjashtojë konsumatorin nga rrjeti përkatës i shpërndarjes deri në përfundimin e procedurës përkatëse gjyqësore ose jashtëgjyqësore, përveçse në rastet kur konsumatori e ka ndërprerë kontratën me tregtarin që ofron shërbim publik.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, kur tregtari ka ndërprerë ofrimin e shërbimit publik dhe/ose ka përjashtuar konsumatorin nga rrjeti përkatës i shpërndarjes para se të jetë i njoftuar për nisjen e procedurës përkatëse gjyqësore ose jashtëgjyqësore, është i detyruar, pa kompensim dhe në afat prej dy ditëve, ta lidhë ose të fillojë dhe të vazhdojë t'i ushtrojë shërbimet publike deri në përfundim të procedurës përkatëse gjyqësore ose jashtëgjyqësore, përveçse në rastet kur konsumatori e ka ndërprerë kontratën me tregtarin që ofron shërbim publik.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni zbatohen edhe në rastet kur tregtari ka nisur procedurën e përmbarrimit kundër konsumatorit.

Dispozitat e veçanta për konsumatorët e rrezikuar si shfrytëzues të shërbimit publik

Neni 65

Kriteret për përvetësimin e statusit të konsumatorit të rrezikuar si shfrytëzues i shërbimit publik, llojet e benefiteve të veçanta të dedikuara për konsumatorët e rrezikuar dhe mënyrat për realizimin e tyre në aspektin e përcaktimit të çmimeve, informimit, këshillimit dhe ndihmës në zgjidhjen e kundërshtimeve të konsumatorëve dhe kontesteve i përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mënyra të veçanta për kontakt me tregtarin

Neni 66

Tregtarët që ofrojnë shërbime publike janë të detyruar t'u sigurojnë konsumatorëve në çdo rast ekzistencën dhe funksionimin e papenguar të linjës telefonike sipas tarifës bazë të thirrjes, e për shkak të mundësisimit që konsumatorët të parashtrajnë pyetje, të kërkojnë ndihmë, të denoncojnë problem, ndërprerje, bllokim apo mungesë, si dhe të shprehin ankesën e tyre.

Kreu 3

PRAKTIKA TË PADREJTA TREGTARE

Kapitulli 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Ndalimi i praktikës së padrejtë tregtare

Neni 67

Në marrëdhëniet konsumatore të tregtarëve, si dhe të çdo subjekti që vepron në emër dhe/ose në llogari të tregtarit, u ndalohet praktika e padrejtë tregtare.

Vëllimi i zbatimit të dispozitave të praktikës së padrejtë tregtare

Neni 68

(1) Është i ndaluar zbatimi i praktikës së padrejtë tregtare nga neni 69 i këtij ligji edhe atëpara, gjatë dhe pas marrëdhënies konsumatore në lidhje me të gjitha produktet.

(2) Si produkt, në kuptimin e dispozitave për praktikë të padrejtë tregtare, konsiderohen mallrat dhe shërbimet, duke përfshirë edhe pasuritë e patundshme, shërbimet digjitale dhe përmbajtjet digjitale, si dhe të drejtat dhe detyrimet.

(3) Në raport me praktikën e padrejtë tregtare, përveç dispozitave të këtij Ligji, zbatohen edhe:

1) dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore, e veçanërisht dispozitat për vlefshmërinë e plotë, lidhja dhe veprimi ndaj kontratave;

2) rregullat që kanë të bëjnë me kërkesat shëndetësore dhe të sigurisë për mallrat;

3) rregullat me të cilat rregullohen cilatdo kushte për themelim afarist, procedurat për lëshimin e lejeve, si dhe zbatimi i kodeve morale të sjelljes ose rregullat tjera të veçanta për rregullimin e profesioneve qëllimi i të cilave është mirëmbajtja e standardeve të larta të ndërgjegjes të profesionalizmit të personave në këto profesione;

4) rregullat që kanë të bëjnë me lëshimin e certifikatave dhe shënimin e standardeve të pastërtisë së objekteve të bëra prej metaleve të çmuara dhe

5) rregullat me të cilat rregullohet kompetenca e gjykatave.

(4) Dispozitat nga nenet 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76 dhe 77 të këtij ligji, nuk zbatohen nëse çështje të veçanta të ndërlidhura me praktikën e padrejta tregtare janë rregulluar ndryshe me rregulla të veçanta.

(5) Dispozitat nga ky ligj nuk mund të paraqesin bazën për kufizimin e lirisë për lëshimin e shërbimeve as për kufizimin e lirisë së qarkullimit të mallrave.

Praktika të padrejta tregtare

Neni 69

(1) Konsiderohet se një praktikë e caktuar tregtare është e padrejtë, nëse:

1) bie ndesh me kërkesat e vëmendjes së duhur profesionale dhe

2) materialisht i çrregullon ose me siguri do t'i prishë interesin ekonomik dhe sjelljen e konsumatorit mesatar në raport me produktin deri te i cili vjen ose të cilit i është dedikuar ose anëtarit mesatar të grupit, e kur praktika tregtare është e orientuar drejt një grupi të caktuar të konsumatorëve.

(2) Praktika tregtare për të cilën është e sigurt se do t'i prishë në aspektin material interesin ekonomik dhe sjelljen vetëm të grupit të përkufizuar qartë të konsumatorëve, të cilët janë veçanërisht të rrezikuar në aspektin e praktikës ose të produktit të prekur për shkak të pafuqisë së tyre mentale ose fizike, moshës ose naivitetit në mënyrë të parashikueshme nga tregtari, vlerësohen nga perspektiva e anëtarit mesatar të atij grupi, me ç'rast kjo nuk ka të bëjë me reklamimin e zakonshëm dhe ligjor në të cilin jepen deklaratat të tepruara ose deklaratat që thjeshtë nuk duhet të interpretohen.

Raste të veçanta të praktikës së padrejtë tregtare

Neni 70

Si praktika të veçanta të padrejta tregtare, në përputhje me këtë ligj, konsiderohen rastet e praktikave mashtruese, respektivisht praktika agresive tregtare.

Praktikat tregtare që gjithmonë konsiderohen të padrejta si praktika mashtruese tregtare

Neni 71

(1) Në të gjitha rrethanat e një rasti individual dhe sipas rregullës, si praktika të padrejta tregtare konsiderohen praktikat vijuese mashtruese tregtare:

- 1) tregtari pohon se është nënshkruar i kodit të caktuar të sjelljes, edhe pse nuk është ashtu;
- 2) tregtari aplikon ose shënon një markë kolektive, të certifikuar ose tjetër të përshtatshme tregtare, përkatësisht një shenjë tjetër të përshtatshme dalluese që tregon besim, cilësi ose të ngjashme, pa marrë autorizimin e nevojshëm për këtë;
- 3) tregtari pohon se kodi i sjelljes ka konfirmim, mbështetje ose leje nga trup publik ose organ tjetër, edhe pse nuk është ashtu;
- 4) tregtari pretendon se ai dhe/ose praktikantët e tij tregtare/ose mallrat janë aprovuar, rekomanduar ose certifikuar nga një trup publik ose tjetër, edhe pse nuk është kështu ose ndonjë pohimi i tillë është bërë pa plotësuar kushtet e kërkuara për aprovimin, rekomandimin ose konfirmimin;
- 5) tregtari bën thirrje për të blerë produkte për çmim të caktuar pa zbuluar ekzistencën e çfarëdo baze të arsyeshme që mund ta ketë tregtari, për atë se nuk do të jetë në gjendje të ofrojë për furnizim ose të blejë nga një tregtar tjetër për furnizim produktet në fjalë ose produkte të tjera përkatëse me këtë çmim, e për periudhë kohore dhe në sasi që janë arsyeshme duke marrë parasysh vetë mallrat, vëllimin e reklamimit të mallrave dhe çmimin e ofruar ("shpallje me tërheqje");
- 6) tregtari bën thirrje për blerje të produkteve për çmim të caktuar dhe më pas refuzon t'ia tregojë konsumatorit mallin e reklamuar ose nga ana tjetër refuzon të marrë porosi për mallin ose të njëjtun ta realizojë në kuadër të afatit të arsyeshëm ose nga ana tjetër tregon mostër të mallit me defekt ose gabim, e në të gjitha këto raste me qëllim të promovimit të mallrave të tjera ("tërheqje dhe zëvendësim");
- 7) tregtari bën deklaratë të rreme se malli do të jetë në dispozicion vetëm për periudhë shumë të kufizuar kohore ose se malli për periudhë shumë të kufizuar kohore do të jetë në dispozicion vetëm në kushte të caktuara, e me qëllim që të nxirret vendim i drejtpërdrejt dhe konsumatori të privohet nga mundësia e mjaftueshme ose koha e mjaftueshme për të marrë vendim të informuar;
- 8) tregtari merr përsipër shërbimet pas shitjes në raport me konsumatorët me të cilët ka komunikuar para se të lidhet marrëdhënia konsumatore në një gjuhë që nuk është zyrtare në territorin e shtetit ku ky është themeluar në aspektin afarist, e më pas shërbimet e njëjta i bën të arritshme për konsumatorët vetëm në një gjuhë tjetër pa ia bërë të ditur qartë me këtë rast konsumatorit përpara se ky i fundit të bëhet i detyruar në marrëdhënien konsumatore;
- 9) tregtari deklaron ose krijon përshtypjen ndryshe se malli mund të shitet në përputhje me rregullat në fuqi, edhe pse nuk është ashtu;
- 10) tregtari përfaqëson të drejtat e konsumatorëve të përcaktuara me rregull si shenjë e veçantë e ofertës së tij;
- 11) tregtari përdor përmbajtje redaktuese në mediat për të promovuar mallin, e kur tregtari ka paguar për promovimin pa e përmendur këtë qartë në përmbajtjen ose përmes mënyrë vizuale ose zanore, kështu që konsumatori këtë mund ta shohë qartë ("shpallje redaktuese"), pa prekur me këtë rast dispozitat e Ligjit të Shërbimeve audio dhe audiovizuale mediatike;
- 12) tregtari siguron rezultate nga kërkimi si përgjigje të kërkimi onlajn nga konsumatori, pa bërë të ditur qartë çfarëdo shpallje ose pagesë të paguar në mënyrë që të arrihet renditje më e lartë e mallrave në kuadër të rezultateve nga kërkimi;
- 13) tregtari bën pohime të rëndësishme të pasakta për natyrën dhe vëllimin e rrezikut për sigurinë personale të konsumatorit ose familjes së tij nëse konsumatori nuk e blen mallin;

14) tregtari bën promocionin e mallit që është i ngjashëm me mallin e prodhuar nga një prodhues tjetër i caktuar në atë mënyrë që joshet qëllimisht konsumatori që të besojë se malli është bërë nga prodhuesi i njëjtë, edhe pse nuk është ashtu;

15) tregtari themelon, udhëheq ose promovon skemë piramidale të promocionit ku konsumatori bën investim për mundësinë e përfitimit të kompensimit kryesisht për shkak të përfshirjes së konsumatorëve tjerë në skemën në vend se për shkak të shitjes ose përdorimit të mallrave;

16) tregtari pohon se planifikon të ndërpresë punën ose të zhvendosë objektin e tij afarist, edhe pse nuk është ashtu;

17) tregtari pohon se mallrat janë të tilla që e lehtësojnë fitimin në lojërat e fatit;

18) tregtari pohon rrejtshëm se malli mund të shërojë sëmundje, funksione të çrregulluara ose deformime;

19) tregtari jep ose përcjell informacione të rëndësishme të pasakta për kushtet e tregut ose arritshmërinë e mallit me qëllim që të shtyjë konsumatorin ta blejë mallin në kushte më pak të favorshme sesa kushtet e zakonshme të tregut;

20) tregtari në kuadër të praktikave tregtare pohon se reklamohet lojë shpërblyese ose promocion shpërblyes pa ndarë shpërblimet e përshkruara ose ekuivalentin e arsyeshëm të tyre;

21) tregtari e përshkruan mallin si "gratis", "falas", "pa kompensim" ose ngjashëm, e kur konsumatori duhet të paguajë çfarëdo shume ose kompensim që është ndryshe nga shpenzimi që nuk mund të shmanget në mënyrë që t'i përgjigjet praktikës tregtare dhe në mënyrë që ta marrë ose paguajë për dërgimin e sendit;

22) tregtari përfshin në materialin propagandistik llogari, faturë ose dokument të ngjashëm me të cilin kërkohet pagesë dhe konsumatorit i krijohet përshtypja se ai e ka porositur tashmë mallin, edhe pse nuk është ashtu;

23) tregtari pohon rrejtshëm ose krijon përshtypjen se nuk vepron për qëllime të veprimtarisë së tij tregtare, afariste, zejtare ose profesionale ose nga ana tjetër prezanton rrejtshëm vetveten si konsumator;

24) tregtari krijon përshtypje të rrejtshme se shërbimi pas shitjes në lidhje me mallin është i arritshëm në shtetin e ndryshëm nga ai ku shitet malli;

25) tregtari u rishet konsumatorëve bileta për ngjarje që i ka marrë me mjete të automatizuara në mënyrë që të anashkalojë kufizimin e numrit të biletave që një person mund t'i blejë ose dispozitat tjera që zbatohen për blerjen e biletave;

26) tregtari bën të ditur se shikimet dhe vlerësimet në rrjetet sociale për produktin i parashtrajnë konsumatorët që në fakt e kanë përdorur apo blerë produktin pa ndërmarrë masa të arsyeshme dhe përkatëse për të kontrolluar nëse shikimet dhe vlerësimet e tilla rrjedhin nga konsumatorët e tillë dhe

27) tregtari ose personi juridik ose fizik i autorizuar prej tij poston shikime, vlerësime ose rekomandime të rrejtshme të konsumatorëve në rrjetet sociale, ose i paraqet ato në mënyrë të rrejtshme në mënyrë që të promovojë mallrat.

Praktikat tregtare që gjithmonë konsiderohen të padrejta si praktika agresive tregtare

Neni 72

Në të gjitha rrethanat e rastit individual dhe sipas rregullës, si të padrejta do të konsiderohen praktikat vijuese agresive tregtare:

1) tregtari krijon përshtypjen se konsumatori nuk mund të braktisë hapësirat derisa të lidhet kontrata;

2) tregtari bën vizita personale në shtëpinë e konsumatorit duke mos marrë parasysh kërkesën e tij që ta braktisë shtëpinë e tij ose të mos e vizitojë më, përveçse në rrethanat dhe në masën që janë të arsyeshme, sipas rregullave të vlefshme, për zbatimin e obligimit kontraktual;

3) tregtari bën oferta të vazhdueshme dhe të pakërkuara me telefon, me faks, me postë elektronike ose me mjete të tjera komunikimi në distancë, përveçse në rrethanat dhe në masën që ato janë të arsyeshme, sipas rregullave të vlefshme, për zbatimin e obligimit kontraktual, pa prekur me këtë rast dispozitat për kontratat e lidhura në distancë, dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale dhe rregullat për mbrojtjen e privatësisë në komunikimet elektronike;

4) tregtari kërkon nga konsumatori që dëshiron të parashtojë kërkesë në bazë të policës së sigurimit të sigurojë dokumente që nuk mund të konsiderohen relevante për të vlerësuar nëse kërkesa është e bazuar apo nga ana tjetër nuk i përgjigjet sistematikisht korrespondencës së vazhdueshme të konsumatorit me qëllim që ta pengojë nga realizimi i të drejtave të tij kontraktuale;

5) tregtari gjatë reklamimit përfshin joshjen e drejtpërdrejtë të fëmijëve që të blejnë mallin e reklamuar ose që ata t'i bindin prindërit ose të rriturit e tjerë që t'i blejnë mallrat e reklamuar për ta, pa prekur me këtë rast dispozitat e Ligjit të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuale Mediatike;

6) tregtari kërkon pagesë të menjëhershme ose të prolonguar të mallit, si dhe kthimin ose ruajtjen e mallrave të furnizuara nga tregtari pa kërkesë të konsumatorit, përveçse kur bëhet fjalë për mall të zëvendësuar në kuptim të dispozitave të kontratave të lidhura në distancë. ("shitje inerte");

7) tregtari e informon shprehimisht konsumatorin se, nëse ai nuk e blen mallin, do të rrezikohet puna ose mbijetesa e tregtarit; dhe

8) tregtari krijon pasqyrë të rrejshme se konsumatori tashmë ka fituar, se do të fitojë ose se duke ndërmarrë veprim të caktuar do të fitojë shpërblim ose përfitim tjetër përkatës, edhe pse nuk ka shpërblim ose përfitim tjetër përkatës ose nga ana tjetër nëse ndërmarrja e veprimit të caktuar në lidhje me marrjen e shpërblimit ose përfitimi tjetër përkatës është kushtëzuar me pagesë ose shpenzime të tjera për konsumatorin.

Kapitulli 2

PRAKTIKAT MASHTRUESE TREGTARE

Rastet e praktikave mashtruese tregtare

Neni 73

Praktika mashtruese tregtare konsiderohen veprimet, në kuptimin e veprimeve dhe lëshimeve aktive, në kuptimin e veprimeve pasive.

Veprimet mashtruese

Neni 74

(1) Praktika tregtare konsiderohet si mashtruese nëse përmban informacion të rrejshëm dhe për shkak të kësaj është e pavërtetë ose nëse në çfarëdo mënyre, duke përfshirë përshtypjen e përgjithshme që ajo lë, mashtron ose ka gjasa që të mashtojë konsumatorin mesatar, madje edhe kur informacionet faktikisht janë të sakta, në lidhje me një ose më shumë nga rrethanat nga paragrafi (2) i këtij neni, e në cilindo nga rastet shkakton ose ka gjasa të shkaktojë që konsumatori mesatar të miratojë vendim të tregut, të cilin përndryshe nuk do ta kishte marrë.

(2) Si rrethana me të cilat ka të bëjë praktika mashtruese tregtare, në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni, konsiderohen:

1) ekzistenca ose natyra e produktit;

2) karakteristikat kryesore të produktit, siç janë arritshmëria, dobia, rreziqet, realizimi, përbërja, pajisja plotësuese, ndihma pas shitjes dhe veprimi ndaj kundërshtimeve dhe ankesave, mënyra dhe data e prodhimit ose sigurimit, dërgimit, përshtatshmëria e dedikimit, shfrytëzimi, sasia, specifikimi, origjina gjeografike ose tregtare ose rezultatet e pritura nga përdorimi i tij, ose nga ana tjetër rezultatet e testeve ose kontroleve të zbatuara;

3) vëllimi e detyrimeve të tregtarit, motivet e praktikës tregtare dhe natyra e procesit të shitjes, çdo deklaratë ose simbol që ka të bëjë me sponsorizimin ose aprovimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të tregtarit ose produktit;

4) çmimi ose mënyra se si është llogaritur çmimi ose ekzistimi i përfitimeve të caktuara në aspektin e çmimit;

5) nevoja për servisim, pjesë, zëvendësim ose riparim;

6) natyra, veçoritë ose të drejtat e tregtarit ose përfaqësuesit të tij, siç janë identiteti ose prona e tyre, kualifikimet, statusi, aprovimet e dhëna, posedimi i të drejtave të pronësisë industriale, ekonomike ose intelektuale, çmimet ose mirënjohjet që u janë dhënë; dhe

7) të drejtat e konsumatorit, duke përfshirë të drejtën e zëvendësimit ose kthimit të parave dhe dispozitat për konformitetin e mallrave dhe garancitë tregtare nga ky ligj, si dhe rreziqet me të cilat mund të përballlet konsumatori.

(3) Praktika tregtare konsiderohet të jetë mashtruese edhe nëse, në gjendjen e saj faktike, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe specifikën e rastit, e shtyn ose ndoshta mund ta shtyjë konsumatorin mesatar të marrë vendim tregu që ai nuk do ta kishte marrë në rast tjetër, e që ka të bëjë me:

1) çdo vendosje të mallrave në treg, duke përfshirë reklamimin krahasues, që shpie drejt konfuzionit me produkte të tjera, marka tregtare, emra tregtarë ose shenja të tjera për dallimin e konkurrentit;

2) mospërbushja e detyrimeve që tregtari ka marrë sipas kodeve të sjelljes për të cilat është zotuar, kur detyrimi nuk është fakultativ, por është i fortë dhe mund të kontrollohet dhe tregtari në praktikë e tij tregtare tregon se është i detyruar me kodin e sjelljes.

3) çfarëdo vendosje e mallit në treg për të cilin pohohet se është identik me mallin bë vend anët të Bashkimi Europian, e që ka përbërje ose karakteristika dukshëm të ndryshme, përveç nëse ky dallim nuk është i arsyeshëm me faktorë të rregullave dhe objektivë.

Lëshim mashtrues

Neni 75

(1) Një praktikë e caktuar tregtare konsiderohet mashtruese nëse në gjendjen e dhënë faktike, duke marrë parasysh të gjitha shenjat dhe rrethanat e saj dhe kufizimet e medias për njoftim, anashkalon shumë informacione të rëndësishëm që i nevojiten konsumatorit mesatar në mënyrë që në rrethanat e dhëna të marrë vendim të informuar të tregut dhe në këtë mënyrë konsumatorin mesatar e shtyn ose ka gjasa që ta shtynë të marrë vendim tregu që përndryshe nuk do ta kishte marrë.

(2) Konsiderohet se bëhet fjalë për lëshim mashtrues edhe kur, duke marrë parasysh kërkesat nga paragrafi (1) i këtij neni, tregtari i fsheh ose në mënyrë të paqartë, të pakuptueshme, të paqartë ose jo me kohë i jep të dhënat e rëndësishme nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe kur anashkalon të identifikojë qëllimin tregtar për praktikën e dhënë tregtare, ndërsa e njëjta siç duket nuk rezulton nga rrethanat e rastit, me ç'rast në dy rastet konsumatorin mesatar e shtyn ose ka gjasa ta shtyjë të marrë vendim tregu që përndryshe nuk do ta kishte marrë.

(3) Kur media e shfrytëzuar për njoftimin e praktikës tregtare nënkupton kufizime hapësinore ose kohore, gjatë vlerësimit nëse informacioni është anashkaluar do të merren parasysh këto kufizime dhe çfarëdo masash që janë ndërmarrë nga tregtari për ta bërë informacionin të kapshëm për konsumatorët me ndihmën e mjeteve të tjera.

(4) Në rast të thirrjes për blerje, si të rëndësishme do të konsiderohen informacionet vijuese, me kusht që në mënyrë evidente të mos rezultojnë nga rrethanat e rastit:

1) shenjat kryesore të mallrave, në vëllim përkatës të medias dhe të mallit;

2) adresa gjeografike dhe identiteti i tregtarit, siç është emri ose emërtimi i tij tregtar dhe, kur është e përshtatshme, adresa gjeografike dhe identiteti i tregtarit në emrin e të cilit ky vepron;

3) çmimi me tatimet e përfshira ose kur natyra e mallit është e tillë që çmimi nuk mund të përlloraritet paraprakisht, mënyra në të cilën përlloraritet çmimi, si dhe kur është e përshtatshme, të gjitha shpenzimet plotësuese për transport, dorëzimin ose postën ose, kur këto shpenzime nuk mund të përllorariten në mënyrë të arsyeshme paraprakisht, fakti që shpenzimet e këtilla plotësuese do të duhet të paguhen;

4) metdhomat e pagesës, dërgimit dhe punës të mallrave, nëse ato devijojnë nga kërkesat në drejtim të vëmendjes profesionale;

5) për mallrat dhe punët juridike ku ekziston e drejta e tërheqjes ose heqjes dorë, ekzistimi i së drejtës së këtillë dhe

6) për mallra që ofrohen në hapësirën e shitjes onlajn, vallë personi i tretë që e ofron mallin është tregtar ose jo, në bazë të deklaratës që personi i tretë ia jep organizatorit të hapësirës për shitje onlajn.

(5) Kur konsumatorëve u sigurohet mundësia për kërkimin e produkteve të ofruara nga tregtarë të ndryshëm ose nga konsumatorë në bazë të kërkesës në formë të fjalës kyçe, frazës ose shënim tjetër, pa marrë parasysh se ku përfundimisht lidhet kontrata, të rëndësishme konsiderohen informacionet e përgjithshme, të cilat janë të arritshme në pjesën specifike të interfejsit onlajn, e që drejtpërdrejt dhe lehtë është i arritshëm nga faqja ku janë prezantuar rezultatet nga kërkimi, për parametratë kryesore që përcaktojnë renditjen e mallrave të prezantuara te konsumatori si rezultat i kërkimit dhe rëndësisë relevante të atyre parametrave, për dallim nga parametrat tjera.

(6) Dispozitat nga paragrafi (5) i këtij neni nuk do të zbatohen te ofruesit e veglave për kërkime në internet.

(7) Ofrues i veglave për kërkime në internet në kuptimin e paragrafit (6) të këtij neni do të thotë një person fizik ose juridik, i cili mundëson ose zotohet të mundësojë vegla për kërkim në internet të konsumatorëve.

(8) Gjatë përcaktimit të ekzistimit të lëshimit mashtrues, merren parasysh:

1) kërkesat për informim të përcaktuara në nenet 120 dhe 121 i këtij ligji në aspektin e informimit parakontraktual, nenin 122 të këtij ligji në aspektin e detyrimit ndaj informacioneve parakontraktual, nenin 123 të këtij ligji në aspektin e gjuhës së informacioneve parakontraktual, nenin 124 të këtij ligji në aspektin e barrës së dëshmimit, nenin 125 të këtij neni në aspektin e kërkesave formale për kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit dhe nenin 126 të këtij ligji në aspektin e kërkesave formale për kontratat në distancë;

2) dispozitat nga Ligji për veprimtari turistike për paket-aranzhimet dhe aranzhimet udhëtuese;

3) dispozitat nga Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore për kontratat për përdorim me afat të paluajtshmërisë, për produkt afatgjatë për pushim, për rishitje dhe për shkëmbim;

4) dispozitat për shënimin e çmimeve të mallrave që u ofrohen konsumatorëve, nga Ligji për ilaçet dhe mjetet ndihmëse mjekësore dhe Ligjin e Tregtisë Elektronike;

5) dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve në kontratat për kredi konsumatore dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji

6) rregullat për tregtim në distancë me shërbimet financiare të dedikuara për konsumatorët, me rregullat për ekspozimet e përbashkëta në letrat e transmetueshme me vlerë, me rregullat për ndërmjetësim në sigurimin, me rregullat për sigurimin dhe risigurimin, me rregullat për tregjet dhe instrumentet financiare dhe me rregullat për prospektet që publikohen gjatë ofertës publike të letrave me vlerë ose gjatë pranimit të tyre në tregtim.

(9) Kur tregtari siguron qasje deri te vlerësimet dhe mallrat e dhëna nga konsumatorët në rrjetet sociale, kryesisht konsiderohet informacioni i dhënë nga tregtari që të sigurohet se vlerësimet e publikuara rrjedhin nga konsumatorë që me të vërtetë e kanë blerë mallin.

Kapitulli 3 PRAKTIKË AGRESIVE TREGTARE

Kur konsiderohet agresive praktika tregtare

Neni 76

Një praktikë e caktuar tregtare konsiderohet se është agresive nëse në gjendjen e dhënë faktike, duke marrë parasysh të gjitha shenjat dhe rrethanat e saj, përmes shqetësimit, detyrimit, duke përfshirë edhe përdorimin e forcës fizike ose ndikimit të tepruar, i rregullon në masë të konsiderueshme ose ka gjasa që t'i prishë lirinë e përzgjedhjes së konsumatorit mesatar ose veprimin e tij lidhur me mallin dhe në këtë mënyrë konsumatorin mesatar e shtynë ose ka gjasa ta shtynë të marrë vendim të tregut që përndryshe nuk do ta kishte marrë.

Kur ka shqetësim, detyrim ose ndikim të tepruar

Neni 77

Gjatë përcaktimit nëse gjatë praktikës përdoret shqetësim, detyrim, duke përfshirë edhe përdorimin e forcës fizike ose ndikimi i tepruar, do të merren parasysh:

- 1) koha e tij e zhvillimit, lokaliteti, natyra ose qëndrueshmëria;
- 2) përdorimi i gjuhës ose sjelljes kërcënuese ose ofenduese;
- 3) shfrytëzimi nga tregtari i një aksidenti të veçantë ose të rrethanave pesha e të cilave e prishë fuqinë e rezonimit të konsumatorit, ndërsa tregtari ka ditur për këtë, që të ndikojë në vendimin e konsumatorit lidhur me mallin;
- 4) çfarëdo pengesa të rënda dhe të pabarabarta jashtëkontraktuale të vendosura nga tregtari në rastin kur konsumatori dëshiron t'i realizojë të drejtat e veta kontraktuale, duke përfshirë të drejtat e ndërprerjes së kontratës ose të transferimit të mallit tjetër ose te tregtar tjetër dhe
- 5) çdo kërcënim për ndërmarrjen e veprimeve në kundërshtim me ligjin.

Kapitulli 4 TË DREJTAT E KONSUMATORËVE NË RAST TË PRAKTIKAVE TË PADREJTA TREGTARE

E drejta e kompensimit të dëmit, ulja e çmimit dhe ndërprerja e kontratës

Neni 78

(1) Konsumatorët, të drejtat e të cilëve shkelen me përdorimin e praktikave të padrejta tregtare nga tregtari kanë të drejtë për kompensim të dëmit që e kanë pësuar.

(2) Konsumatorët, të drejtat e të cilëve janë shkelur në praktika të padrejta tregtare nga tregtari kanë të drejtë gjithashtu për ulje proporcionale të çmimit dhe ndërprerje të kontratës.

(3) Gjatë vendimmarrjes për të drejtat nga paragrafet (1) dhe (2) të këtij neni, organet për mbikëqyrjen e tregut do t'i marrin parasysh peshën dhe natyrën e praktikës së padrejtë tregtare, vëllimin e dëmit që e ka pësuar konsumatori dhe rrethanat tjera relevante të rastit.

(4) Të drejtat e konsumatorit në rast të praktikave të padrejta tregtare sipas paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni nuk prekin të drejtat e tjera të konsumatorëve të përcaktuara nga ky ligj ose me rregulla të tjera.

Pjesa 3
KONTRATAT KONSUMATORE

Kapitulli 1
DISPOZITA TË PËRBASHKËTA PËR KONTRATAT KONSUMATORE

Kapitulli 1
DISPOZITA TË PADREJTA KONTRAKTUALE

Pjesa 1
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR DISPOZITA TË PADREJTA KONTRAKTUALE

Ndalim për shfrytëzimin e dispozitave të padrejta kontraktuale

Neni 79

Është e ndaluar që tregtarët të përdorin dispozita të padrejta kontraktuale në marrëdhëniet konsumatore.

Dispozitat e padrejta kontraktuale

Neni 80

(1) Dispozitë e padrejtë kontraktuale konsiderohet dispozita kontraktuale, me të cilën në kundërshtim me parimin e ndërgjegjes dhe ndershmërisë, krijon një shpërpjestim të dukshëm midis të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të palëve, e në dëm të konsumatorit.

(2) Dispozitat për dispozita të padrejta kontraktuale të këtij ligji zbatohen pa marrë parasysh nëse për dispozitën e caktuar kontraktuale është biseduar ose jo, si dhe pavarësisht nga ajo nëse bëhet fjalë për kushte të përgjithshme të kontratës të miratuara ose aprovuara nga organ ose trup kompetent.

(3) Konsiderohet se për dispozitë të caktuar kontraktuale është biseduar individualisht nëse ajo dispozitë është përpiluar paraprakisht dhe konsumatori nuk ka pasur ndikim në përmbajtjen e saj, e veçanërisht nëse bëhet fjalë për dispozita që janë të përfshira në kontrata formulare ose tipike (standarde) të tregtarit ose në kushtet e tij të përgjithshme të kontratës.

(4) Nëse vlerësimi i përgjithshëm i kontratës bën të ditur se e njëjta është kontrata formulare ose tipike (standarde) ose bëhet fjalë për kushte të përgjithshme të kontratës, fakti se për çështje të caktuara të ndërlidhura me dispozitë të caktuar kontraktuale ose se është biseduar për dispozitë të caktuar kontraktuale individualisht nuk përjashton mundësinë që ndonjë nga dispozitat tjera kontraktuale të jetë e padrejtë.

(5) Nëse tregtari pohon se disa çështje të caktuara që kanë të bëjnë me dispozitë të caktuar kontraktuale ose për dispozitë të caktuar kontraktuale të përfshirë në kontrata formulare ose tipike (standarde) ose sipas kushteve të përgjithshme të kontratës janë biseduar individualisht, ai është i detyruar ta dëshmojë këtë.

Vëllimi i zbatimit

Neni 81

(1) Dispozitat e këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me dispozitat e padrejta nuk zbatohen në kontratat kontraktuale që në kontratën janë përfshirë si pasojë e përmbajtjes së rregullave të detyrueshme, respektivisht të kontratave përkatëse ndërnacionale dhe kontratave të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, veçanërisht në fushën e së drejtës së transportit.

(2) Në marrëdhëniet konsumatore me element ndërnacional, dispozitat e këtij neni që kanë të bëjnë me dispozitat e padrejta kontraktuale zbatohen pa marrë parasysh rregullat për përcaktimin e së drejtës së vlefshme, si dispozita me zbatim të drejtpërdrejt, e kur kontrata është lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Vlerësim nëse dispozita kontraktuale është e padrejtë

Neni 82

(1) Gjatë vlerësimit nëse dispozita kontraktuale është e padrejtë merren parasysh natyra e mallrave ose shërbimeve me të cilat ka të bëjë kontrata si dhe, sipas kohës së lidhjes së kontratës, të gjitha rrethanat gjatë lidhjes së kontratës dhe të gjitha dispozitat tjera të kontratës ose kontrata tjetër në raport me të cilin kjo është dytësore.

(2) Vlerësimi nëse dispozita kontraktuale është e padrejtë ka të bëjë edhe me elementet e rëndësishme të kontratës, si dhe me përshtatshmërinë e çmimit dhe kompensimeve të tjera në raport me mallrat dhe shërbimet që furnizohen si kundër kompensimit, madje edhe kur këto dispozita kontraktuale janë të shprehura në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe pa mëdyshje.

Transparenca e dispozitave kontraktuale

Neni 83

Kur janë shkruar të gjitha ose vetëm disa nga dispozitat kontraktuale që i vihen në dispozicion konsumatorit, të njëjtat duhet të jenë të shprehura në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe pa mëdyshje.

Interpretimi i dispozitave kontraktuale

Neni 84

(1) Në rast dyshimi rreth kuptimit të dispozitës kontraktuale, e njëjta interpretohet në favor të konsumatorit.

(2) Gjatë interpretimit veçanërisht merret parasysh pozita e konsumatorit si palë më e dobët ekonomikisht në marrëdhëniet konsumatore, veçanërisht kur bëhet fjalë për konsumatorët e rrezikuar.

3) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni nuk zbatohet në rastet kur organet e mbikëqyrjes së tregut ose shoqatat që kanë interes të arsyeshëm juridik për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit ndërmarrin veprime para gjykatave ose organeve ose trupave të tjera kompetente për vlerësimin e asaj nëse dispozitat që janë përfshirë në kontratën formulare ose tipike (standarde) ose në kushtet e përgjithshme të kontratës janë të padrejta, respektivisht për ndalimin e shfrytëzimit të tyre.

Pasoja juridike në rast të dispozitës së padrejtë kontraktuale

Neni 85

(1) Dispozita e padrejtë kontraktuale është e pavlefshme.

(2) Organet e mbikëqyrjes së tregut janë të detyruara sipas detyrës zyrtare të ndalojnë shfrytëzimin e dispozitës së padrejtë kontraktuale nga tregtarët gjatë ushtrimit të punëve në kompetencë të tyre në përputhje me ligjin.

(3) Pavlefshmëria e një dispozite të caktuar të padrejtë nuk tërheqë pavlefshmëri edhe të vetë kontratës, nëse ajo mund të mbijetojë pa dispozitën e pavlefshme dhe nëse ajo nuk ka qenë kusht i kontratës as nxitje vendimtare për shkak të cilës është lidhur kontrata.

(4) Kontrata do të mbetet në fuqi madje edhe nëse dispozita e padrejta kontraktuale që është e pavlefshme ka qenë kusht apo nxitje vendimtare e kontratës, e në rastet kur pavlefshmëria është konstatuar pikërisht në mënyrën që kontrata të lirohet nga ajo dispozitë dhe të vlejë pa të.

Dispozitat kontraktuale që në përgjithësi konsiderohen të padrejta

Neni 86

(1) Si të padrejta, qoftë në raport me objektin e tyre apo në raport me veprimin e tyre, konsiderohen në veçanti dispozitat vijuese kontraktuale:

1) dispozita kontraktuale me të cilën përjashtohet ose kufizohet përgjegjësia e tregtarit për dëmin e shkaktuar me vdekje ose lëndim të trupit të konsumatorit, e si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tregtarit;

2) dispozita kontraktuale me të cilën përjashtohen ose kufizohen në mënyrë joadekuate të drejtat e konsumatorit në rast të mospërbushjes së plotë ose të pjesshme, respektivisht plotësimi të ngathët ose të vonuar të detyrimeve kontraktuale të tregtarit, si në raport me tregtarin, ashtu edhe në raport me person të tretë, duke përfshirë edhe të drejtën e tejkalimit të kërkesës së konsumatorit ndaj tregtari me atë që tregtari e ka ndaj tij;

3) dispozita kontraktuale me të cilën detyrimet e tregtarit në aspektin e furnizimit të mallrave ose shërbimeve është e lidhur me kushtin përmbushja e të cilit varet vetëm nga vullneti i tij, derisa konsumatori është i detyruar në mënyrë të pakushtëzuar me kontratën, respektivisht dispozitat e tij;

4) dispozita kontraktuale me të cilën për tregtarin parashikohet e drejta për të mbajtur shumat që konsumatori ia ka paguar në rast se konsumatori do të vendosë të mos lidhë ose të përmbushë kontratën, pa parashikuar njëherësh të drejtën që konsumatori të kërkojë pagesën e një shume ekuivalente nga tregtari në rast se tregtari ndërpreu kontratën;

5) dispozita kontraktuale me të cilën parashikohet obligim për konsumatorin për t'i paguar tregtarit kompensim që është në disproporcion të dukshëm ndaj detyrimeve të tregtarit, e kur konsumatori nuk do të përmbushë detyrimet e tij;

6) dispozita kontraktuale me të cilën për tregtarin parashikohet e drejta që të ndërpresë kontratën sipas gjetjes së tij të lirë kur e drejta e njëjtë nuk është parashikuar për konsumatorin, si dhe dispozita kontraktuale me të cilën për tregtarin parashikohet e drejta që të ruajë shumat që konsumatori ia ka paguar ndonëse tregtari nuk i ka kryer detyrimet e tij ndaj konsumatorit në rast se tregtari e ndërpreu kontratën;

7) dispozita kontraktuale me të cilën për tregtarin parashikohet e drejta që të ndërpresë kontratën e lidhur në kohë të pacaktuar pa lënien e afatit përkatës të pushimit për konsumatorin, përveçse në rastet kur konsumatori ka shkelur dukshëm kontratën me ç'rast tregtari është i detyruar t'i japë konsumatorit njoftim se do të pushohet;

8) dispozita kontraktuale me të cilën parashikohet vazhdimi i heshtur në kohë të pacaktuar në afatin e vlefshmërisë së kontratës së lidhur në kohë të caktuar në rast se konsumatori nuk jep njoftim të shprehur joadekuat, e në rastin kur afati i parashikuar që konsumatori ta japë njoftimin përkatës për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së kontratës është parashikuar në mënyrë të paarsyeshme herët para skadimit të afatit të vlefshmërisë së kontratës;

9) dispozita kontraktuale me të cilën konsumatori detyrohet në mënyrë të pakushtëzuar për kushtet me të cilat nuk ka pasur mundësi të vërtetë që të njihet para lidhjes së kontratës;

10) dispozita kontraktuale me të cilën parashikohet e drejta e tregtarit të ndryshojë në mënyrë të njëanshme dispozitat dhe kushtet e kontratës, pa parashikuar në kontrata me këtë rast një arsye të justifikuar për këtë ndryshim;

11) dispozita kontraktuale me të cilën parashikohet e drejta e tregtarit të ndryshojë në mënyrë të njëanshme cilëndo nga shenjat dhe karakteristikat e mallit ose shërbimit, pa parashikuar në kontrata me këtë rast një arsye të justifikuar për këtë ndryshim;

12) dispozita kontraktuale me të cilën parashikohet e drejta e tregtarit të përcaktojë çmimin e mallrave ose shërbimeve në kohën e realizimit ose zbatimit të tyre, si dhe dispozita kontraktuale me të cilën parashikohet e drejta e tregtarit të rrisë çmimin e mallrave ose shërbimeve, pa parashikuar me këtë rast të drejtën e konsumatorit për të ndërprerë kontratën nëse çmimi përfundimtar është tepër i lartë në raport me çmimin e përcaktuar gjatë lidhjes së kontratës;

13) dispozita kontraktuale me të cilin për parashikohet e drejta e tregtarit të përcaktojë nëse mallrat ose shërbimet janë proporcionale me kontratën, si dhe dispozita kontraktuale me të cilin për parashikohet e drejta ekskluzive e tregtarit për të bërë interpretimin e cilëndo dispozite kontraktuale;

14) dispozita kontraktuale me të cilin për parashikohet e drejta e tregtarit të respektojë detyrimet e marra përsipër nga përfaqësuesit ose agjentët e tij, si dhe dispozita kontraktuale me të cilin për parashikohet e drejta e tregtarit të respektojë detyrimet e marra përsipër nga përfaqësuesit ose agjentët e tij kushtësohet me përmbushjen e ndonjë formaliteti të veçantë;

15) dispozita kontraktuale me të cilën parashikohet që konsumatori të përmbushë të gjitha detyrimet e tij pa i përmbushur tregtarin ato të tij;

16) dispozita kontraktuale me të cilin për parashikohet e drejta e tregtarit të transferojë detyrimet e tij dhe/ose të tërheqë të drejtat e tij nga kontrata, pa pëlqimin e shprehur të konsumatorit, e ku kjo do të çonte në reduktim të detyrimeve ndaj konsumatorit në bazë të përmbushjes ose garancisë tregtare dhe

17) dispozita kontraktuale me të cilin përjashtohet dhe/ose vështirësohet e drejta e konsumatorit që të marrë përsipër një veprim të caktuar juridik ose të përdorë çfarëdo mjeti juridik, e në veçanti dispozitën kontraktuale me të cilën konsumatori detyrohet kontestin eventual ta zgjidhë në procedurë arbitrimi që nuk rregulluar me rregulla të veçanta, dispozitë kontraktuale me të cilën në mënyrë të pabazë kufizohen mjetet dëshmuese që i ka në dispozicion konsumatori, si dhe dispozita kontraktuale me të cilën parashikohet që barra e dëshmimit që sipas rregullave të vlefshme bie në palën tjetër i transferohet konsumatorit.

(2) Dispozitat kontraktuale nga paragrafi (1) i këtij neni konsiderohen të padrejta pa nevojën që çdo rast individual të vlerësohet nëse për të njëjtat është biseduar individualisht dhe nëse me të njëjtat, në kundërshtim me parimin e ndërgjegjes dhe ndershmërisë, krijohet disproporcion evident mes të drejtave kontraktuale dhe detyrimeve të palëve, e në dëm të konsumatorit.

(3) Me dispozitat nga paragrafi (1) pika 7) e këtij neni nuk përjashtohet ekzistimi i dispozitës me të cilën parashikohet e drejta e tregtarit të shërbimeve financiare ta ndërpresë në mënyrë të njëanshme kontratën e lidhur në kohë të pacaktuar pa lënien e afatit të pushimit të konsumatorit, në rastet kur për këtë ekziston arsye e justifikueshme, me ç'rast tregtari është e detyruar t'i japë konsumatorit njoftimin se është i pushuar.

(4) Me dispozitat nga paragrafi (1) pika 10) e këtij neni nuk përjashtohet ekzistimi i dispozitës me të cilën parashikohet e drejta e tregtarit të shërbimeve financiare ta ndryshojë normat e kamatave që i ka borxh ose ia kanë borxh konsumatorit, si dhe shumat dhe të dhënat tjera për shërbime financiare, pa njoftim përkatës të konsumatorit, e kur për këtë ekziston arsye e justifikueshme, me ç'rast tregtari është e detyruar t'i japë konsumatorit njoftimin për këtë sa më herët që mundet, por vetëm nëse për konsumatorin është parashikuar e drejta që ta ndërpresë kontratën pa lënien e afatit të pushimit.

(5) Me dispozitat nga paragrafi (1) pika 10) e këtij neni nuk përjashtohet ekzistimi i dispozitës kontraktuale me të cilën parashikohet e drejta e tregtarit të shërbimeve financiare t'i ndryshojë dispozitat dhe kushtet e kontratës të lidhur në kohë të pacaktuar, me ç'rast tregtari është e detyruar t'i japë konsumatorit njoftim të arsyeshëm për këtë, por vetëm nëse për konsumatorin është parashikuar e drejta që ta ndërpresë kontratën.

(6) Me dispozitat nga paragrafi (1) pika 12) e këtij neni nuk përjashtojnë ekzistimi i dispozitës kontraktuale me të cilën parashikohet klauzolë për shkallë rrëshqitëse, kur e njëjta është e lejuar dhe nëse metoda e ndryshimeve të çmimit është përshkruar në mënyrë të prerë.

(7) Dispozitat nga paragrafi (1) pikat 7), 10) dhe 12) e këtij neni nuk zbatohen në kontratat konsumatore me të cilat ushtrohet treg i letrave të transferueshme me vlerë, instrumente financiare dhe produktet ose shërbime tjera ku çmimi lidhet me lëvizjet në bursë ose indekse ose normave në treg financiar mbi të cilat tregtari nuk ka ndikim, si dhe kontratat për shitjen ose blerjen e valutës së huaj, çeqet e udhëtimit ose remitencat ndërnacionale të shprehura në valuta të huaja.

Kapitulli 2

KONTRATA PËR SHITJE DHE KONTRATA PËR SHËRBIME

Pjesa 1

DISPOZITAT E PËRBASHKËTA PËR KONTRATAT PËR SHITJE DHE KONTRATAT PËR SHËRBIME

Vëllimi i zbatimit

Neni 87

(1) Dispozitat e këtij neni dhe të neneve 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji zbatohen si të përgjithshme për kontratat për shitje dhe kontratat për shërbime të lidhura mes konsumatorit dhe tregtarit ku konsumatori paguan ose detyrohet të paguajë çmimin.

(2) Dispozitat e këtij neni dhe të neneve 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij Ligji zbatohen edhe në kontratat për furnizimin me ujë, gaz, energji elektrike ose ngrohje qendrore, duke përfshirë edhe rastet kur ato furnizohen nga ofruesit e shërbimeve publike, e kur të njëjtat furnizohen me bazë kontraktuale.

(3) Dispozitat e këtij neni dhe të neneve 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji zbatohen edhe në kontratat ku tregtari furnizon ose detyrohet të furnizojë përmbajtje digjitale që nuk është në bartës të përhershëm ose shërbim digjital për konsumatorin, ndërsa konsumatori siguron ose detyrohet të sigurojë të dhëna personale për tregtarin, përveç nëse të dhënat personale të siguruar nga konsumatori janë të përpunuara vetëm nga tregtari për shkak të furnizimit të përmbajtjes digjitale që nuk është bartës i përhershëm ose shërbim digjital në përputhje me këtë ligj ose t'i mundësojnë tregtarit t'i përmbushë detyrimet e tij dhe tregtari nuk i përpunon ato të dhëna personale për çfarëdo qëllimi tjetër.

(4) Në rast të mospërputhjes së dispozitave të këtij neni dhe neneve 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji me rregulla të tjera të veçanta me të cilat rregullohen sektorë të veçantë, përparësi në zbatimin kanë rregullat e veçantë që rregullojnë sektorët e veçantë.

(5) Me dispozitat e këtij neni dhe neneve 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji nuk preket në zbatimin e dispozitave të përgjithshme të së drejtës kontraktuale, e veçanërisht dispozitat për vlefshmërinë, lidhjen dhe veprimin e kontratave, në vëllimin në të cilin këto dispozita nuk janë të përcaktuara me këtë ligj.

(6) Me dispozitat e këtij neni dhe neneve 88, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji nuk preket në mundësinë që tregtarët t'u ofrojnë konsumatorëve vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale që nënkuptojnë nivel më të lartë të mbrojtjes sesa ajo që rezulton nga këto dispozita.

(7) Dispozitat nga paragrafet (2), (3), (4), (5) dhe (6) e këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në raport me vëllimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me kontratat në distancë dhe kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit.

Përfshirje

Neni 88

(1) Dispozitat e këtij neni dhe të neneve 87, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji për kontratat për shitje dhe për kontratat për shërbime nuk zbatohen në kontratat:

1) për shërbimet sociale, duke përfshirë ato të strehimit social, kujdesit për fëmijët dhe mbështetjen për familjet dhe personat që kanë nevojë të përhershme ose të përkohshme për kujdes, duke përfshirë edhe kujdesin afatgjatë;

2) për shërbimet e mbrojtjes shëndetësore, në kuptim të Ligjit të Mbrojtjes së të Drejtave të Pacientëve, pa marrë parasysh nëse të njëjtat i ofrojnë ose jo institucionet shëndetësore;

3) vënia e basteve me vlerë në para gjatë lojërave të fatit, duke përfshirë lotarinë, lojërat e kazinosë dhe gjërat e basteve;

(4) për shërbimet financiare;

5) për krijimin, përvetësimin ose transferimin e pasurive të patundshme ose të drejtave mbi pasuritë e patundshme;

6) për ndërtimin e ndërtimit të ri, për ridedikimin e konsiderueshëm të ndërtimeve ose për dhënie me qira të nevojave për strehim;

7) për paket-aranzhimet turistike dhe aranzhimet e ndërlidhura për udhëtim në përputhje me Ligjin e Veprimtarisë Turistike, përveç nëse është përcaktuar ndryshe nga dispozitat e këtij neni dhe neneve 87, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji;

8) për përdorim me afat të paluajtshmërisë, për produkt afatgjatë për pushim, për rishitje dhe për shkëmbim;

9) të cilat, në përputhje me dispozitat nga rregullat e veçanta, janë të përbëra nga organet e administratës shtetërore ose trupat publik që kanë obligim në përputhje me rregullat të jenë të pavarur dhe të paanshëm dhe të cillt janë të detyruar të sigurojnë, duke dhënë me këtë rast informacione gjithëpërfshirëse juridike, se konsumatori do të lidhë kontrata vetëm pasi që do t'i mendojë me kujdes aspektet juridike të tij dhe vëllimin e zbatimit;

10) për furnizimin e ushqimit, pijeve dhe mallrave të tjera të dedikuara për konsumin rrjedhës në amvisëri, që tregtari shpesh dhe rregullisht ia dërgon konsumatorit në shtëpinë, banesën ose vendin e tij të punës.

11) për shërbimet e transportit të udhëtarëve në përputhje me rregullat në fushën e transportit të udhëtarëve, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe nga dispozitat e këtij neni dhe të neneve 87, 89, 90, 91, 92, 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji;

12) të lidhura përmes automateve shitëse ose objekteve të automatizuara tregtare;

13) të lidhura me operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nëpërmjet foltoreve publike për përdorimin e tyre ose të lidhura me përdorimin e vetëm një lidhjeje të vetme që konsumatori e vendos përmes telefonit, internetit ose pajisje të faksit

14) për mallrat e shitura në procedurat e përmbarimit ose ndryshe në përputhje me autorizimin e përcaktuar me ligj.

(2) Përfshirjet nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse me kontratat në distancë dhe kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit.

Pjesa 2

DETYRIM PËR INFORMIM PARAKONTRAKTUAL

Neni 89

(1) Para se konsumatori të bëhet i detyruar me çfarëdo kontrata për shitje ose kontrata për shërbime, respektivisht me cilëndo ofertë përkatëse, përveç nëse këto informacione siç duket nuk rezultojnë nga rrethanat e rastit, tregtari është i detyruar që në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme t'ia japë konsumatorit informacionet vijuese:

1) shenjat kryesore të mallrave ose shërbimeve, në vëllimin përkatës të mediave dhe të vetë mallrave dhe shërbimeve;

2) identitetin e tregtarit, siç janë emri dhe emërtimi i tij tregtar, adresa gjeografike ku është themeluar në aspektin afarist dhe numër telefoni;

3) çmimin e përgjithshëm të mallrave ose shërbimeve, duke përfshirë të gjitha tatimet, e kur natyra e mallrave ose shërbimeve është e tillë që çmimi nuk mund të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme paraprakisht, mënyra e përlllogaritjes së çmimit, si dhe, kur është e zbatueshme, të gjitha kompensimet plotësuese për transport, dërgim ose postë ose, kur këto kompensime nuk mund të përcaktohen në mënyrë të arsyeshme paraprakisht, fakti që këto kompensime do të mund të jentë të arkëtuara;

4) aty ku është e zbatueshme, mënyrat e pagesës, dërgimit dhe përmbushjes, koha në të cilën tregtari detyrohet t'i dërgojë mallrat ose t'i ofrojë shërbimet, si dhe politika për veprim ndaj kundërshtimeve ose ankesave;

5) aty ku është e zbatueshme krahas konfirmimit të ekzistimit të përgjegjësisë për disproporcion të mallrave ose shërbimeve, përmbajtjeve digjitale ose shërbimeve digjitale në kuptimin e rregullave të zbatueshme, ekzistimin dhe kushtet e ushtrimit të shërbimeve pas shitjes dhe garancitë tregtare;

6) aty ku është e zbatueshme, afati i vlefshmërisë së kontratës, e nëse kontrata është në kohë të pacaktuar ose nga ana tjetër i nënshtrohet vazhdimit automatik, atëherë kushtet për ndërprerjen e kontratës;

7) aty ku është e zbatueshme, funksionaliteti i mallrave me elemente digjitale, përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale, duke përfshirë edhe masat e zbatueshme për mbrojtje teknike të tij dhe

8) aty ku është e zbatueshme, çfarëdo interoperabiliteti relevant i mallrave me elemente digjitale, përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale, e kur tregtari për këtë ka ditur ose në mënyrë të arsyeshme pritet se është dashur të di për këtë.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen edhe në kontratat për furnizim me ujë, gaz ose energji elektrike edhe kur këto nuk ofrohen për shitje në vëllim ose sasi të pacaktuar saktësisht, si në kontratat për furnizim të ngrohjes qendrore ose përmbajtjes digjitale që nuk furnizohet në bartës të përhershëm.

(3) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni do të zbatohen në kontratat për shitje dhe kontratat për shërbime që nuk lidhen si kontrata në distancë ose si kontrata jashtë hapasirave afariste të tregtarit.

Pjesa 3

TË DREJTAT TJERA TË KONSUMATORIT

Kompensime për shfrytëzimin e mjeteve për pagesë

Neni 90

(1) Tregtarëve u është e ndaluar t'u arkëtojnë konsumatorëve kompensime për shfrytëzimin e mjeteve të caktuara për arkëtim që e tejkalojnë shpenzimin që tregtari është i detyruar ta parashtrijë për shfrytëzimin e këtyre mjeteve.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet në mënyrë përkatëse edhe në kontratat për paket-aranzhimet turistike dhe për aranzhime të ndërlidhura për udhëtim.

Tarifat e komunikimit telefonik

Neni 91

(1) Kur një tregtar shfrytëzon linjë telefonike për qëllim të komunikimit me konsumatorin në raport me kontratën e lidhur, konsumatori që ka kontaktuar tregtarin nuk është i detyruar të paguajë më shumë se tarifa themelore e thirrjes.

(2) Me dispozitën e paragrafit (1) të këtij neni nuk preket e drejta e operatorëve të rrjeteve publik të komunikimeve elektronike të arkëtojnë për thirrjet e tilla.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në kontratat e paket-aranzhimeve turistike dhe për aranzhimet e ndërlidhura për udhëtim.

Pëlqimi për pagesa plotësuese

Neni 92

(1) Para se konsumatori të bëhet i detyruar me çfarëdo kontrata ose me çfarëdo oferte, tregtari është i detyruar t'i kërkojë konsumatorit pëlqimin e drejtpërdrejtë për çdo pagesë që është plotësuese në raport me kompensimin e kontraktuar për detyrimin kryesor kontraktual të tregtarit.

(2) Nëse tregtari nuk ka siguruar pëlqimin e drejtpërdrejtë të konsumatorit, por për të njëjtin ka nxjerr konkluzion në bazë të opsioneve standarde që konsumatori është i detyruar t'i refuzojë me qëllim që të shmangë pagesën shtesë, konsumatori ka të drejtën e kthimit të kësaj pagese.

(3) Dispozitat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në kontratat e paket-aranzhimeve turistike dhe aranzhimet e ndërlidhura për udhëtarë.

Shitje Inerte

Neni 93

(1) Secila shitje interte nga tregtari, si praktikë e padrejtë tregtare në përputhje me nenin 72 pika 6) e këtij ligji, është e ndaluar me ligj dhe konsumatori nuk është i detyruar për çfarëdo kompensimi në rastet e dërgesave të pakërkuara të mallrave, ujit, gazit, energjisë elektrike, ngrohjes qendrore ose përmbajtjes digjitale, si dhe në rastet e ushtrimeve të pakërkuara të shërbimeve.

(2) Mungesa e përgjigjes nga konsumatori nuk mund të konsiderohet si pëlqim i tij i dërgesave të pakërkuara ose ushtrimi i shërbimeve.

(3) Secila shitje që bie ndesh me qëndrimet (1) dhe (2) të këtij neni konsiderohet e pavlefshme.

Kapitulli 3

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR KONTRATËN PËR SHITJE

Pjesa 1

VËLLIMI I ZBATIMIT

Dispozita të përgjithshme

Neni 94

(1) Dispozitat e këtij neni dhe neneve 95 dhe 96 të këtij ligji zbatohen vetëm në kontratat për shitje.

(2) Dispozitat e këtij neni dhe neneve 95 dhe 96 të këtij neni nuk zbatohen në kontratat për furnizim me ujë, gaz ose energji elektrike, kur këto ofrohen për shitje në vëllim ose sasi të përcaktuar saktësisht, si dhe në kontratat për furnizimin e ngrohjes qendrore ose përmbatjes digjitale që nuk furnizohet me bartës të përhershëm.

Dërgimi

Neni 95

(1) Përveç nëse palët nuk janë marrë vesh ndryshe në aspektin e kohës së dërgimit, tregtari është i detyruar t'i dërgojë mallrat përmes transmetimit të zotërimit ose kontrollit fizik të mallrave te konsumatori, pa prolongim, e në çdo rast jo më vonë se 30 ditë nga lidhja e kontratës.

(2) Kur tregtari nuk e ka respektuar detyrimin për dërgimin e mallrave në kohën e dakorduar me konsumatorin ose në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, konsumatori është i autorizuar t'i bëjë thirrje tregtarit që të bëjë dërgimin dhe për këtë t'i jep afat plotësues që është përkatës me rrethanat e rastit me ç'rast, nëse tregtari nuk e bën dërgimin në këtë afat, konsumatori ka të drejtë ta ndërpresë kontratën.

(3) Konsumatori nuk është patjetër t'i jep tregtarit afat plotësues për dërgim që është përkatës me rrethanat e rastit në rastet kur tregtari ka refuzuar ta bëjë dërgimin, kur dërgesa në kohën e kontraktuar është me rëndësi thelbësore duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat gjatë lidhjes së kontratës, si dhe kur konsumatori para lidhjes së kontratës e ka informuar tregtarin se dërgimi deri ose në datë të caktuar është me rëndësi thelbësore.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) të këtij neni, kur tregtari nuk ka përmbushur detyrimin për të dërguar mallrat në kohën e dakorduar me konsumatorin ose brenda afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën menjëherë.

(5) Pas ndërprerjes së kontratës, tregtari është i detyruar t'ia kthejë konsumatorit të gjitha shumatat që ky ia ka paguar në bazë të kontratës.

Transferimi i rrezikut

Neni 96

(1) Kur në përputhje me kontratën tregtari është i detyruar t'ia dërgojë mallrat konsumatorit, rreziku për dështim të rastësishëm ose dëmtim të mallrave kalon te konsumatori kur ai ose ndonjë subjekt tjetër i përcaktuar nga ai, me përjashtim të transportuesit, do të përvetësojë zotërimin fizik mbi mallrat.

(2) Në rastet kur konsumatori ia ka besuar transportin e mallrave një transportuesi të caktuar, ndërsa tregtari nuk e ka ofruar përzgjedhjen e transportuesit, rreziku për dështimin e rastësishëm ose dëmtimin e mallrave kalon te konsumatori kur mallrat janë dërguar te transportuesi.

(3) Me dispozitat nga paragrafi (2) i këtij neni nuk përjashtohet e drejta e konsumatorit në raport me transportuesin.

Pjesa 2

KONFORMITETI I MALLRAVE

Dispozitat e përgjithshme

Neni 97

(1) Tregtari është i detyruar që konsumatorit t'i dorëzojë mall konsumator që i përmbush kërkesat subjektive dhe objektiv për konformitet me kontratën të përcaktuara në nenet 99 dhe 100 të këtij ligji, nëse është e zbatueshme, kështu që nuk do të jetë në kundërshtim me kërkesat për të drejtat e personave të tretë të mallrave konsumatore të përcaktuara në nenin 101 të këtij ligji.

(2) Tregtari i përgjigjet konsumatorit për çdo mospërputhje të mallit që ka ekzistuar në momentin e dorëzimit të tij te konsumatori, pa marrë parasysh nëse tregtari ka ditur për këtë, respektivisht ka ligj për përgjegjësi për konformitet të mallit.

(3) Tregtari i përgjigjet konsumatorit edhe për çdo mospërputhje të mallit të konsumit me kontratën e shitjes që do të shfaqet pas dorëzimit të tij tek konsumatori, nëse i njëjti është pasojë e shkakut që ka ekzistuar para dorëzimit.

(4) Pa prekur në detyrimet që rezultojnë nga neni 100 paragrafi (2) i këtij Ligji, dispozitat nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni zbatohen edhe në mallra me elemente digjitale.

Vëllimi i zbatimit të dispozitave të konformitetit të mallrave konsumatore

Neni 98

(1) Si mall konsumator, në kuptim të dispozitave të këtij neni dhe neneve 97, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108 dhe 109 të këtij Ligji, konsiderohet:

a) çdo send i prekshëm i lëvizshëm, me përjashtim të mallrave që shiten në procedurë përbarimi ose ndryshe sipas autorizimit të përcaktuar me ligj, të ujit dhe gazit që nuk janë të paketuara për shitje në një vëllim ose sasi të saktë, si dhe të energjisë elektrike dhe

b) çdo send i prekshëm i lëvizshëm në të cilin është instaluar ose me të cilin është ndërlidhur një përmbajtje digjitale se shërbim digjital në atë mënyrë që nëse nuk ka përmbajtje digjitale ose shërbim digjital malli nuk do t'i ushtrojë funksionet e tij, me ç'rast përjashtim janë bartësit e përhershëm që shërbejnë vetëm si bartë të përmbajtjes digjitale.

(2) Kontratat për furnizimin e mallit konsumator që duhet të përpunohet ose prodhohet konsiderohen si kontrata për shitje në kuptimin e dispozitave të këtij neni dhe neneve 97, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108 dhe 109 të këtij ligji.

(3) Nëse nuk është dakorduar ndryshe, dispozitat e këtij neni dhe neneve 97, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108 dhe 109 të këtij ligji nuk zbatohen te mallrat e përdorura (tashmë të shfrytëzuara) që shiten në ankande publike ku konsumatorët e kanë mundësinë e pranisë personale dhe në shitjen e kafshëve të gjalla.

(4) Në rast të zbatimit të përjashtimit nga paragrafi (3) i këtij neni në shitjen e mallrave të përdorura (tashmë të shfrytëzuara) që shiten në ankandet publike dhe në shitjen e kafshëve të gjalla, konsumatorët duhet të informohen për këtë në mënyrë të qartë, gjithëpërfshirëse dhe lehtësisht të arritshme.

(5) Dispozitat e këtij neni dhe neneve 97, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108 dhe 109 të këtij ligji nuk zbatohen në kontrata për furnizimin e përmbajtjeve digjitale ose shërbimeve digjitale, përveç nëse përmbajtjet digjitale ose shërbimet digjitale që janë instaluar ose lidhur mes vete me mall konsumator në kuptimin e paragrafit (1) të këtij neni janë furnizuar me mall konsumator në përputhje me kontratën për shitje, pa marrë parasysh atë nëse përmbajtja e tillë digjitale ose shërbimi digjital është furnizuar nga tregtari ose nga ndonjë person i tretë.

(6) Në rast të dyshimit nëse furnizimi me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital që është instaluar ose ndërlidhur me mallin konsumator paraqet pjesë të kontratës për shitje, supozohet se përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital është pjesë e kontratës për shitje.

(7) Dispozitat e këtij neni dhe neneve 97, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108 dhe 109 të këtij ligji për konformitet të mallrave zbatohen në përgjegjësinë për pasiguri të produkteve të rregulluara me rregullat për siguri të produkteve, si dhe as në përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga produkti me defekt të rregulluar me dispozitat e këtij ligji.

Kërkesa subjektive për konformitet të mallrave konsumatore me kontratën

Neni 99

Supozohet se mallrat konsumatore janë në konformitet me kontratën, ku është e zbatueshme, kur:

- 1) janë me përshkrim, sasi, cilësi dhe posedojnë funksionalitet, kompatibilitet, interoperabilitet dhe karakteristika të tjera, siç janë parashikuar me kontratën;
- 2) janë të përshtatshme për dedikimin e veçantë për të cilin konsumatori i furnizon ato, për çka tregtari e ka ditur në momentin e lidhjes së kontratës dhe të njëjtën e ka pranuar;
- 3) janë të dërguara me të gjitha shtesat, udhëzimet, duke përfshirë instalimin dhe mbështetjen e përdoruesit, siç parashikohet në kontrata dhe
- 4) azhurnohen dhe plotësohen siç është parashikuar me kontratën.

Kërkesat objektive për konformitet të mallrave konsumatore me kontratën

Neni 100

(1) Krahas përmbushjes së të gjitha kërkesave subjektive për konformitet nga neni 99 i këtij ligji, në mënyrë që të konsiderohet se ato përputhen me kontratën, mallrat konsumatore duhet patjetër:

1) atje ku është e zbatueshme, të jenë të përshtatshme për qëllimin për të cilin mallrat e të njëjtit lloj zakonisht përdoren në përputhje me rregullat e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Bashkimit Europian, standardet teknike ose, në mungesë të standardeve të tilla teknike, kodet e sjelljes në sektorin përkatës;

2) atje ku është e zbatueshme, të kenë cilësinë dhe të përputhen me përshkrimin e mostrës ose modelit që tregtari ia ka vënë në dispozicion konsumatorit para lidhjes së kontratës;

3) atje ku është e zbatueshme, të dorëzohet së bashku me shtesat, duke përfshirë edhe paketimin, udhëzimet e instalimit ose udhëzime të tjera, ashtu siç konsumatori mund të presë në mënyrë të arsyeshme ta marrë dhe

4) të jenë me sasi dhe ta tregojnë cilësinë dhe karakteristikat tjera, duke përfshirë edhe në raport me qëndrueshmërinë, funksionalitetin, kompatibilitetin dhe sigurinë që janë të zakonshme për mallrat e llojit të njëjtë që konsumatori mund t'i presë në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh natyrën e mallrave dhe duke marrë parasysh çfarëdo deklarata publike për veçoritë e veçanta të mallrave të dhëna nga tregtari ose në emër të tij ose nga persona të tjerë në fazat paraprake të zinxhirit të njëjtë të kontratave, duke përfshirë edhe prodhuesin, veçanërisht gjatë reklamimit ose gjatë shënimit.

(2) Në rastet e shitjes së mallit me elemente digjitale, shitësi është i zotuar të informojë konsumatorin për azhurnimet dhe ta furnizojë me azhurnime, duke përfshirë edhe azhurnimet e sigurisë, siç janë të nevojshme që ai mall ta ruaj përputhshmërinë, për periudhën kohore:

1) kur konsumatori mund të presë në mënyrë të arsyeshme duke marrë parasysh llojin dhe dedikimin e mallit dhe elementeve digjitale dhe duke marrë parasysh rrethanat dhe natyrën e kontratës, ku kontrata për shitje parashikon furnizim të njëhershëm me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital ose

2) siç është përcaktuar në nenin 107 paragrafi (3) i këtij ligji dhe nëse është e zbatueshme, kur kontrata për shitje parashikon furnizim të vazhdueshëm me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital për periudhë të caktuar kohore.

(3) Nëse konsumatori, në afat të arsyeshëm, nuk i instalon azhurnimet e siguruar nga tregtari në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, tregtari nuk do të jetë përgjegjës për mospërputhjen që rezulton vetëm nga lëshimi i instalimit të azhurnimit përkatës, me kusht:

1) tregtari të ketë informuar konsumatorin në lidhje me arritshmërinë e azhurnimit dhe pasojat e lëshimit të instalimit të azhurnimit dhe

2) knsumatori të mos ketë instaluar azhurnimin ose instalimin joadekuat të azhurnimit nga konsumatori të mos jetë rezultat i mangësive në udhëzimet për instalimin të dhëna nga tregtari.

(4) Si moskonformitetet do të konsiderohet edhe cilado mospërputhje që është si pasojë e montimit të parregullt të mallrave konsumatore, nëse montimi është pjesë e kontratës për shitje të mallrave dhe nëse mallrat janë montuar nga tregtari ose nën mbikëqyrjen e tij, si dhe kur mallrat i ka montuar vetë konsumatori, ndërsa montimi i parregullt është pasojë e mangësive në udhëzimet për montim të dhëna nga tregtari.

(5) Nuk do të konsiderohet se mallrat konsumatore nuk janë në konformitet me kontratën, në kuptimin e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni nëse, në kohën e lidhjes së kontratës, konsumatori ka qenë veçanërisht i informuar se karakteristika të caktuara të mallit devijojnë nga kërkesat objektive për përputhshmëri dhe konsumatori shprehimisht është pajtuar me atë devijim gjatë lidhjes së kontratës.

(6) Tregtari është i detyruar me deklaratat publike nga paragrafi (1) pika 4) e këtij neni nëse dëshkohet se nuk ka ditur dhe nuk ka mundur të dijë në mënyrë të arsyeshme për deklaratat përkatëse, ose nëse dëshmon se deri në kohën e lidhjes së kontratës, deklarata publike ka qenë e korrigjuar në mënyrë të njëjtë ose në mënyrën që është e krahasueshme me atë në të cilën është dhënë: ose nëse dëshmon se deklarata nuk ka mund të ndikojë në vendimin e konsumatorit për ta blerë mallin.

Të drejtat e palëve të treta ndaj mallrave konsumatore

Neni 101

Nëse shfrytëzimi i mallit konsumatorë në përputhje me nenet 98, 99 dhe 100 të këtij ligji është pamundësuar ose kufizuar për shkak të shkeljes së cilësdo të drejte të personit të tretë, veçanërisht të drejtat e pronësisë intelektuale, konsumatori ka të drejtë në rast të konformitetit së mallit konsumator të parashikuar në nenet 102, 103, 104 dhe 105 të këtij ligji.

Të drejta të konsumatorit në rast të mospërputhjes së mallrave konsumatore

Neni 102

(1) Në rast të mospërputhjes së mallrave konsumatore me kontratën, konsumatori ka të drejtë:

- 1) të kërkojë largim falas të mospërputhjes përmes përmirësimit ose zëvendësimit të mallrave;
- 2) të kërkojë ulje proporcionale të çmimit ose
- 3) ta ndërpresë kontratën.

(2) Sidoqoftë, konsumatori mund të kërkojë kompensim të dëmit që e ka pësuar për shkak të mospërputhjes së mallrave konsumatore, duke përfshirë edhe dëmin që për shkak të mospërputhjes së mallrave konsumatore e ka pësuar në sendet tjera të tij në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore.

(3) Me mënjanimin falas të moskonformitetit së mallrave konsumatore në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni nënkuptohet, mospagesa e kompensimit për shpenzimet që janë të domosdoshme për sjelljen e mallit në përputhshme me kontratën, e veçanërisht shpenzimet për postë, transport, punë dore dhe materiale.

(4) Konsumatori ka të drejtë të mos paguajë një pjesë të çmimit derisa tregtari të përmbushë detyrimet e tij në rast të mospërputhjes së mallrave konsumatore, duke përfshirë detyrimin për kompensimin e dëmit.

E drejta e riparimit ose zëvendësimit

Neni 103

(1) Konsumatori është i autorizuar të kërkojë nga tregtari ose nga personi i autorizuar prej tij riparimin e mallit konsumator pa pagesë ose të kërkojë nga tregtari ndërrim falas të mallit konsumator, përveç nëse riparimi ose zëvendësimi është i pamundur ose joadekuat.

(2) Kërkesa e konsumatorit për riparim ose zëvendësim të mallit konsumator konsiderohet joadequate nëse për tregtarin tërheqë shpenzime të paarsyeshme në raport me kërkesat e tjera të mundshme të konsumatorit, e duke marrë parasysh vlerën e mallit nëse nuk ka pasur mospërputhje, kuptimi i mospërputhjes për konsumatorin, si dhe nëse kërkesa tjetër e mundshme e konsumatorit mund të përmbushej pa shqetësime të konsiderueshme për konsumatorin.

(3) Tregtari ka të drejtë të refuzojë kërkesën e konsumatorit për riparim ose zëvendësim nëse riparimi ose zëvendësimi është i pamundshëm ose kërkesa është joadequate.

(4) Tregtari ose personi i autorizuar prej tij janë të detyruar të kryejnë riparimin ose zëvendësimin e mallit konsumator, në mënyrë përkatëse, në afat të arsyeshëm nga momenti kur konsumatori e ka informuar tregtarin për mospërputhje që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë qëkur malli është marrë përsipër dhe pa shqetësime të konsiderueshme për konsumatorin, duke marrë parasysh natyrën e mallit dhe dedikimin për të cilin konsumatori e ka furnizuar, si dhe natyrën, peshën e mospërputhjes dhe kompleksitetin e mënjanimin të mospërputhjes.

(5) Konsumatori i cili ka kërkuar riparimin e mallit konsumator, në çdo rast është i autorizuar të kërkojë zëvendësimin e tij nëse tregtari ose personi i caktuar prej tij nuk e ka kryer riparimin e kërkuar brenda një kohe të arsyeshme e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 30 ditë nga momenti kur është pranuar malli.

(6) Me riparim nënkuptohet sjellja e mallit konsumator në përputhje me kontratën.

(7) Kur mospërputhja duhet të hiqet me riparim ose zëvendësim, konsumatori është i detyruar që mallin t'ia vërë në dispozicion tregtarit, ndërsa tregtari është i detyruar ta marrë përsipër dhe të përballojë shpenzimet e pranimit.

(8) Nëse është e nevojshme të riparohen ose zëvendësohen malli që është instaluar ose montuar në mënyrë përkatëse me natyrën ose qëllimin e tij përpara shfaqjes së moskonformitetit, detyrimi për mënjanimin e moskonformitetit përfshin detyrimin për mënjanimin e mallit dhe instalimin respektivisht montimin e mallit të riparuar ose zëvendësuar ose detyrim për të përballuar shpenzimet e atij mënjanimi dhe instalimi, respektivisht montazhit.

(9) Në rast të zëvendësimit të mallit, konsumatori nuk është i detyruar të paguajë për përdorimin e zakonshëm të mallit të zëvendësuar para zëvendësimit të tij.

E drejta e uljes proporcionale të çmimit

Neni 104

(1) Konsumatori ka të drejtë të kërkojë nga tregtari ulje proporcionale të çmimit, nëse:

1) tregtari ose personi i autorizuar prej tij nuk kanë kryer riparimin ose zëvendësimin e mallit, përkatësisht në afat të arsyeshëm që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga momenti kur është pranuar malli;

2) tregtari ose personi i autorizuar prej tij nuk e kanë kryer riparimin ose zëvendësimin e mallit, në mënyrë përkatëse, pa shqetësime të konsiderueshme për konsumatorin;

3) kur mospërputhja shfaqet përkundër përpjekjes së tregtarit ose personit të autorizuar prej tij, në mënyrë përkatësisht, të mënjanojë mospërputhjen e mallit;

4) kur mospërputhja është e një natyre aq serioze sa mund të arsyetojë uljen e çmimit ose

5) tregtari ose personi i autorizuar prej tij ka deklaruar, ose është e qartë nga rrethanat, se nuk do të mënjanojë mospërputhjen e mallit brenda një kohe të arsyeshme ose pa shqetësime të konsiderueshme për konsumatorin.

(2) Ulja proporcionale e çmimit do të bëhet sipas proporcionit ndërmjet vlerës konformitetit së mallit dhe vlerës së moskonformitetit të mallit në kohën e lidhjes së kontratës.

E drejta e ndërprerjes së kontratës

Neni 105

(1) Konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën, nëse:

1) tregtari ose personi i autorizuar prej tij nuk e ka kryer riparimin ose zëvendësimin e mallit, në mënyrë përkatëse, në afat të arsyeshëm, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga momenti i pranimit të mallit;

2) tregtari ose personi i autorizuar prej tij nuk e kanë kryer riparimin ose zëvendësimin e mallit, në mënyrë përkatëse pa shqetësime të konsiderueshme për konsumatorin;

3) kur mospërputhja shfaqet përkundër përpjekjes së tregtarit ose personit të autorizuar prej tij që në mënyrë përkatëse ta mënjanojë mospërputhjen e mallit;

4) kur mospërputhja është e një natyre aq serioze sa mund të arsyetojë ndërprerjen e kontratës ose

5) tregtari ose personi i autorizuar prej tij ka deklaruar, ose është e qartë nga rrethanat, se nuk do të mënjanojë mospërputhjen e mallit brenda një kohe të arsyeshme ose pa shqetësime të konsiderueshme për konsumatorin.

(2) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni, konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën edhe nëse tregtari nuk ka bërë ose paguar uljen e duhur të çmimit në afat të arsyeshëm që nuk mund të jetë më i gjatë se tetë ditë nga momenti kur është pranuar kërkesa e konsumatorit për ulje proporcionale të çmimit.

(3) Kur mospërputhja ka të bëjë vetëm me pjesën e mallit që i është dorëzuar konsumatorit në përputhje me kontratën dhe janë plotësuar kushtet për ndërprerjen e kontratës në përputhje me këtë ligj, konsumatori mund ta ndërpresë kontratën vetëm për pjesën që ka mangësi.

(4) Me përjashtim të paragrafit (3) të këtij neni konsumatori mund të ndërpresë kontratën edhe në aspektin e çfarëdo malli që e ka pranuar së bashku me mallin e papërputhshëm nëse nuk mundet nga konsumatori në mënyrë të arsyeshme të pritët të pranojë t'i mbajë vetëm mallrat e përputhshme.

(5) Sidoqoftë, konsumatori nuk ka të drejtë të ndërpresë kontratën nëse mospërputhja e mallrave konsumatore është me rëndësi më të vogël, me ç'rast nuk preken të drejtat e tij në përputhje me dispozitat e këtij neni dhe neneve 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 106, 107, 108 dhe 109 të këtij ligji.

(6) Konsumatori e ndërpret kontratën me deklaratë drejtuar tregtarit me të cilën do ta shprehë vendimin për ndërprerjen e kontratës.

(7) Nëse konsumatori e ndërpret kontratën, ai është i detyruar t'ia kthejë mallin tregtarit në kurriz të tregtarit, dhe tregtari është i detyruar t'ia kthejë çmimin e paguar për mallin konsumatorit me pranimin e mallit ose me rastin e pranimit dëshmisë nga konsumatori se malli i është dërguar tregtarit.

(8) Në lidhje me të drejtat dhe detyrimet tjera që rezultojnë nga veprimi i ndërprerjes së kontratës, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore për ndërprerjen e kontratave për shkak të mospërmbushjes.

(9) Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve (1), (2), (3), (4), (5), (6), (7) dhe (8) të këtij neni, konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën për shkak të shkeljes së theksuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Detyimore për ndërprerjen e kontratave për shkak të mospërmbushjes dhe për ndërprerje për shkak të mangësive materiale në përmbushjen.

Detyrimi për realizimin e të drejtave të konsumatorit në rast të mospërputhjes së mallrave konsumatore

Neni 106

(1) Për shkak të realizimit të të drejtave të tij, në përputhje me nenet 102, 103, 104 dhe 105 të këtij ligji, nuk është e domosdoshme që konsumatori të ketë kontrolluar mallin konsumator gjatë dorëzimit të tij, e as që ia ka dhënë për kontroll ndonjë subjekti të tretë.

(2) Sidoqoftë, për shkak të realizimit të të drejtave të tij, në përputhje me nenet 102, 103, 104 dhe 105 të këtij ligji, është e nevojshme që konsumatori të informojë tregtarin ose personin e caktuar prej tij për ekzistimin e mospërputhjes së mallrave, pa marrë parasysh nëse mospërputhja është e dukshme apo e fshehur, në afat prej 60 ditëve llogaritur nga dita kur e ka zbuluar mospërputhjen.

Afatet për realizimin e të drejtave të konsumatorit në rast të mospërputhjes së mallrave të konsumit

Neni 107

(1) Nëse me kontratë nuk është caktuar afat më i gjatë, tregtari i përgjigjet konsumatorit për mospërputhshmërinë e mallit të konsumit, përkatësisht mallit me element digjital, nëse ai tregohet në afat prej dy vjetësh nga dorëzimi i tij.

(2) Tregtari i përgjigjet konsumatorit për mospërputhjen e mallrave të konsumit me elementet digjitale të dorëzuara në përputhje me kontratën e shitjes e cila parashih furnizim të vazhdueshëm me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital, që ekziston ose shfaqet brenda dy vite nga momenti i dorëzimit të mallit me element digjital.

(3) Kur kontrata nga paragrafi (2) i këtij neni parashikon furnizim të vazhdueshëm për një periudhë më të gjatë se dy vjet, tregtari do t'i përgjigjet konsumatorit për mospërputhshmërinë e përmbajtjes digjitale ose të shërbimit digjital që ekziston ose tregohet në periudhën kur përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital duhet të furnizohet në përputhje me kontratën e shitjes.

(4) Konsumatori mund t'i shfrytëzojë të drejtat e tij në rast të moskonformitetit së mallit të konsumit në afat prej dy vjetësh nga kur e ka njoftuar tregtarin ose personin e autorizuar prej tij për ekzistimin e moskonformitetit së mallit të konsumit.

(5) Me rastin e shitjes së mallrave të përdorura (tashmë të shfrytëzuara), konsumatori dhe tregtari mund të merren vesh për një afat më të shkurtër prej dy vjetësh të përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, me kusht që afati i kontraktuar të mos jetë më i shkurtër se një vit.

(6) Barra e dëshmimit nëse mallrat e konsumit, përkatësisht mallrat me element digjital janë në përputhje me afatet e përcaktuara në paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni bie mbi tregtarin.

Përgjegjësi kaskade

Neni 108

(1) Kur tregtari i drejtpërdrejtë i përgjigjet konsumatorit për shkak të moskonformitetit së mallrave të konsumit që është pasojë e veprimit ose mosveprimit të prodhuesit, tregtarit të mëparshëm në të njëjtin zinxhir kontratësh ose një ndërmjetësi tjetër, tregtari i drejtpërdrejtë ka të drejtë të parashtojë kërkesa në lidhje me subjektin përgjegjës ose subjektet përgjegjëse në zinxhirin e kontratës.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore për regres.

Vëllimi i zbatimit të dispozitave në rast të mospërputhjes së mallit konsumatorë

Neni 109

(1) Zbatimi i dispozitave të këtij ligji me të cilat rregullohen të drejtat e konsumatorit në rast të mospërputhjes së mallrave konsumatore nuk mund të përjashtohet ose kufizohet me çfarëdo dispozitë kontraktuale ose kontrata ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, e krijuar ose e lidhur përpara se konsumatori të informojë tregtarin për mospërputhjen e mallrave konsumatore, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përjashtojnë ose kufizojnë të drejtat e konsumatorit.

(2) Në marrëdhëniet me konsumatorin me element ndërnacional, dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen të drejtat e konsumatorit në rast të moskonformitetit të mallrave konsumatore do të zbatohen pavarësisht nga dispozitat për përcaktimin e së drejtës autoritare, si dispozita me zbatim të drejtpërdrejtë, e kur kontrata është lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(3) Çdo kontrata në kundërshtim me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni është e pavlefshme.

(4) Dispozitat e neneve 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107 dhe 108 të këtij ligji nuk cenojnë mundësinë e tregtarëve për t'u ofruar konsumatorëve lidhjen e marrëdhënieve kontraktuale që nënkuptojnë nivel më të lartë mbrojtjes sesa ajo që rezulton nga këto dispozita.

Pjesa 3

GARANCIA TREGTARE PËR MALLRAT

Dispozitat e përgjithshme

Neni 110

(1) Kur tregtari i ka dhënë konsumatorit një garanci tregtare me fletë garancie në të cilën është përfshirë detyrimi i tregtarit ose prodhuesit për të garantuar funksionimin e duhur të mallrave të konsumit gjatë një kohe të caktuar, duke llogaritur nga dorëzimi i tyre te konsumatori, tregtari dhe prodhuesi janë të detyruar me dispozitat dhe kushtet e përcaktuara në fletën e garancisë dhe në reklamimin e lidhur me mallrat konsumatore të arritshme përpara ose në momentin e lidhjes së kontratës.

(2) Kur prodhuesi i ka dhënë konsumatorit garanci tregtare me fletë garancie e cila përmban detyrimin e prodhuesit për të garantuar qëndrueshmërinë e mallrave konsumatore për një periudhë të caktuar kohore, duke llogaritur nga dorëzimi i tyre te konsumatori, prodhuesi është i detyruar konsumatorit sa i përket riparimit ose zëvendësimit të mallrave të konsumit në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe kushtet e parashikuara në listat e garancisë në shpalljet përkatëse të mallrave konsumatore të arritshme para ose në momentin e lidhjes së kontratës.

(3) Prodhuesi mund t'i ofrojë kushte më të favorshme konsumatorit me garanci tregtare, mund t'i ofrojë edhe kushte më të favorshme.

(4) Nëse dispozitat dhe kushtet e përcaktuara në listën e garancive janë më pak të favorshme për konsumatorin sesa ato të përcaktuara në reklamimet përkatëse të mallrave konsumatore, do të zbatohen ato të përcaktuara në reklamën përkatëse, përveç nëse para lidhjes së kontratës, reklamimi i mallrave konsumatore është korrigjuar në të njëjtën mënyrë ose të krahasueshme, si dhe kur është bërë reklamimi përkatës.

(5) Si mall konsumator nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni konsiderohen:

a) çdo send i prekshëm i luajtshëm, me përjashtim të mallrave të shitura sipas procedurës përmbartuese ose të autorizuar ndryshe me ligj, për ujin dhe gazin e paketuar për shitje në një vëllim ose sasi të caktuar, si dhe energjinë elektrike; dhe

b) çdo send i prekshëm i luajtshëm, në të cilin është instaluar ose me të cilin është ndërlidhur përmbajtje digjitale ose shërbim digjital në mënyrë të tillë që nëse nuk ka përmbajtje digjitale ose shërbim digjital, mallrat nuk do të kryejnë funksionet e tyre, me përjashtim të bartësve të përhershëm që shërbejnë ekskluzivisht si bartës të përmbajtjes digjitale.

(6) Dispozitat për garanci tregtare për mallin nga ky ligj do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme në rastet kur tregtari ose prodhuesi nuk i ka lëshuar fletë garancie konsumatorit, por obligimi i tyre për garanci tregtare rrjedh nga reklamimi përkatës.

(7) Dispozitat e neneve 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117 dhe 118 të këtij ligji nuk ndikojnë në zbatimin e dispozitave për përgjegjësinë e tregtarit për mospërputhshmërinë e mallrave.

Përmbajtja, forma dhe gjuha e fletës së garancisë

Neni 111

(1) Në listën e garancisë duhet të përmendet se konsumatori ka të drejta të duhura në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore me kontratat për shitjen e mallrave dhe duhet të thuhet qartë se vetë garancia tregtare nuk ndikon në të drejtat e konsumatorit, e veçanërisht jo në të drejtat e tij për arsye të mospërputhjes së mallrave.

(2) Në fletën e garancisë në mënyrë të qartë duhet të përmenden përshkrimi i mallit të konsumit, data e shitjes së tij, numri i llogarisë së lëshuar, përmbajtja e garancisë tregtare dhe kushtet e rëndësishme që nevojiten për parashtrimin e kërkesave në përputhje me garancinë tregtare, e veçanërisht afati i vlefshmërisë së garancisë tregtare, zbatimi territorial i garancisë tregtare, emri (emërtimi) dhe adresa (selia) e botuesit të saj, si dhe emri (emërtimi), adresa (selia) dhe të dhënat për kontakt me subjektin në të cilin konsumatori duhet t'i drejtohet në raste se malli konsumator nuk funksionon siç duhet ose nuk funksionojnë në periudhën për të cilën është dhënë garancia tregtare për qëndrueshmëri.

(3) Fleta e garancisë në të cilën gjendet garancia tregtare, konsumatorit i vihet në dispozicion me shkrim ose transportuesit tjetër të përhershëm që është në dispozicion dhe i arritshëm më së voni gjatë dorëzimit të mallrave.

(4) Lista e garancisë që përmban garancion tregtar lëshohet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj, gjë që nuk përjashton mundësinë e përdorimit të njëkohshëm edhe të gjuhëve të tjera.

(5) Kur fleta e garancisë në të cilën është përfshirë garancia tregtare e lëshuar nga tregtari ose nga prodhuesi është në gjuhë të huaj, vetëm kushtet dhe dispozitat e garancionit tregtar në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën e flasin së paku 20% e qytetarëve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj, gjë që nuk e përjashton mundësinë e përdorimit të njëkohshëm të gjuhëve të tjera, përveç nëse garancia tregtare e lëshuar në gjuhë të huaj parashikon të drejta më të mëdha të konsumatorit.

(6) Kur lista e garancionit në të cilën është përfshirë garancia tregtare nuk është në pëlçim me dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3), (4) dhe (5) të këtij neni, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e garancisë tregtare, ndërsa konsumatori ka të drejtë të përmbushë garancinë tregtare.

(7) Dispozitat dhe kushtet e përmendura në fletën e garancisë janë të detyrueshme për konsumatorin vetëm nëse janë të qarta, të kuptueshme dhe lehtësisht të dukshme.

Afati i garancisë

Neni 112

(1) Kohëzgjatjen e afatit të garancisë konsumatori dhe tregtari e përcaktojnë me kontrata.

(2) Kur në fletën e garancisë përmenden më shumë afate të garancisë me kohëzgjatje të ndryshme, e nuk janë të përcaktuara individualisht mallrat e konsumit dhe/ose përkatësitë e tyre me të cilat këto afate kanë të bëjnë, si përgjithësisht i zbatueshëm merret afati më i gjatë i garancisë.

(3) Kur në fletën e garancisë të lëshuar nga tregtari dhe në fletë garancie të lëshuar nga prodhuesi janë përmendur afatet e garancisë me kohëzgjatje të ndryshme, si përgjithësisht i zbatueshëm merret afati më i gjatë i garancisë.

Të drejtat e konsumatorit në raport me afatin e garancisë

Neni 113

(1) Konsumatori mundet për shkak të funksionimit të parregullt ose për shkak të mosfunksionimit në periudhën për të cilën është lëshuar garancia tregtare për qëndrueshmëri të kërkojë nga tregtari, respektivisht nga prodhuesi ose personi i përcaktuar nga ana e tyre riparimin e mallit konsumator ose nga ana tjetër nga tregtari, respektivisht nga prodhuesi të kërkojë zëvendësimin të mallit konsumator gjatë afatit të garancisë, pa marrë parasysh atë se kur është shfaqur funksionimi i parregullt respektivisht mosfunksionimi.

(2) Konsumatori mund të kërkojë zëvendësim të mallit konsumator në rastet kur malli konsumator është riparuar tre herë gjatë afatit të garancisë, pavarësisht nga arsyeja për riparim, si dhe në rastet kur malli konsumator është riparuar tashmë dy herë gjatë afatit të garancisë për arsye të njëjtë për riparim.

(3) Në rastet e paragrafit (2) të këtij neni, tregtari, respektivisht prodhuesi është i detyruar, edhe pse është përcaktuar mundësia e mëtejshme për riparim gjatë afatit të garancisë, me kërkesë të konsumatorit, për të zëvendësuar mallin konsumator.

(4) Nëse në momentin e parashtrimit të kërkesës nga konsumatori, tregtari ose prodhuesi nuk ka mall përkatës të konsumit, respektivisht mall konsumator që do të përputhet me nevojat e konsumatorit, e në çdo rast pasi të kalojnë 30 ditë nga kërkesa e parashtruar, konsumatori ka të drejtë, sipas zgjedhjes së tij:

1) të ndërpresë kontratën dhe të kërkojë kthimin e çmimit të paguar;

2) të kërkojë ulje proporcionale të çmimit ose

3) të kërkojë zëvendësimin me mall tjetër përkatës konsumator, e kur tregtari, respektivisht prodhuesi ka në dispozicion mall të tillë konsumator.

(5) Tregtari, respektivisht prodhuesi është i detyruar të njoftojë konsumatorin që ka kërkuar zëvendësim të mallit konsumator se ka në dispozicion mall të tillë konsumator në afat që nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

(6) Konsumatori, sidoqoftë, ka të drejtën e kompensimit të dëmit që e ka pësuar për shkak të asaj se ka qenë i privuar nga përdorimi i mallit konsumator nga momenti i kërkesës së riparimit ose zëvendësimi deri në zbatimin e tyre.

Vazhdimi i afatit të garancisë

Neni 114

(1) Në raste të riparimit të vogël, afati i garancisë zgjatet për aq kohë sa konsumatori është privuar nga përdorimi i mallit konsumator.

(2) Kur, për shkak të funksionimit me defekt, bëhet zëvendësimi i mallit konsumator ose riparimi thelbësor i tij, afati i garancisë fillon të rrjedhë përsëri nga zëvendësimi, pra nga kthimi i mallit të riparuar të konsumit tek konsumatori.

(3) Nëse është zëvendësuar ose riparuar në mënyrë thelbësore vetëm ndonjë pjesë e mallit konsumator, afati i garancisë fillon të rrjedhë përsëri vetëm për atë pjesë.

(4) Tregtari ose prodhuesi është i detyruar të shënojë të drejtat e konsumatorit nga dispozitat e paragrafëve (1), (2) dhe (3) të këtij neni në fletën e garancisë.

Shpenzimet dhe rreziku

Neni 115

(1) Tregtari, respektivisht prodhuesi, është i detyruar që në llogarinë e tij ta transferojë mallin e konsumit deri në vendin ku i njëjti duhet të riparohet, respektivisht të zëvendësohet, si dhe mallin konsumator të riparuar, respektivisht të zëvendësuar t'ia kthejë mbrapa konsumatorit.

(2) Në kohën e riparimit, rreziku i prishjes ose dëmtimit të mallrave konsumatore është në barrë të tregtarit, respektivisht prodhuesit.

Humbja e të drejtave

Neni 116

Të drejtat e konsumatorit ndaj tregtarit, respektivisht prodhuesi në bazë të garancisë tregtare të përfshirë në fletën e garancisë, humben pas skadimit të një viti, duke e llogaritur ditën kur ai ka kërkuar nga ai riparim ose zëvendësim të mallit të konsumit.

Ndalimi i keqpërdorimit të shprehjeve "garanci tregtare" ose "fletë garancie"

Neni 117

U ndalohet tregtarëve gjatë lidhjes së kontratave të shitjes, si dhe gjatë reklamimit të mallrave të konsumit t'i përdorin shprehjet "garanci tregtare", "fletë garancie" ose shprehje të tjera të ngjashme me kuptim të njëjtë, nëse në bazë të kontratës së shitjes konsumatori nuk përvetëson të drejta më të mëdha ose plotësuese në raport me ato që rezultojnë nga përgjegjësia e tregtarit për mospërputhjen e mallit ose nga të drejtat tjera që konsumatori i ka në përputhje me këtë ligj ose rregull tjetër.

Vëllimi i zbatimit të dispozitave për garanci tregtare për mallrat

Neni 118

(1) Zbatimi i dispozitave për garanci tregtare dhe për fletë garancie nga ky ligj nuk mund të përjashtohet ose kufizohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose indirekte, me çfarëdo dispozite ose marrëveshje kontraktuale mes konsumatorit dhe tregtarit.

(2) Kur në fletën e garancisë janë përfshirë kushte dhe/ose dispozita në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohet garancia tregtare për mallrat ose nga rregulloret e posaçme, zbatohen dispozitat e këtij ligji ose të rregullave të veçanta.

(3) Barra për të dëshmuar se tregtari i ka përmbushur detyrimet e tij në përputhje me dispozitat për garancinë tregtare për funksionimin e drejtë të mallit konsumator të këtij ligji bie mbi tregtarin.

(4) Në marrëdhëniet konsumatore me element ndërnacional, dispozitat e këtij ligji për garanci tregtare të mallrave zbatohen pa marrë parasysh rregullat për përcaktimin e së drejtës së vlefshme, si dispozita me zbatim të drejtpërdrejt, e kur kontrata për shitje është lidhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(5) Çdo kontratë për garanci tregtare e dhënë me një fletë garancie, që nuk është në përputhje me dispozitat e këtij ligji është e pavlefshme.

(6) Me dispozitat nga nenet 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 109, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 116 dhe 117 të këtij ligji nuk preket në mundësinë tregtarët t'u ofrojnë konsumatorëve hyrje në marrëdhënie kontraktuale që nënkuptojnë nivel më të lartë të mbrojtjes sesa ajo që rezulton nga këto dispozita.

Kapitulli 4 KONTRATA TË VEÇANTA KONSUMATORE

Pjesa 1 KONTRATA NË DISTANCË DHE KONTRATA JASHTË HAPËSIRAVE AFARISTE TË TREGTARIT

Nënpjesa 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Vëllimi i zbatimit të dispozitave për kontrata në distancë dhe kontrata jashtë hapësirave afariste të tregtarit

Neni 119

(1) Dispozitat me të cilat rregullohen kontratat në distancë dhe kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit zbatohen në kontrata të shitjes ose jashtë kontratave për shërbime të lidhura mes konsumatorit dhe tregtarit në distancë dhe/ose jashtë hapësirave afariste të tregtarit.

(2) Zbatimi i dispozitave nga ky ligj për kontratat në distancë dhe për kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit me të cilat përcaktohen të drejtat e konsumatorit nuk mund të përjashtohet ose kufizohet me çfarëdo dispozite kontraktuale ose kontrata mes konsumatorit dhe tregtarit, e kur në përgjigjen përkatëse është e zbatueshme e drejta vendore.

(3) Çdo marrëveshje ose kontratë në kundërshtim me paragrafin (2) të këtij neni janë të pavlefshme.

Nënpjesa 2 DETYRIMI PËR INFORMIM PARAKONTRAKTUAL

Përmbajtja e detyrimit për informim parakontraktual

Neni 120

(1) Përpara se konsumatori të bëhet i detyruar ndaj çdo kontrata në distancë ose kontratë jashtë hapësirave afariste të tregtarit, respektivisht me çfarëdo oferte përkatëse, tregtari është i detyruar t'i japë konsumatorit në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme informacionin vijues:

1) shenjat kryesore të mallrave ose shërbimeve, në vëllimin përkatës të medias dhe të vetë mallrave ose shërbimeve;

2) identitetin e tregtarit, siç është emri ose emërtimi i tij tregtar;

3) adresa gjeografike ku tregtari është i themeluar në aspektin afarist dhe, ku është e zbatueshme, numri i tij i telefonit dhe adresa e postës elektronike, si dhe informacione plotësuese kur tregtari siguron mjete të tjera për hapësirë për shitje onlajn ose komunikim elektronik që garantojnë se konsumatori mund të ruajë korrespondencë të shkruar, duke përfshirë datën dhe orën e korrespondencës së tillë me tregtarin në bartës të përhershëm, me ç'rast të gjitha mjetet e komunikimit që janë siguruar nga tregtari janë për mundësimin e kontaktit të shpejtë dhe efikas të konsumatorit me tregtarin, si dhe, ku është e zbatueshme, adresa gjeografike dhe identiteti i tregtarit në emrin dhe/ose llogarinë e të cilit vepron tregtari;

4) kur është ndryshe nga adresa e përmendur në pikën 3) të këtij paragrafi, adresa gjeografike e selisë afariste të tregtarit dhe, ku është e zbatueshme, adresa gjeografike e tregtarit në emrin dhe/ose llogarinë e të cilit vepron tregtari, e tek të cilat konsumatori mund t'ë adresojë çfarëdo ankese;

5) çmimi i përgjithshëm i mallrave ose shërbimeve, duke përfshirë të gjitha tatimet, e të përcaktohet paraprakisht, mënyra e përlllogaritjes së çmimit, si dhe, aty ku është e zbatueshme, të gjitha kompensimet plotësuese për transportin, dërgimin, postën ose çfarëdo shpenzimesh tjera ose, kur këto kompensime nuk mund të përcaktohen në mënyrë të arsyeshme paraprakisht, fakti që këto kompensime do mund të jenë të arkëtuara;

6) te kontratat në kohë të pacaktuar ose kontratat me parapagesë, çmimi i përgjithshëm në të cilin janë përfshirë shpenzimet e përgjithshme për periudhën së përlllogaritur me ç'rast, kur te këto kontrata bëhet pagesa në shumë fikse, çmimi i përgjithshëm i përfshin edhe shpenzimet e përgjithshme me atë që, në rastet kur shpenzimet e përgjithshme nuk mund të përcaktohen në mënyrë të arsyeshme paraprakisht, përmendet mënyra e përlllogaritjes së çmimit;

7) ku është e zbatueshme, që çmimi të përcaktohet personalisht për konsumatorin në bazë të vendimmarrjes së automatizuar;

8) shpenzimet e përdorimit të mjeteve të komunikimit në distancë për lidhjen e kontratës, kur këto shpenzime përlllogariten në mënyrë tjetër, e jo sipas tarifës themelore;

9) mënyrat e pagesës, dërgimit dhe plotësisimit, koha deri në të cilën tregtari detyrohet të dërgojë mallrat ose të ofrojë shërbimet dhe, ku është e zbatueshme, politika e tregtarit për të vepuar ndaj kundërshtimeve ose ankesave;

10) kur konsumatori ka në dispozicion të drejtën e tërheqjes, kohëzgjatja e tij dhe kushtet dhe procedura për ushtrimin e tij në përputhje me dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen kontratat në distancë dhe kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit, si dhe formulari për tërheqje nga kontrata e pacaktuar në rregullën nga paragrafi (6) i këtij neni;

11) ku është e zbatueshme, të përmendet se konsumatori është i detyruar të përballojë shpenzimet për kthimin e mallrave në rast të tërheqjes së tij nga kontrata dhe, kur në kontratat në distancë, mallrat nuk mund të kthehen normalisht me postë, të përmenden shpenzimet për kthimin;

12) të përmendet se, nëse konsumatori e ushtron të drejtën e tërheqjes pasi ka parashtruar kërkesë për ushtrimin e shërbimeve ose dërgimin e mallrave përkatëse në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ai është i detyruar t'ia paguajë tregtarit shpenzimet e arsyeshme në përputhje me nenin 125 paragrafi (4), neni 126 paragrafi (15) dhe nenin 131 paragrafi (5) të këtij ligji;

13) kur konsumatorit në përputhje me dispozitat nga ky ligj me të cilat rregullohen kontratat në distancë dhe kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit nuk e ka në dispozicion të drejtën e tërheqjes, të përmendet se konsumatori nuk mund të shfrytëzojë të drejtën e tërheqjes ose nga ana tjetër, ku është e zbatueshme, të përmenden rrethanat kur konsumatori e humb të drejtën e tërheqjes;

14) të përmendet në kuptim të konfirmimit të ekzistimit të garancisë ligjore për përputhje të mallrave ose shërbimeve, përmbajtjeve digjitale ose shërbimeve digjitale në përputhje me këtë ligj;

15) ku është e zbatueshme, ekzistenca dhe kushtet për ushtrimin e ndihmës pas shitjes për konsumatorin, shërbimeve pas shitjes dhe garanci tregtare;

16) ku është e zbatueshme, të përmendet ekzistimi i kodeve përkatëse të sjelljes dhe mënyrave të qasjes deri te mostrat e të njëjtave;

17) ku është e zbatueshme, afati i vlefshmërisë së kontratës, e nëse kontrata është në kohë të pacaktuar ose nga ana tjetër i nënshtrohet vazhdimit automatik, atëherë kushtet e ndërprerjes së kontratës;

18) ku është e zbatueshme, kohëzgjatja minimale e detyrimeve të konsumatorit sipas kontratës;

19) ku është e zbatueshme, ekzistenca dhe kushtet e zbatueshme për depozitat ose garancitë tjera financiare që konsumatori është i detyruar t'i paguajë ose t'i lëshojë me kërkesë të tregtarit;

20) ku është e zbatueshme, për funksionalitetin, duke përfshirë edhe masat e zbatueshme për mbrojtjen teknike të mallrave me elemente digjitale, përmbajtjen digjitale dhe shërbimin digjital;

21) ku është e zbatueshme, çdo kompatibilitet dhe interoperabilitet përkatës i mallrave me elemente digjitale, përmbajtjen digjitale dhe shërbimin digjital, e kur tregtari e ka ditur për këtë ose në mënyrë të arsyeshme pritet se është dashur të dinte për këtë dhe

22) ku është e zbatueshme, ekzistimi i mundësisë për qasje drejt mënyrave të zgjidhjes jashtëgjyqësore të kontesteve me konsumatorin, të zbatueshme te tregtari, si dhe për mënyrat e qasjes në të njëjtat.

(2) Dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen edhe në kontratat për furnizim me ujë, gaz ose energji elektrike dhe kur këto nuk ofrohen për shitje në vëllim ose sasi të përcaktuar saktësisht, si dhe në kontratat për furnizimin e ngrohjes qendrore ose të përmbajtjes digjitale që nuk furnizohet në bartës të përhershëm.

(3) Në rastet e ankandit publik, informacionet e përcaktuara në dispozitat e paragrafit (1) pikat 2), 3) dhe 4) të këtij neni mund të zëvendësohen me detajet e njëjta që i jep udhëheqësi i ankandit.

(4) Konsiderohet se tregtari ka përmbushur detyrimin për informim parakontraktual në raport me informacionet e përcaktuara në paragrafin (1) të pikave 10), 11) dhe 12) të këtij neni, nëse i ka dërguar konsumatorit mostër të formularit të plotësuar saktësisht për tërheqje nga kontrata, të përcaktuar në rregullën nga paragrafi (6) i këtij neni.

(5) Nëse tregtari nuk e ka kryer detyrimin për informim parakontraktual për kompensimet plotësuese ose shpenzime të tjera në përputhje me paragrafin (1) pikat 5) dhe 6) të këtij neni, si dhe detyrimin për informim parakontraktual për shpenzimet për kthimin e mallrave në përputhje me paragrafin (1) pika 11) e këtij neni, konsumatori është i detyruar t'i shlyej këto kompensime ose shpenzime.

(6) Formën dhe përmbajtjen e formularit për tërheqje nga kontrata në distancë ose kontrata jashtë hapësirave afariste të tregtarit e përcakton ministri i Ekonomisë.

Përmbajtja e detyrimit për informim parakontraktual për kontratat e lidhura në hapësirën e shitjeve online

Neni 121

Para se konsumatorit të bëhet i detyruar me çfarëdo kontrata në distancë për çfarëdo oferte përkatëse në hapësirë të shitjes onlajn ofruesi i hapësirës së shitjes onlajn, pa prekur në dispozitat për praktika të padrejta tregtare, është i detyruar që në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme përkatëse për mjetin e komunikimit në distancë t'ia japë konsumatorit informacionet vijuese:

1) informacione të përgjithshme, të arritshme në pjesë specifike të interfejsit onlajn, i cili është drejtpërdrejt dhe lehtë i arritshëm nga faja ku janë prezantuar ofertat, për parametrat kryesorë që e përcaktojnë renditjen, për ofertat që i jepen konsumatorit si rezultat i kërkimit dhe rëndësisë relative të atyre parametrave krahasuar me parametrat tjerë;

2) nëse pala e tretë që ofron mallra, shërbime ose përmbajtje digjitale është tregtar ose jo, në bazë të deklaratës së një personi të tretë që i dorëzohet ofruesit të hapësirës së shitjes onlajn;

3) kur pala e tretë që ofron mallra, shërbime ose përmbajtje digjitale nuk është tregtar, informacion se të drejtat e konsumatorëve që rezultojnë nga rregullat e mbrojtjes së konsumatorit nuk zbatohen në kontratën dhe

4) ku është e zbatueshme, cilat janë detyrimet e personit të tretë kontraktual që ofron mallra, shërbime ose përmbajtje digjitale dhe cilat janë detyrimet e ofruesit të hapësirës së shitjes onlajn, me ç'rast informacioni i tillë nuk prek në detyrimet për personin e tretë që është tregtar ose për ofruesin e hapësirës së shitjes onlajn që rezultojnë nga rregullat e mbrojtjes së konsumatorit.

Detyrimi për informacione parakontraktuale

Neni 122

Informacionet nga nenet 120 dhe 121 të këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual paraqesin pjesën përbërëse të kontratës së distancës, respektivisht të kontratës jashtë hapësirave afariste të tregtarit dhe nuk mund të ndryshohet nëse palët në shprehimisht nuk bien dakord ndryshe.

Gjuha e informacionit parakontraktual

Neni 123

(1) Tregtari është i detyruar që informacionet nga nenet 120 dhe 121 të këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual të konsumatorit t'ia japë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetit e saj, gjë që nuk përjashton mundësinë për përdorimin e njëhershëm edhe të gjuhëve të tjera.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet në mënyrë përkatëse edhe në kontratat për paket-aranzhime turistike dhe për aranzhime të ndërlidhura për udhëtarë.

Barra e dëshmimit

Neni 124

Në rast kontesti lidhur me atë nëse, kur dhe si i janë dhënë konsumatorit informacionet nga nenet 120 dhe 121 të këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual, barra e dëshmimit bie mbi tregtarin.

Kërkesat formale për kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit

Neni 125

(1) Në lidhje me kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit, ky i fundit është i detyruar t'i japë konsumatorit informacionet nga nenet 120 dhe 121 të këtij Ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual në letër ose, nëse konsumatori është dakord, me bartës tjetër të përhershëm.

(2) Informacionet nga nenet 120 dhe 121 të këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual duhet të jenë të lexueshme dhe të përpiluara në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

(3) Tregtari është i detyruar që konsumatorit t'i japë kopje të kontratës së nënshkruar ose vërtetim për kontratën e lidhur në letër ose, nëse konsumatori është dakord, me bartës tjetër të përhershëm, duke përfshirë edhe vërtetimin për pajtueshmërinë e shprehur paraprake dhe pranimin e konsumatorit për zbatimin e kontratës për furnizim me përmbajtje digjitale, kur e njëjta nuk furnizohet me bartës të përhershëm, me ç'rast konsumatori, në përputhje me dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen kontratat në distancë dhe kontratat jashtë hapësirave afariste, e humb të drejtën e tërheqjes.

(4) Në rastet kur konsumatori ka për qëllim zbatimin e shërbimeve ose furnizimin me ujë, gaz ose energji elektrike, kur këto nuk ofrohen për shitje në vëllim ose sasi të përcaktuar saktësisht, si dhe furnizimi me ngrohje rajonale të fillojë para skadimit të afatit për tërheqje nga kontrata, dhe nga kontrata për konsumatorin rezulton detyrimi për pagesë, tregtari është i detyruar të kërkojë nga konsumatori që të dorëzojë shprehimisht kërkesë të këtillë edhe atë në bartës të përhershëm dhe të kërkojë që konsumatori të konfirmojë se kur kontrata është e përmbushur tërësisht nga tregtari, konsumatori më nuk do të ketë të drejtën e tërheqjes.

(5) Për kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit, nuk mund të vendosen kërkesa plotësuese formale krahas atyre nga dispozitat e këtij ligji.

Kërkesat formale për kontratat në distance

Neni 126

(1) Lidhur me kontratat në distancë, tregtari është i detyruar t'ia japë ose t'ia bëjë të arritshme konsumatorit informacionet nga nenet 120 dhe 121 të këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual në mënyrën që është përkatëse për mjetin e komunikimit në distancë, si dhe në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.

(2) Kur informacionet nga nenet 120 dhe 121 të këtij ligji ë kanë të bëjnë me informimin parakontraktual, që tregtari është i detyruar t'ia japë konsumatorit janë në bartës të përhershëm, të njëjtat duhet të jenë të lexueshme.

(3) Kur me kontratën në distancë që duhet të lidhet përmes mjeteve elektronike konsumatori merr pësipër obligimin për të bërë pagesën, tregtari është i detyruar që në mënyrë të qartë dhe të dukshme, e paka para se konsumatori ta bëjë porosinë, t'ia japë konsumatorit informacionet nga neni 120 paragrafët 1), 5), 6), 17) dhe 18) të këtij ligji.

(4) Kur me kontratën në distancë që duhet të lidhet përmes mjeteve elektronike konsumatori merr përsipër obligimin për të bërë pagesën, tregtari është i detyruar që të sigurojë se konsumatori, gjatë bërjes së porosisë, shprehimisht do të konfirmojë se porosia nënkupton detyrimin e tij për pagesë.

(5) Kur me kontratën në distancë që duhet të lidhet përmes mjeteve elektronike konsumatori merr përsipër obligimin për të bërë pagesën, ndërsa bërja e porosisë nënkupton aktivizimin e pullës ose funksion të ngjashëm, tregtari është i detyruar të sigurojë shënimin, në mënyrë dukshëm të qartë, në pullën ose funksionin e ngjashëm vetëm me fjalët "porosi me detyrim për pagesë" ose me shprehje përkatëse johezituese që shënon se bërja e porosisë nënkupton detyrimin për pagesë ndaj tregtarit.

(6) Nëse tregtari nuk i respekton detyrimet nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, konsumatori nuk është i detyruar me kontratën ose porosinë.

(7) Dispozitat e paragrafëve (3), (4), (5) dhe (6) të këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse edhe në kontratat e pake-aranzhimeve turistike dhe aranzhimet e ndërlidhur për udhëtarë.

(8) Tregtari është i detyruar të sigurojë shënim të qartë dhe të lexueshëm në faqen e tij të internetit, më së voni deri në fillim të procesit të porositjes, nëse ekzistojnë kufizime në aspektin e dërgesës, si dhe cilat mjete të pagesës pranohen.

(9) Kur kontrata lidhet përmes mjeteve të komunikimit në distancë që nënkuptojnë hapësirë ose kohë të kufizuar për paraqitjen e informacioneve, tregtari është i detyruar, përmes këtij mjete dhe para lidhjes së kësaj kontrate, konsumatorit t'ia bëjë të arritshme së paku informacionet nga neni 120 paragrafi (1) pikat 1), 2), 5), 6), 10) dhe 17) të këtij ligji përveç formularit për tërheqje nga kontrata të përcaktuar në rregullën nga neni 120 paragrafi (6) i këtij neni.

(10) Kur kontrata lidhet përmes mjeteve të komunikimit në distancë që nënkuptojnë hapësirë ose kohë të kufizuar për paraqitjen e informacioneve, tregtari është i detyruar, konsumatorit t'ia japë informacionet tjera nga ky ligj që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual, krahas informacioneve nga paragrafi (9) i këtij ligji, në mënyrë përkatëse dhe në përputhje me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

(11) Pa marrë parasysh paragrafët (9) dhe (10) të këtij neni, nëse tregtari i telefon konsumatorit për qëllimet e lidhjes së kontratës në distancë, ai është i detyruar, në fillim të bisedës me konsumatorin, t'ia njoftojë konsumatorit identitetin e tij dhe, ku është e zbatueshme, identitetin e subjektit në emër dhe/ose llogari të të cilit e bën thirrjen, si dhe qëllimin tregtar të thirrjes.

(12) Kur kontrata në distancë duhet të lidhet përmes telefonit, tregtari është i detyruar që konsumatorit t'i lëshojë vërtetim për ofertën në bartës të përhershëm, me ç'rast konsumatori është i detyruar madje pasi të nënshkruajë ofertën ose do ta dërgojë pëlqimin e vet të shkruar, në bartës të përhershëm.

(13) Dispozita nga paragrafi (12) i këtij neni zbatohet në mënyrë përkatëse edhe në kontratat për paket-aranzhimet turistike edhe në kontratat e ndërlidhura për udhëtim.

(14) Tregtari është i detyruar t'i sigurojë konsumatorit vërtetim për kontratën e lidhur, në bartës të përhershëm, në kohë të arsyeshme pas lidhjes së kontratës në distancë, e më së voni në kohën e dërgimit të mallit ose para fillimit të ushtrimit të shërbimit, me ç'rast vërtetimi duhet t'i përmbajë:

1) të gjitha informacionet nga nenet 120 dhe 121 të këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual, përveç kur tashmë ia ka dhënë këto informacione në bartës të përhershëm para lidhjes së kontratës në distancë dhe

2) kur është e zbatueshme, vërtetimi për pëlqimin e shprehur paraprakisht dhe pranimin e konsumatorit për realizimin e kontratës së furnizimit me përmbajtje digjitale, ku e njëjta nuk është përmendur në bartësin e përhershëm, me ç'rast konsumatori, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, humbet të drejtën për t'u tërhequr.

(15) Në rastet kur konsumatori ka për qëllim ushtrimin e shërbimeve ose furnizimit me ujë, gaz dhe energji elektrike, kur këto nuk ofrohen në shitje në vëllim ose sasi të përcaktuar saktësisht, si dhe furnizimi me ngrohje qendrore të fillojë para skadimit të afatit për tërheqje nga kontrata, tregtari është i detyruar që konsumatorit t'i dorëzojë shprehimisht kërkesë të këtillë për furnizimin, edhe atë në bartës të përhershëm dhe të kërkojë që konsumatori të konfirmojë se kur kontrata është përmbushur tërësisht nga tregtari, konsumatori më nuk do të ketë të drejtën e tërheqjes.

(16) Me dispozitat e këtij neni nuk preket në zbatimin e dispozitave nga Ligji për tregti elektronike që kanë të bëjnë me lidhjen e kontratave elektronike dhe me bërjen e porosive elektronike.

(17) Për kontratat në distancë, nuk mund të vendosen kërkesa plotësuese formale krahas këtyre nga dispozitat e këtij ligji.

Nënpjesa 3 E DREJTA E TËRHEQJES

Dispozita të përgjithshme për të drejtën e tërheqjes

Neni 127

(1) Konsumatori ka të drejtën e tërheqjes nga kontrata në distancë ose nga kontrata jashtë hapësirave afariste, në afat prej 14 ditëve, pa dhënë me këtë rast arsye ose arsyetim për tërheqjen nga kontrata dhe pa detyrimin e tij që të paguajë çfarëdo shpenzime përveç shpenzimeve të parashikuara në nenin 131 të këtij ligji dhe përveçse në rastet e përcaktuara në nenin 133 të këtij ligji.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, në rastë të kontratave të lidhura gjatë vizitave të pakërkua në shtëpinë e konsumatorit nga ana e tregtarit ose gjatë ekskursioneve të organizuara nga tregtari me synimin ose qëllimin për të promovuar ose për t'u shitur mallra konsumatorëve, konsumatori ka të drejtën e tërheqjes nga kontrata, në afat prej 30 ditëve, pa dhënë me këtë rast arsye ose arsyetim për tërheqjen nga kontrata dhe pa detyrimin e tij që të paguajë çfarëdo shpenzime përveç shpenzimeve të parashikuara në nenin 131 të këtij ligji dhe përveçse në rastet e përcaktuara në nenin 133 të këtij ligji.

(3) Afati për tërheqje skadon pasi të kalojnë 14 ditë në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, respektivisht 30 ditë në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni edhe atë:

1) te kontratat për shërbime, nga dita e lidhjes së kontratës;

2) te kontratat e shitjes, nga dita kur konsumatori ose ndonjë subjekt i tretë i përcaktuar nga konsumatori, me përjashtim të transportuesit, do të përvetësojë zotërimin fizik të mallit ose:

a) në rastin kur konsumatori ka porositur më shumë mallra që janë të përfshira me porosinë e njëjtë, por janë porositur ndaras, nga dita kur konsumatori ose ndonjë palë e tretë e përcaktuar nga konsumatori, me përjashtim të transportuesit, do të përvetësojë zotërim fizik mbi dërgesën e fundit;

b) në rastin e dorëzimit të mallit që përbëhet nga më shumë dërgesa ose copë, nga dita kur konsumatori ose ndonjë subjekt i tretë i përcaktuar nga konsumatori, me përjashtim të transportuesit, do të përvetësojë zotërimin fizik të mallit të parë ose pjesës së fundit;

c) në rastin e një kontrata për dorëzimin e përhershëm të mallrave për periudhë të caktuar kohore, nga dita kur konsumatori ose ndonjë subjekt i tretë i përcaktuar nga konsumatori, me përjashtim të transportuesit, do të përvetësojë zotërimin fizik të mallit të parë ose

3) te kontratat për furnizimin me ujë, gaz ose energji elektrike, ku këto nuk ofrohen për shitje në vëllim ose sasi të caktuar saktësisht, si dhe kontratat për furnizimin e ngrohjes qendrore ose përmbajtjes digjitale që nuk furnizohet me bartës të përhershëm, nga data e lidhjes së kontratës.

(4) Është i lejuar ushtrimi i detyrimeve kontraktuale, nga të dyja palët, gjatë kohëzgjatjes së afatit të tërheqjes.

(5) Pa marrë parasysh dispozitat nga paragrafi (4) i këtij neni, tregtarit i ndalohe të pranojë pagesë nga konsumatori në bazë të kontratës jashtë hapësirave afariste të tregtarit para skadimit të 14 ditëve në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, respektivisht 30 ditë në rastet e paragrafit (2) të këtij neni nga dita e lidhjes së kontratës.

(6) Kur tregtari nuk ia ka dhënë konsumatorit informacionet parakontraktuale që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen dhe me kushtet dhe procedurën për realizimin e së drejtës së tërheqjes, në përputhje me dispozitat nga ky ligj, si dhe rregullën nga neni 120 paragrafi (6) i këtij ligji, afati për tërheqje skadon pas kalimit të 12 muajve dhe 14 ditëve në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, respektivisht 12 muaj e 30 ditë në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni nga afati i përcaktuar në paragrafin (3) të këtij neni.

(7) Kur tregtari ia ka dhënë konsumatorit informacionet parakontraktuale që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen dhe me kushtet dhe procedurën për realizimin e së drejtës së tërheqjes, në përputhje me dispozitat nga ky ligj, si dhe rregullën nga neni 120 paragrafi (6) i këtij ligji, në afat prej 12 muajve nga afati i paragrafit (3) të këtij neni, afati për tërheqje skadon pas kalimit të 14 ditëve në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, respektivisht 30 ditë në rastet nga paragrafi (2) i këtij neni nga dita kur konsumatori i ka marrë këto informacione.

Mënyrat e realizimit të së drejtës për tërheqje

Neni 128

(1) Konsumatori që ka për qëllim të ushtrojë të drejtën e tërheqjes nga kontrata duhet të njoftojë për këtë tregtarin përpara se të skadojë afati për tërheqje.

(2) Të drejtën e tërheqjes nga kontrata konsumatori e realizon me dërgimin e formularit për tërheqje nga kontrata e përcaktuar në rregullën nga neni 120 paragrafi (6) i këtij ligji përmes çfarëdo deklarate tjetër të padiskutueshme për vendimin e tij për t'u tërhequr nga kontrata.

(3) Afati për njoftimin e tregtarit për tërheqjen nga kontrata është respektuar nëse njoftimi është dërguar nga konsumatori përpara skadimit të afatit të tërheqjes nga neni 127 i këtij ligji.

(4) Krahas mënyrave të realizimit të së drejtës për tërheqje nga kontrata të përcaktuara në qëndrimet (1) dhe (2) të këtij neni, tregtari mundet përmes faqes së tij të internetit t'ia vendosë në dispozicion konsumatorit edhe opsionin e plotësimit elektronik dhe parashtrimin të formularit për tërheqje nga kontrata e nënshkruar në rregullën nga neni 120 paragrafi (6) i këtij neni, si dhe çfarëdo deklarate tjetër të padiskutueshme për vendimin e tij për tërheqje nga kontrata.

(5) Në rastet nga paragrafi (4) i këtij neni, tregtari është i detyruar që konsumatorit t'i dërgojë vërtetim për pranimin e njoftimit përkatës për tërheqje nga kontrata, pa prolongim dhe në bartës të përhershëm.

(6) Në raport me mënyrën e realizimit të së drejtës së tërheqjes nga kontrata në përputhje me dispozitat e këtij neni, barra e dëshmimit është te konsumatori.

Veprimi i përgjithshëm i realizimit të së drejtës për tërheqje

Neni 129

(1) Realizimi i së drejtës së tërheqjes nga kontrata përkatëse nga konsumatori ka veprimin e ndërprerjes së kontratës.

(2) Ndërprerja e kontratës, në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, nënkupton ndërprerjen e detyrimeve të palëve për përmbushjen e kontratës në distancë ose kontratën jashtë hapësirave afariste të tregtarit ose ndërprerjen e detyrimeve të palëve për lidhjen e kontrata në distancë ose kontratës jashtë hapësirave afariste të tregtarit, e kur ofertën për lidhjen e tyre e ka dhënë konsumatori.

Detyrime të tregtarit në rast të tërheqjes

Neni 130

(1) Tregtari është i detyruar t'ia kthejë konsumatorit të gjitha pagesat e kryera nga ana e tij si dhe, ku është e zbatueshme, shpenzimet për dërgesë, pa prolongim, por jo më vonë se 14 ditë në rastet nga neni 127 paragrafi (1) i këtij ligji, respektivisht 30 ditë në rastet nga neni 127 paragrafi (2) i këtij ligji, nga dita kur është njoftuar për vendimin e konsumatorit për tërheqje nga kontrata në përputhje me nenin 128 të këtij ligji.

(2) Tregtari është i detyruar të bëjë kthimin nga paragrafi (1) i këtij neni duke shfrytëzuar mjetet e njëjta që i ka shfrytëzuar konsumatori gjatë pagesës së tij të parë, përveç nëse konsumatori shprehimisht nuk është pajtuar ndryshe dhe me kusht që konsumatori të mos jetë i detyruar të shlyejë çfarëdo shpenzimesh ose kompensimesh që rezultojnë nga kthimi i këtillë.

(3) Pa marrë parasysh dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, tregtari nuk është i detyruar të bëjë kthimin e shpenzimeve plotësuese, e kur konsumatori shprehimisht ka zgjedhur mënyrën e dërgesës që është e ndryshme nga lloji më i lirë i standard i dërgesës që e ofron tregtari.

(4) Me përjashtim të rastit të kontratës për shitje tregtari ka ofruar që vetë të marrë përsipër mallrat, tregtari mund të mbajë kthimin e pagesave derisa nuk i kthehen mallrat ose derisa konsumatori nuk i siguron dëshmi se mallrat ia ka kthyer tregtarit, varësisht nga ajo se cili veprim do të ndodhë së pari.

(5) Tregtari është i detyruar t'i mbrojë të dhënat personale të konsumatorit në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(6) Tregtari nuk guxon të përdorë çfarëdo përmbajtje tjetër përveç të dhënave personale, e që konsumatori e ka siguruar ose krijuar gjatë shfrytëzimit të të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital të furnizuar nga tregtari, përveçse në rastet kur ajo përmbajtje:

1) është i papërdorshëm jashtë kontekstit të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital të furnizuar nga tregtari;

2) i referohet ekskluzivisht aktivitetit të konsumatorit kur shfrytëzohet përmbajtja digjitale ose shërbimin digjital i furnizuar nga tregtari;

3) tregtari e ka bashkuar me të dhëna të tjera dhe nuk mund ta ndajë ose për ndarjen e tillë do të nevojiteshin përpjekje disproporcionale ose

4) është krijuar bashkërisht nga konsumatori dhe persona të tjerë, ndërsa konsumatorët tjerë janë në gjendje të vazhdojnë të përdorin përmbajtjen.

(7) Me përjashtim të paragrafit (6) pikat 1), 2) dhe 3) të këtij neni, tregtari është i detyruar që me kërkesë të konsumatorit t'i vendosë në dispozicion çdo përmbajtje që nuk përfshin të dhëna personale, e të cilat konsumatori i ka siguruar ose krijuar gjatë shfrytëzimit të të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital të furnizuar nga tregtari.

(8) Konsumatori ka të drejtë përmbajtjen digjitale nga paragrafi (7) i këtij neni ta marrë pa pagesë, pa kufizime nga tregtari, në afat të arsyeshëm dhe në formatin e zakonshëm dhe të lexueshëm nga pajisja informatike që përdoret zakonisht.

(9) Në rast të tërheqjes nga kontrata, tregtari mund të parandalojë çfarëdo shfrytëzimi të mëtejshëm të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital nga ana e konsumatorit, veçanërisht në atë mënyrë që konsumatorit do t'ia pamundësojë qasjen në përmbajtjen digjitale ose shërbimin digjital ose duke pamundësuar llogarinë e përdorimit e konsumatorit.

Detyrimet e konsumatorit në rast të tërheqjes

Neni 131

(1) Me përjashtim të rasteve kur tregtari ka ofruar ta marrë përsipër mallrat, konsumatori është i detyruar t'ia kthejë mallrat tregtarit ose t'ia dorëzojë atij ose subjektit të autorizuar nga tregtari për të marrë mallin, pa prolongim, por jo më vonë se 14 ditë në rastet nga neni 127 paragrafi (1) i këtij ligji, respektivisht 30 ditë në rastet nga neni 127 paragrafi (2) i këtij ligji, nga dita kur ka njoftuar tregtarin për vendimin për tërheqje nga kontrata, në përputhje me dispozitat nga neni 128 i këtij ligji, me ç'rast të konsiderohet se konsumatori e ka respektuar afatin nëse mallrat ia ka kthyer tregtarit para skadimit të afatit prej 14, respektivisht 30 ditëve.

(2) Konsumatori është i detyruar t'i marrë përsipër vetëm shpenzimet e drejtpërdrejta për kthimin e mallrave, përveç nëse tregtari nuk ka pranuar t'i marrë përsipër këto shpenzime ose nëse tregtari nuk e ka njoftuar konsumatorin se është ai që është i detyruar t'i marrë përsipër ato.

(3) Në rast të kontratës jashtë hapësirave afariste të tregtarit ku janë dërguar mallrat në shtëpinë e konsumatorit gjatë vetë lidhjes së saj, tregtari është i detyruar që mallin ta marrë përsipër në shpenzim personal, nëse mallrat për nga natyra e tyre janë të tilla që nuk mund të kthehen normalisht përmes postës.

(4) Konsumatori është përgjegjës vetëm për vlerën e ulur të mallrave që është pasojë e trajtimit të tyre që nuk është e nevojshme për përcaktimin e natyrës së tyre, shenja dhe funksionim me atë që konsumatori, sidoqoftë, nuk është përgjegjës për vlerën e ulur të mallrave kur tregtari nuk i ka dhënë konsumatorit informacione parakontraktual që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen dhe kushtet dhe procedurën e ushtrimit të së drejtës së tërheqjes, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe me rregulloren nga neni 120 paragrafi (6) i këtij ligji.

(5) Kur konsumatori realizon të drejtën e tërheqjes nga kontrata, te kontratat për shërbime, te kontratat për furnizim me ujë, gaz ose energji elektrike, kur këto nuk ofrohen për shitje në vëllim ose sasi të përcaktuar saktësisht, si dhe te kontratat e furnizimit të ngrohjes qendrore, pasi ka

dorëzuar kërkesë të qartë për të filluar zbatimin e tyre përpara skadimit të afatit për tërheqje nga kontrata, ai është i detyruar t'i paguajë tregtarit shumën që është proporcional me atë që është zbatuar deri në kohën kur konsumatori e ka njoftuar tregtarin për realizimin e së drejtës së tërheqjes në raport me vlerën e përgjithshme të kontratës.

(6) Në rast të tërheqjes nga kontrata, konsumatori nuk guxon të shfrytëzojë përmbajtjen digjitale ose shërbimin digjital dhe ta bëjë të arritshme për palë të treta.

(7) Pëlqimi (5) i këtij neni, shuma proporcionale që konsumatori është i detyruar t'ia paguajë tregtarit llogaritet në bazë të çmimit të përgjithshëm të kontraktuar, me atë që, ku kur çmimi i përgjithshëm është tepër i lartë, shuma proporcionale llogaritet në bazë të vlerës së tregut të shërbimit që është kryer.

(8) Konsumatori nuk është i detyruar të marrë përsipër shpenzimet për:

1) ushtrimin e shërbimeve ose furnizimit me ujë, gaz ose energji elektrike, kur këto nuk ofrohen për shitje në një vëllim ose sasi të përcaktuar saktësisht, si dhe furnizimit të ngrohjes qendrore, tërësisht ose pjesërisht, e gjatë kohëzgjatjes së afatit për tërheqje nga kontrata, nëse:

a) tregtari nuk i ka dhënë konsumatorit informacionin parakontraktual që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen, kushtet dhe procedurën e realizimit të së drejtës për tërheqje nga kontrata, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, si dhe rregullën nga neni 120 paragrafi (6) i këtij ligji, respektivisht nuk ia ka dhënë konsumatorit informacionet parakontraktuale që kanë të bëjnë me të përmendurit se nëse konsumatori e realizon të drejtën e tërheqjes pasi ka parashtruar kërkesë për ushtrimin e shërbimeve ose për dërgimin e mallrave përkatës në përputhje me këtë ligj, ai është i detyruar t'ia paguajë tregtarit shpenzimet e arsyeshme në përputhje me këtë ligj ose

b) në rastet kur konsumatori vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji, ushtrimin e shërbimeve ose furnizimin me ujë, gaz ose energji elektrike, kur këto nuk ofrohen për shitje në vëllim ose sasi të përcaktuar saktësisht, si dhe furnizimi i ngrohjes qendrore të fillojë para skadimit të afatit për tërheqje nga kontrata, konsumatori nuk ka parashtruar shprehimisht kërkesë që realizimi i tyre të fillojë përpara skadimit të afatit për tërheqje nga kontrata ose

2) dërgimi i përmbajtjes së plotë ose të pjesshme digjitale që nuk është dërguar, e në bartës të përhershëm, nëse:

a) konsumatori nuk ka dhënë paraprakisht pëlqimin e qartë për fillimin e ekzekutimit të kontratës para skadimit të afatit prej 14 ditësh, pra 30 ditë, në përputhje me nenin 127 të këtij ligji;

b) konsumatori nuk është darkorduar të humbasë të drejtën për t'u tërhequr nga kontrata kur ka dhënë shprehimisht pëlqimin e tij për fillimin e realizimit të kontratës; ose

c) tregtari nuk i ka dhënë konsumatorit vërtetim për pëlqimin e shprehur paraprak dhe pranimin e konsumatorit për realizimin e kontratës.

(9) Në përputhje me dispozitat nga neni 128 i këtij ligji dhe me dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3), (4), (5), (6) dhe (8) të këtij neni, konsumatori nuk ka kurrfarë përgjegjësie si pasojë e realizimit të së drejtës së tij për tërheqje.

Ndërprerja e vlefshmërisë së kontratave dytësore

Neni 132

(1) Pa marrë parasysh dispozitat nga neni 15 i Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve në kontratat për kredisë konsumatore, nëse konsumatori dëshiron të ushtrojë të drejtën e tij për tërheqje nga kontrata në distancë ose nga kontrata jashtë hapësirës afariste të tregtarit, në përputhje me nenet 127, 128, 129, 130 dhe 131 të këtij ligji, të gjitha kontratat dytësore pushojnë menjëherë të vlejné përveç atyre të përcaktuara në nenin 130 paragrafi (3) dhe nenin 131 paragrafi (8) i këtij ligji.

(2) Në raport me veprimin e ndërprerjes së vlefshmërisë së kontratave dytësore, zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat nga Ligji për marrëdhëniet detyimore, por pa detyrimin e konsumatorit që të përgjigjet për çfarëdo shpenzime ose dëm të lidhur me vetë ndërprerjen e kontratave dytësore, përveç atyre të parashikuara shprehimisht në dispozitat e këtij ligji.

Rastet kur përjashtohet e drejta e tërheqjes

Neni 133

(1) E drejta për tërheqje nga kontrata në distancë ose nga kontrata jashtë hapësirës afariste të tregtarit, në përputhje me nenet 127, 128, 129, 130 dhe 131 është përjashtuar në rastet e:

1) kontratave për shërbimit kur shërbimi është kryer plotësisht, por nëse nga kontrata për konsumatorin rezulton detyrimi për pagesë vetëm nëse ushtrimi ka filluar me pëlqimin paraprak të qartë të konsumatorit dhe me pranimin e tij të qartë se ai humbet të drejtën për tërheqje nga kontrata, pasi kontrata të jetë realizuar plotësisht nga tregtari;

2) furnizimit të mallrave ose shërbimeve, çmimi i të cilave varet nga luhatjet në tregjet financiare mbi të cilat tregtari nuk ka ndikim, e që mund të ndodhin gjatë afatit të tërheqjes nga kontrata;

3) furnizimit të mallrave të përpunuara sipas specifikimit të konsumatorit ose të mallrave që dukshëm janë të përshtatura për konsumatorin;

4) furnizimit të mallrave që prishen lehtë ose të mallrave me afat të shkurtër skadimi;

5) furnizimit të mallrave të mbyllura origjinale që nuk janë të përshtatshme për kthim për arsye higjienike ose mbrojtjes së shëndetit, e që janë të hapura pas dorëzimit;

6) furnizimit të mallrave që sipas natyrës së tyre pas dorëzimit përzihen në mënyrë të pandashme me artikuj të tjerë;

7) furnizimit të pijeve alkoolike, çmimi i të cilave është dakorduar në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes, e dorëzimi i së cilës mund të bëhet tek pas 30 ditësh dhe vlera reale e të cilave varet nga luhatjet e tregut në të cilan tregtari nuk ka ndikim;

8) kontratave kur konsumatori ka kërkuar në mënyrë të veçantë vizitë nga tregtari me qëllim të kryerjes së riparimeve urgjente ose mirëmbajtjes, me kusht që, kur gjatë një vizite të tillë, tregtari ushtron shërbime që janë plotësuese në raport me ata që konsumatori i ka kërkuar ose i janë dërguar mallra plotësuese që nuk janë pjesë zëvendësuese të domosdoshme për riparimin ose mirëmbajtjen, e drejta e tërheqjes së kontratës zbatohet në këto shërbime ose mallra plotësuese;

9) furnizimit të regjistrimeve të mbyllura audio dhe video, si dhe të programeve kompjuterike që janë të hapura pas dorëzimit;

10) blerjes së gazetave, botimeve periodike ose revistave, me përjashtim të kontratave me parapagim për furnizimin e botimeve të tilla;

11) kontratave të lidhura në ankand publik;

12) sigurimit të shërbimeve të akomodimit, kur nuk është për nevojat e banimit, transportit të mallrave, shërbimeve të automobilave me qira, kateringut ose shërbimeve që lidhen me aktivitetet në kohë të lirë, nëse me kontratën parashikohet datë e caktuar ose afat i zbatimit dhe

13) kontratave për furnizim me përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale, kur ato nuk furnizohen me bartës të përhershëm dhe atë kur realizimi i kontratës ka filluar, e nga kontrata për konsumatorin rezulton detyrimi për pagesë, vetëm nëse:

a) konsumatori ka dhënë pëlqimin e qartë për fillimin e përmbushjes së kontratës gjatë periudhës së tërheqjes;

b) konsumatori ka pranuar shprehimisht se me këtë humbet e drejta e tërheqjes nga kontrata dhe

c) tregtari i ka siguruar vërtetimet në përputhje me nenin 125 paragrafi (3) i këtij ligji dhe neni 126 paragrafi (14) i këtij ligji.

(2) Përfshirjet nga paragrafi (1) pikat 1), 2), 3) dhe 5) të këtij neni nuk do të zbatohen në kontratat e lidhura gjatë vizitave të pakërkua në shtëpinë e konsumatorit nga tregtari ose në ekskursionet e organizuara nga tregtari me synimin ose qëllimin e promovimit ose shitjes së mallrave për konsumatorët.

(3) Në rast të kontratës për shërbim nga e cila konsumatori është i detyruar të paguajë, e konsumatori ka kërkuar shprehimisht vizitë nga tregtari për të kryer riparime, konsumatori humbet të drejtën të tërhiqet pasi shërbimi të jetë kryer plotësisht kusht që përmbushja e kontratës të ketë filluar me pëlqimin e shprehur paraprakisht të konsumatorit.

Кapитulli 5

KONTRATAT PËR PËRDORIM ME AFAT TË PALUAJTSHMËRISË, PËR PRODUKT AFATGJATË PËR PUSHIM, PËR RISHITJE DHE PËR SHKËMBIM

Pjesa 1

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Vëllimi i zbatimit

Neni 134

(1) Mbrojtja e konsumatorëve për kontrata për përdorim me afat të paluajtshmërisë, kontratat për produkt afatgjatë për pushim, kontratat e rishitjes dhe kontratat e shkëmbimit të lidhura ndërmjet konsumatorit dhe tregtarit, është rregulluar në nenet 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147 dhe 148 të këtij ligji.

(2) Gjatë përlogaritjes së kohës së vlefshmërisë së kontratës për përdorim me afat të paluajtshmërisë ose të kontratës për produkt afatgjatë për pushim, do të merret parasysh çdo dispozitë nga kontrata përkatëse që mundëson ripërtëritjen ose vazhdimin e saj të heshtur.

Vëllimi i zbatimit të rregullave të tjera

Neni 135

Me dispozitat me të cilat rregullohen kontratat nga neni 134 i këtij ligji nuk preket në zbatimin e:

1) dispozitat e përgjithshme të Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore në raport me mjetet juridike;

2) rregullat për regjistrimin ose evidentimin e objekteve të patundshme ose të tundshme, si dhe rregullat për transmetimin e paluajtshmërive;

3) rregullat me të cilat rregullohen kushtet për themelimin e shoqërive tregtare, dhënien e autorizimit ose licencave për ushtrimin e veprimtarive që janë të rregulluara me rregulla të veçanta dhe

4) rregulloret që kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave që janë përmbajtje e kontratave nga dispozitat e këtij neni dhe neneve 134, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147 dhe 148 të këtij ligji.

Zbatimi i dispozitave për kontrata për për përdorim me afat të paluajtshmërisë, për produkt afatgjatë për pushim, për rishitje dhe për shkëmbim

Neni 136

(1) Zbatimi i dispozitave të këtij neni dhe neneve 134, 135, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147 dhe 148 të këtij ligji me të cilat përcaktohen të drejtat e konsumatorit nuk mund të përjashtohet ose kufizohet me cilëndo dispozitë kontraktuale ose kontrata mes konsumatorit dhe tregtarit, në rastet kur në kontratën përkatëse janë zbatuar rregulloret në fuqi të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(2) Çdo kontrata ose ujdj që është në kundërshtim me paragrafin (1) të këtij neni është e pavlefshme.

(3) Kur në kontrata me element ndërnacional nuk është e zbatueshme e drejta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dispozitat nga ky nen dhe nenet 134, 135, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147 dhe 148 të këtij ligji, me të cilat përcaktohen të drejtat e konsumatorit, zbatohet pavarësisht nga rregullat për përcaktimin e së drejtës së vlefshme, si dispozita me zbatim të drejtpërdrejtë, në rastet kur paluajtshmëria gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Kur në kontrata me element ndërnacional nuk është e zbatueshme e drejta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, dispozitat nga ky nen dhe nenet 134, 135, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147 dhe 148 të këtij ligji, me të cilat përcaktohen të drejtat e konsumatorit, zbatohet pavarësisht nga rregullat për përcaktimin e së drejtës së vlefshme, si dispozita me zbatim të drejtpërdrejtë, në rastet kur kontrata përkatëse nuk ka të bëjë drejtpërdrejt me paluajtshmërinë, ndërsa tregtari ushtron veprimtari tregtare ose profesionale në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ose nga ana tjetër në çfarëdo mënyre i orienton këto veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me ç'rast vetë kontrata përkatëse bën pjesë në kuadër të këtyre veprimtarive.

Pjesa 2

DETYRIME PARA LIDHJES SË KONTRATAVE

Reklamim

Neni 137

(1) Tregtari është i detyruar në kuadër të çdo shpalljeje të theksojë mundësinë që konsumatori t'i marrë informacionet në përputhje me nenin 138 të këtij ligji për informimin parakontraktual, si dhe të tregojë se ku dhe si mund t'i marrë ato.

(2) Kur lidhja e kontratës për përdorimin e ndarë në aspektin kohorë të paluajtshmërisë, e kontratave për produkt afatgjatë për pushim, e kontratave për rishitje ose kontratave për shkëmbim duhet t'i ofrohen personalisht konsumatorit gjatë ndonjë ngjarjeje të promovimit ose për shitje, tregtari është i detyruar në ftesën të theksojë qartë qëllimin tregtar dhe natyrën e ngjarjes.

(3) Informacionet në përputhje me nenin 138 të këtij ligji që kanë të bëjnë me informacionet parakontraktuale duhet të jenë në dispozicion të konsumatorit në çdo kohë gjatë gjithë kohëzgjatjes së ngjarjes nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Është e ndaluar që tregtari t'i promovojë, reklamojë ose shesë përdorimin me afat të paluajtshmërisë dhe produktin afatgjatë për pushim si investim.

Detyrimi për informim parakontraktual

Neni 138

(1) Përpara se konsumatori të detyrohet me çfarëdo kontrata apo çfarëdo oferte, tregtari është i detyruar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme t'ia japë konsumatorit informacionet e sakta dhe përkatëse vijuese:

1) në rast të kontratës për përdorimin me afat të paluajtshmërisë, përmes formularit standard me informacione në përputhje me rregullën nga paragrafi (6) i këtij neni;

2) në rast të kontratës për produkt afatgjatë për pushim, përmes formularit standard me informacione në përputhje me rregullën nga paragrafi (6) i këtij neni;

3) në rast të kontratës për rishitje, përmes formularit standard me informacione në përputhje me rregullën nga paragrafi (6) i këtij neni;

4) në rast të kontratës për shkëmbim, përmes formularit standard me informacione në përputhje me rregullën nga paragrafi (6) i këtij neni;

(2) Tregtari është i detyruar që informacionet nga paragrafi (1) i këtij neni t'ia japë konsumatorit pa kompensim edhe atë në formë të shkruar ose në bartës tjetër të përhershëm që është lehtësisht i arritshëm dhe i kapshëm për konsumatorin.

(3) Tregtari është i detyruar informacionet nga paragrafi (1) i këtij neni t'ia dorëzojë konsumatorit, të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj, gjë që nuk përjashton mundësinë e përdorimit të njëkohshëm edhe të gjuhëve të tjera.

(4) Në rast të kontestit për atë nëse, kur apo si i janë dhënë konsumatorit informacionet nga paragrafi (1) i këtij neni, barra e dëshmimit bie mbi tregtarin.

(5) Si e padrejtë, e pavlefshme është dispozita ose kushti kontraktual me të cilat parashikohet që barra e dëshmimit që, sipas dispozitave të këtij neni dhe neneve 134, 135, 136, 137, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146m 147 dhe 148 të këtij ligji, bie mbi tregtarin, kalon te konsumatori.

(6) Forma dhe përmbajtja e formularëve standard me informacione për kontratën për përdorimin me afat të paluajtshmërisë, për kontratën për produkt afatgjatë për pushim, për kontratën për rishitje dhe për kontratën për shkëmbim, si dhe formularin e veçantë standard për lehtësimin e së drejtës së tërheqjes nga këto kontratai përcakton ministri i Ekonomisë.

Pjesa 3

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Forma dhe gjuha e kontratave

Neni 139

(1) Kontrata nga neni 134 i këtij ligji duhet të lidhet në formë të shkruar, në letër ose në bartës tjetër të përhershëm.

(2) Kontratat nga neni 134 i këtij ligji duhet të përpilohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj, gjë që nuk përjashton mundësinë e përdorimit të njëkohshëm edhe të gjuhëve të tjera.

(3) Tregtari është i detyruar t'i dorëzojë konsumatorit një kopje ose disa kopje të kontratës në momentin e lidhjes së saj.

Detyrimi i informacioneve parakontraktuale

Neni 140

(1) Informacionet që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual nga neni 138 i këtij ligji, paraqesin pjesë përbërëse të kontratës përkatëse nga neni 134 i këtij ligji.

(2) Informacionet nga neni 138 i këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual nuk mund të ndryshohen përveç nëse palët shprehimisht pajtohen ndryshe ose nga ana tjetër, nëse ndryshimet vijnë nga rrethana të pazakonta dhe të paparashikueshme që janë jashtë kontrollit të tregtarit dhe pasojat e të cilave nuk ka mund t'i shmang madje edhe nëse do të kishte vepruar me gjithë kujdesin e duhur.

(3) Sidoqoftë, tregtari është i detyruar ndryshimet e informacioneve nga paragrafi (2) i këtij neni, t'ia njoftojë konsumatorit, para lidhjes së kontratës, në letër ose në bartës tjetër të përhershëm që është lehtësisht i arritshëm dhe i kapshëm për konsumatorin.

(4) Ndryshimet e informacioneve nga paragrafi (2) i këtij neni duhet të përcaktohen shprehimisht në kontratën.

(5) Tregtari është i detyruar që para lidhjes së kontratat t'i tregojë konsumatorit shprehimisht të drejtën e tij për tërheqje nga kontrata, kohëzgjatjen e afatit për tërheqje nga kontrata dhe ndalimin e pagesës paraprake gjatë kohëzgjatjes së afatit për tërheqje nga kontrata, në përputhje me nenin 142 të këtij ligji.

(6) Dispozitat kontraktuale nga paragrafi (5) i këtij neni konsumatori duhet t'i nënshkruajë individualisht.

Përmbajtja e kontratave

Neni 141

(1) Krahas informacioneve nga neni 138 i këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me informimin parakontraktual, në kontratën duhet të përfshin edhe:

1) të dhënat për identitetin dhe selinë, vendbanimin ose vendqëndrimin e secilës palë, si dhe nënshkrimi i secilës palë; dhe

2) data dhe vendi oe lidhjes së kontratës.

(2) Në mënyrë që të lehtësohet shfrytëzimi i së drejtës për tërheqje nga kontrata, kontrata duhet të përmbajë edhe formularin e veçantë standard për lehtësimin e së drejtës së tërheqjes të përcaktuar nga rregulla nga neni 138 paragrafi (6) i këtij ligji.

Pjesa 4

E DREJTA TËRHEQJES NGA KONTRATAT PËR PËRDORIMIN ME AFAT TË PALUAJTSHMËRISË, PËR PRODUKT AFATGJATË PER PUSHIM, PËR RISHITJE DHE PËR SHKËMBIM

Dispozitat e përgjithshme

Neni 142

(1) Krahas mjeteve juridike që i ka në dispozicion konsumatori në rast të shkeljes së dispozitave të këtij neni dhe neneve 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 143, 144, 145, 146, 147 dhe 148 nga ky ligj ose nga detyrimet kontraktual të tregtarit, konsumatori ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata e përdorimit me afat të paluajtshmërisë, nga kontrata për produkt afatgjatë per pushim, nga kontrata për rishitje dhe nga kontrata për shkëmbim, në afat prej 14 ditëve nga dita e lidhjes së kontratës, pa dhënë me këtë rast arsye apo arsyetim për tërheqjen nga kontrata përkatëse.

(2) Afati për tërheqje nga paragrafi (1) i këtij neni llogaritet:

1) nga dita e lidhjes së kontratës, respektivisht nga dita e lidhjes së ndonjë parakontrate përkatëse të detyrueshme ose

2) nga dita kur konsumatori do ta marrë kontratën, respektivisht nga dita kur konsumatori do ta marrë parakontratën përkatëse të detyrueshme, nëse kjo datë është e mëvonshme në raport me datën nga pika 1) e këtij paragrafi.

(3) Në çdo rast, afati për tërheqjen e kontratës skadon:

1) pas një viti e 14 ditë nga afati nga paragrafi (2) i këtij neni, dhe kur tregtari nuk e ka plotësuar formularin e veçantë standard për lehtësimin e së drejtës së tërheqjes të përcaktuar në rregullën nga neni 138 paragrafi (6) i këtij ligji dhe i njëjti nuk ia ka dhënë konsumatorit në formë të shkruar, në letër ose në bartës tjetër të përhershëm ose

2) pas tre muajve e 14 ditëve nga afati nga paragrafi (2) i këtij neni, e kur tregtari nuk ia ka dhënë konsumatorit informacionet në përputhje me nenin 138 të këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual, duke përfshirë edhe formularin e veçantë standard për lehtësimin e së drejtës së tërheqjes të përcaktuar në rregullën nga neni 138 paragrafi (6) i këtij ligji në formë të shkruar, në letër ose në bartës tjetër të përhershëm.

(4) Kur formularin e veçantë standard për lehtësimin e së drejtës së tërheqjes të përcaktuar në rregulloren nga neni 138 paragrafi (6) i këtij ligji, tregtari e ka plotësuar dhe ia ka dhënë konsumatorit në formë të shkruar, në letër ose në bartës tjetër të përhershëm, e në afat prej një viti nga afati nga paragrafi (2) i këtij neni, afati për tërheqje fillon nga dita kur konsumatori ka marrë formularin përkatës standard.

(5) Kur tregtari ia ka dhënë konsumatorit informacionet nga neni 138 i këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual, duke përfshirë formularin e veçantë standard për lehtësimin e së drejtës së tërheqjes, të përcaktuar në rregullën nga neni 138 paragrafi (6) të këtij ligji në formë të shkruar, në letër ose në bartës tjetër të përhershëm dhe në afat prej tre muajsh nga afati i përcaktuar në paragrafin (2) të këtij neni, afati i tërheqjes fillon nga dita kur konsumatori ka pranuar informacionin në përputhje me nenin 138 të këtij ligji që kanë të bëjnë me informimin parakontraktual, duke përfshirë formularin e veçantë standard për lehtësimin e së drejtës së tërheqjes, të përcaktuar në rregullën nga neni 138 paragrafi (6) i këtij ligji.

(6) Në rastet kur konsumatorit i është ofruar kontrata shkëmbimi së bashku dhe në të njëjtën kohë me kontratën për përdorim me afat të paluajtshmërisë, atëherë për të dyja kontratat zbatohet një afat i vetëm për tërheqje, në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, derisa përllogaritja e afatit për tërheqje për të dyja kontratat do të realizohet sipas dispozitës nga paragrafi (2) i këtij neni që ka të bëjë me kontratën për përdorimin me afat të paluajtshmërisë.

Mënyrat e realizimit të së drejtës së tërheqjes

Neni 143

(1) Konsumatori i cili synon të shfrytëzojë të drejtën e tërheqjes nga kontrata, duhet për këtë ta njoftojë tregtarin para skadimit të afatit për tërheqje nga kontrata në përputhje me nenin 142 të këtij ligji, në letër ose në bartës tjetër të përhershëm.

(2) Konsumatori mundet, por nuk është i detyruar, ta përdor formularin e veçantë standard për lehtësimin e së drejtës së tërheqjes të përcaktuar në rregulloren nga neni 138 paragrafi (6) i këtij ligji që tregtari ia ka dorëzuar.

(3) Afati për njoftimin e tregtarit për tërheqjen nga kontrata përkatëse është respektuar nëse njoftimi është bërë para skadimit të afatit për tërheqje.

Veprimi për realizimin e së drejtës së tërheqjes

Neni 144

(1) Realizimi i së drejtës për tërheqje nga kontrata e lidhur nga konsumatori ka veprim të ndërprerjes së kontratës.

(2) Kur konsumatori realizon të drejtën për tërheqje nga kontrata, ai nuk është përgjegjës për çfarëdo shpenzimi ose çfarëdo vlere për shërbimet që janë kryer para tërheqjes së tij nga kontrata përkatëse.

Ndalimi i paradhënies

Neni 145

(1) Te kontratat për përdorimin e ndarë në aspektin kohor të paluajtshmërisë, kontratat për produkt afatgjatë për pushim, kontrata për shkëmbim është e ndaluar çfarëdo paradhënie, dhënie të garancisë tregtare, rezervim i parave nga llogaria, njohjen e qartë e borxhit ose dhënie të çfarëdo kompensimi tjetër nga konsumatori i tregtarit ose i subjektit të tretë, e para skadimit të afatit për tërheqje nga kontrata, në përputhje me nenin 142 të këtij ligji.

(2) Te kontratat për rishitje, çdo paradhënie, dhënie garancie tregtare, rezervim parash nga llogaria, njohje e qartë e borxhit ose dhënie e çfarë kompensimi tjetër nga konsumatori te tregtari ose te ndonjë subjekt i tretë, ndërsa përpara shitjes reale ose ndërprerjes së kontratës për rishitje.

Pjesa 5

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR KONTRATAT PËR PËRDORIMIN ME AFAT TË PALUAJTSHMËRIVE

Neni 146

(1) Konsumatori i cili ka përvetësuar të drejtën e përdorimit me afat të paluajtshmërisë që gjendet në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, ka të drejtë të kërkojë regjistrimin e kësaj të drejte në Kadastrën e paluajtshmërive.

(2) Për regjistrimin nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen dispozitat e Ligjit të Kadastrës së Paluajtshmërive.

Pjesa 6

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR KONTRATAT PËR PRODUKT AFATGJATË PËR PUSHIM

Neni 147

(1) Çdo pagesë te kontratat për produkt afatgjatë bëhet në përputhje me planin për shlyerjen e kësteve.

(2) Ndalohet çdo pagesë e çmimit të parashikuar me kontrata për produktin afatgjatë për pushim që nuk është në përputhje me planin për shlyerje me këste.

(3) Çdo pagesë sipas kontratës për produkt afatgjatë për pushime, duke përfshirë edhe kompensimet për anëtarësim (kuotat e anëtarësimit), duhet të jetë e ndarë në këste vjetore në lartësi të barabartë.

(4) Tregtari është i detyruar t'i dërgojë konsumatorit kërkesë për pagesë në bazë të kontratës për produkt afatgjatë pushimi në formë të shkruar në letër ose në bartës tjetër të përhershëm, së paku 14 ditë para ditës së mbërritjes së çdo kësti individual.

(5) Duke filluar nga kësti i dytë e më tutje, konsumatori mund të ndërpresë kontratën për produkt afatgjatë për pushim pa detyrimin e tij për të paguar çfarëdo gjobë kontraktual, e përmes njoftimit të tregtarit të bërë në afat prej 14 ditëve nga marrja e kërkesës për pagesë të çdo kësti.

(6) E drejta e konsumatorit për ndërprerjen e kontratës nga paragrafi (5) i këtij neni, nuk ndikon në të drejtat e tij për ndërprerjen në përputhje me Ligjin e Marrëdhënieve Detyrimore.

Pjesa 7 NDËRPRERJA E KONTRATAVE DYTËSORE

Neni 148

(1) Me realizimin e të drejtës së tërheqjes nga kontrata për përdorimin me afat të paluajtshmërisë ose nga kontrata për produkt afatgjatë për pushim, sipas fuqisë së ligjit, ndërpritet edhe çfarëdo kontrata dytësore për shkëmbim ose çfarëdo kontrata tjetër dytësore, pa pësuar për këtë konsumatori ndonjë shpenzim.

(2) Pa marrë parasysh dispozitat e nenit 15 të Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve gjatë kontratave për kredi konsumatore, nëse konsumatori dëshiron të realizojë të drejtën e tij për tërheqje nga kontrata për përdorimin me afat të paluajtshmërisë, nga kontrata për produkt afatgjatë për pushim, nga kontrata e rishitjes ose kontrata e shkëmbimit, në përputhje me nenet 142, 143 dhe 147 paragrafi (5) i këtij ligji, të gjitha kontratat dytësore pushojnë të jenë të vlefshme menjëherë.

(3) Në raport me veprimin e ndërprerjes së kontratave dytësore, do të zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e Ligjit të Marrëdhënieve Detyrimore, por pa detyrimin e konsumatorit që të përgjigjet për çfarëdo shpenzimi ose dëmi të ndërlidhur me ndërprerjen e kontratave dytësore, përveç atyre të parashikuara shprehimisht me dispozitat e këtij neni.

KAPITULLI 6 KONTRATA PËR FURNIZIMIN ME PËRMBAJTJE DIGJITALE DHE SHËRBIME DIGJITALE

Pjesa 1 DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Vëllimi i zbatimit të dispozitave për kontratat për furnizimin me përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale

Neni 149

(1) Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen kontratat për furnizim me përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale do të zbatohen për çdo kontratë kur tregtari furnizon ose merr përsipër t'i furnizojë konsumatorin me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital, ndërsa konsumatori paguan ose merr përsipër pagesën e çmimit.

(2) Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen kontratat për furnizim me përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale zbatohen edhe kur tregtari furnizon ose detyrohet të furnizojë konsumatorin me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital, ndërsa konsumatori siguron ose detyrohet t'ia sigurojë tregtarit të dhënat personale, me përjashtim të rasteve kur të dhënat personale të ofruara nga konsumatori janë të përpunuar ekskluzivisht nga tregtari për furnizim me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital në përputhje me këtë ligj ose në mënyrë që t'i mundësohet tregtarit t'i respektojë kërkesat ligjore me të cilat është i detyruar, ndërsa tregtari nuk i përpunon ato të dhëna për çfarëdo qëllimi tjetër.

(3) Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen kontratat për furnizimin e përmbytjeve digjitale dhe shërbimeve digjitale zbatohen edhe kur përmbytja digjitale ose shërbimi digjital është siguruar në përputhje me kërkesat e konsumatorit.

(4) Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen kontratat për furnizim me përmbytje digjitale dhe shërbime digjitale zbatohen edhe në bartës të përhershëm që shërben vetëm si posedues i përmbytjes digjitale, përveç nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

(5) Me dispozitat e këtij neni dhe neneve 150, 151, 152, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168 dhe 169 të këtij ligji nuk preket në mundësinë që tregtarët t'u ofrojnë konsumatorëve hyrje në marrëdhënie kontraktual që nënkuptojnë nivel më të lartë të mbrojtjes sesa ajo që rezulton nga këto dispozita.

Përfshirjet nga zbatimi i dispozitave për kontratat për furnizimin me përmbytje digjitale dhe shërbime digjitale

Neni 150

(1) Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen kontratat për furnizim me përmbytje digjitale dhe shërbime digjitale nuk zbatohen në përmbytje digjitale apo shërbime digjitale që janë të përfshira ose të ndërlidhura me mallrat me element digjital dhe që furnizohen me mallra në bazë të kontratës për shitjen e atyre mallrave, pa marrë parasysh nëse kjo përmbytje digjitale ose shërbimi digjital është furnizuar nga shitësi ose nga ndonjë person i tretë.

(2) Në rast të dyshimit nëse furnizimi me përmbytje digjitale të përfshirë ose të ndërlidhur ose shërbimi digjital të instaluar ose të ndërlidhur është pjesë e kontratës së shitjes, konsiderohet se përmbytja digjitale ose shërbimi digjital është përfshirë me kontratën e shitjes.

(3) Dispozitat e këtij ligji me të cilat rregullohen kontratat për furnizim të përmbytjeve digjitale dhe shërbimeve digjitale nuk zbatohen në kontrata që kanë të bëjnë me:

1) sigurimin e shërbimeve që nuk janë shërbime digjitale, pavarësisht nëse format digjitale ose mjetet digjitale tregtari i shfrytëzon për prodhimin e produktit të shërbimit ose për dërgimin ose bartjen e të njëjtit deri te konsumatori;

2) shërbimet e komunikimit elektronik, me përjashtim të shumë shërbimeve të pavarura të komunikimeve elektronike ndërpersonale në përputhje me ligjin;

3) shërbimet e mbrojtjes shëndetësore në përputhje me ligjin;

4) shërbimet e lojërave të fatit, me fjalë tjera, shërbimet që përfshijnë investimin në hise me vlerë në para në lojërat e fatit, duke përfshirë ato me element të aftësisë, siç janë llotaritë, lojërat e kazinosë, lojërat e pokerit dhe bastet, përmes mjeteve elektronike ose çfarëdo teknologjie tjetër për të lehtësuar komunikimin dhe me kërkesë individuale të pranuesit të shërbimeve të tilla në përputhje me ligjin;

5) shërbimet financiare në përputhje me ligjin;

6) softueri që e ofron tregtari nën licencën e softuerit të lirë me burim të hapur, ku konsumatori nuk paguan çmim dhe të dhënat personale të siguruara nga konsumatori përpunohen ekskluzivisht nga tregtari për shkak të përmirësimit të sigurisë, konformitetit ose interoperabilitetit të asaj specifike të softuerit;

7) furnizimi me përmbytje digjitale ku përmbytja digjitale është e arritshme për opinionin e gjerë, me përjashtim të transmetimit të sinjalit si pjesë e një shfaqjeje ose ngjarjeje, siç janë projektionet digjitale kinematografike dhe

8) përmbytje digjitale e siguruar nga organet e sektorit publik.

(4) Kur në kontratën mes tregtarit të njëjtë dhe konsumatorit të njëjtë janë përfshirë edhe furnizimi me përmbytje digjitale ose shërbim digjital dhe furnizimi me mallra dhe shërbime të tjera, të drejtat dhe detyrimet nga kontrata që kanë të bëjnë me përmbytjen digjitale ose shërbimin digjital zbatohen dispozitat me të cilat rregullohen kontratat për furnizim me përmbytje digjitale dhe shërbime digjitale.

Pjesa 2
FURNIZIM ME PËRMBAJTJE DIGJITALE OSE SHËRBIM DIGJITAL

Detyrimet e tregtarit për furnizim me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital

Neni 151

(1) Tregtari është i detyruar t'i furnizojë konsumatorin me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

(2) Nëse palët nuk merren vesh ndryshe, tregtari duhet të furnizojë me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital pa prolongim të panevojshëm pas lidhjes së kontratës.

Kur do të konsiderohet se tregtari ka përmbushur detyrimin për furnizim me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital

Neni 152

Tregtari do të konsiderohet se ka përmbushur detyrimin për furnizim me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital nga neni 151 i këtij ligji kur:

1) përmbajtja digjitale ose çfarëdo mjeti i përshtatshëm për qasje në përmbajtje digjitale ose shkarkim të përmbajtjes digjitale është vënë në dispozicion të konsumatorit ose i është bërë e arritshme ose objekti fizik ose objekti virtual i zgjedhur nga konsumatori për këtë dedikim; dhe

2) shërbimi digjital është bërë i arritshëm për konsumatorin ose në objekt fizik ose në objekt virtual të zgjedhur nga konsumatori për këtë dedikim.

Pjesa 3

KONFORMITETI I PËRMBAJTJES DIGJITALE OSE SHËRBIMIT DIGJITAL

Detyrimi i konformitetit

Neni 153

Tregtari është i detyruar të furnizojë konsumatorin me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital që plotëson kërkesat subjektive dhe objektive për respektimin e kontratës për furnizim me përmbajtje digjitale dhe shërbim digjital të përcaktuar në nenet 154 dhe 155 të këtij ligji, nëse është e zbatueshme, kështu që nuk do të jetë në kundërshtim me kërkesat për të drejtat e personave të tretë të përcaktuara në nenin 157 të këtij ligji.

Kërkesat subjektive për konformitet të përmbajtjes digjitale dhe shërbimeve digjitale me kontratën

Neni 154

Përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital janë në përputhje me kontratën, aty ku është e zbatueshme, veçanërisht kur:

1) janë me përshkrim, sasi, cilësi dhe funksionalitet, kompatibilitet, interoperabilitet dhe karakteristika të tjera, siç është parashikuar me kontratën;

2) janë të përshtatshme për dedikimin e posaçëm për të cilin konsumatori i furnizon, për çka tregtari ka ditur në momentin e lidhjes së kontratës dhe e ka pranuar të njëjtën;

3) janë furnizuar me të gjithë shtesat, udhëzimet, duke përfshirë edhe instalimin dhe mbështetjen e përdoruesit, siç është parashikuar me kontratën dhe

4) azhurnohen siç është parashikuar me kontratën.

Kërkesat objektive për përputhshmërinë e përmbajtjes digjitale dhe shërbimit digjital me kontratën

Neni 155

(1) krahas përmbushjes së të gjitha kërkesave subjektive për përputhshmëri nga neni 154 i këtij ligji, që të konsiderohet se janë të përputhshme me kontratën përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital, duhet të:

1) janë të përshtatshme për dedikimin për të cilin zakonisht përdoren përmbajtja digjitale ose shërbimet digjitale të llojit të njëjtë, aty ku është e zbatueshme, në përputhje me rregullat e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Bashkimit Europian, standardet teknike ose në mungesë të standardeve të tilla teknike, kodet e sjelljes në sektorin përkatës;

2) janë në sasi të mjaftueshme dhe kanë veti dhe karakteristika të realizimit, duke përfshirë edhe në raport me funksionalitetin, kompatibilitetin, qasjen, vazhdimësinë dhe sigurinë, që janë të zakonshme për përmbajtjen digjitale ose shërbimet digjitale të llojit të njëjtë dhe që konsumatori mund t'i presë në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh natyrën e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital dhe duke marrë parasysh të gjitha deklaratat publike të bërë nga ose në emër të tregtarit, ose nga persona të tjerë në fazat paraprake të zinxhirit të njëjtë të kontratave, në veçanti në reklamim ose shënim, përveç nëse tregtari nuk dëshmon se:

a) nuk ka ditur dhe nuk mund të kishte ditur në mënyrë të arsyeshme për deklaratat përkatëse;

b) deri në momentin e lidhjes së kontratës deklarata publike është korrigjuar në mënyrë të njëjtë ose në mënyrë të krahasueshme me atë të cilës i është dhënë ose

c) ajo deklaratë publike nuk mund të ndikojë në vendimin e konsumatorit për të blerë përmbajtje digjitale ose shërbim digjital;

3) aty ku është e zbatueshme, furnizohet me të gjitha shtesat dhe udhëzimet që konsumatori mund të presë në mënyrë të arsyeshme t'i marrë; dhe

4) janë në përputhje me çdo version provë ose pasqyrë paraprake të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital në dispozicion të tregtarit përpara lidhjes së kontratës.

(2) Tregtari garanton se konsumatori është i informuar dhe i sigurohen azhurnime, duke përfshirë azhurnimet e sigurisë, të cilat janë të nevojshme për ruajtjen e konformitetit së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital, në periudhë të caktuar kohore:

1) kur përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital realizohet në përputhje me kontratën, për kontrata ku është daorduar furnizimi i vazhdueshëm për një periudhë të caktuar kohore ose

2) çfarë mund të presë konsumatori në mënyrë të arsyeshme, duke marrë parasysh llojin dhe qëllimin e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital dhe duke marrë parasysh rrethanat dhe natyrën e kontratës, kur kontrata parashikon furnizim të njëhershëm ose një varg furnizimesh individuale.

(3) Nëse konsumatori, një afat të arsyeshëm, nuk i instalon azhurnimet e siguruara nga tregtari në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, tregtari nuk mban përgjegjësi për mospërputhjen që rezulton vetëm nga mosinstalimi i azhurnimit përkatës, me kusht që:

1) tregtari ta ketë informuar konsumatorin për arritshmërinë e azhurnimit dhe për pasojat e mungesës së instalimit të azhurnimit; dhe

2) konsumatori të mos e ketë instaluar azhurnimin ose instalimi joadekuat i azhurnimit nga konsumatori të mos jenë rezultat i mangësive në udhëzimet për instalim të dhëna nga tregtari.

(4) Kur kontrata parashikon furnizim të vazhdueshëm me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital për periudhë të caktuar kohore, përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital do të jenë në përputhje me kontratën për tërë kohëzgjatjen e asaj periudhe.

(5) Nuk do të konsiderohet moskonformiteti nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nëse në momentin e lidhjes së kontratës, konsumatori është njoftuar posaçërisht se një karakteristikë e caktuar e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjitale devijon nga kërkesat objektive për përputhshmëri dhe konsumatori e ka pranuar shprehimisht dhe në mënyrë specifike atë devijim gjatë lidhjes së kontratës.

(6) Përveç nëse palët dakordohen ndryshe, përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital do të realizohen në versionin më të ri të arritshëm gjatë lidhjes së kontratës.

Integrimi i parregullt i përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital

Neni 156

Moskonformitetet do të konsiderohet edhe çfarëdo mospërputhje që është pasojë e integrimit të parregullt të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital në rrethimin digjital të konsumatorit, nëse përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital është i integruar nga tregtari ose nën mbikëqyrjen e tij, si dhe kur përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital është dashur t'i integrojë konsumatori dhe atë e ka bërë, ndërsa integrimi i parregullt është pasojë e mangësive në udhëzimet për integrim të lëshuara nga tregtari.

Të drejtat e personave të tretë në raste të furnizimit me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital

Neni 157

Nëse shfrytëzimi i përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital në përputhje me nenet 154 dhe 155 të këtij ligji është pamundësuar ose kufizuar për shkak të shkeljes së cilësdo të drejte të personit të tretë, veçanërisht të drejtat e pronësisë intelektuale, konsumatori ka të drejta në rast të mospërputhjes së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital të parashikuara në nenet 161, 162, 163 dhe 164 të këtij ligji.

Pjesa 4

PËRGJEGJËSIA E TREGTARIT

Kur përgjigjet tregtari për përmbajtjen digjitale ose shërbimin digjital

Neni 158

(1) Tregtari përgjigjet kur nuk do të furnizojë konsumatorin me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital në përputhje me nenet 151 dhe 152 të këtij ligji.

(2) Kur kontrata parashikon furnizim të njëtrajtshëm ose një varg furnizimesh individuale, tregtari është përgjegjës për çdo mospërputhje që ka ekzistuar në kohën e furnizimit, pa marrë parasysh nëse tregtari e ka ditur për këtë, respektivisht ka përgjegjësi ligjore për mospërputhjen e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital.

(3) Tregtari është përgjegjës për mospërputhshmërinë dy vite nga dita e furnizimit me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital për konsumatorin, pa prekur në të drejtat nga neni 155 paragrafi (2) pika 2) e këtij Ligji.

(4) Kur kontrata parashikon furnizim të vazhdueshëm për periudhë të caktuara kohore, tregtari në përputhje me nenet 154, 155 dhe 156 të këtij ligji është përgjegjës për mospërputhshmërinë që do të shfaqet ose do të bëhet evidente në periudhën për të cilën përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital duhet të furnizohet sipas kontratës.

Barra e dëshmimit të furnizimit të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital

Neni 159

(1) Barra për dëshmim lidhur me atë nëse përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital është furnizuar në përputhje me nenet 151 dhe 152 të këtij ligji, bie mbi tregtarin.

(2) Në rastet kur kontrata parashikon furnizim të njëtrajtshëm ose një varg furnizimesh individuale, barra e dëshmimit lidhur me atë nëse përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital i furnizuar ka qenë i përputhshëm në kohën e furnizimit, bie mbi tregtarin për atë mospërputhshmëri që bëhet evidente në afat prej një viti nga koha kur furnizohet përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital.

(3) Në rastet kur kontrata parashikon furnizim të vazhdueshëm, barra e dëshmit nëse përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital ka qenë e përputhshme në kuadër të periudhës për të cilën përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital është dashur të furnizohet sipas kontratës, bie mbi tregtarin për mungesë të konformitetit, gjë që bëhet e dukshme gjatë asaj periudhe.

(4) Dispozitat nga paragrafët (2) dhe (3) i këtij neni nuk zbatohen nëse tregtari dëshmon se rrethimi digjital i konsumatorit nuk është kompatibil me kërkesat teknike të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital dhe nëse tregtari në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme e ka njoftuar konsumatorin për kërkesat e tilla para lidhjes së kontratës.

(5) Konsumatori duhet të bashkëpunojë me tregtarin, për aq sa është kjo e arsyeshme dhe e nevojshme, në mënyrë që të përcaktojë nëse arsyeja për mospërputhje të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital në kohën e përcaktuar për furnizim të njëtrajtshëm ose një varg furnizimesh individuale, respektivisht furnizim të vazhdueshëm, ku është e zbatueshme, është në rrethimin digjital të konsumatorit.

(6) Detyrimi i konsumatorit për bashkëpunim nga paragrafi (5) i këtij neni do të kufizohet në mjete të arritshme teknike që më së paku e ngarkojnë konsumatorin.

(7) Kur konsumatori nuk bashkëpunon dhe kur tregtari e ka njoftuar konsumatorin për kërkesat teknike në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme përpara lidhjes së kontratës, barra e dëshmimit lidhur me atë nëse ka pasur mospërputhje në kohën e përcaktuar në nenin 158 paragrafin (2) ose paragrafin (4) të këtij Ligji, siç është e zbatueshme, bie mbi konsumatorin.

Pjesa 5

PASOJAT LIGJORE NGA MOSFURNIZIMI DHE MOSKONFORMITETI E PËRMBAJTJES DIGJITALE OSE SHËRBIMIT DIGJITAL

Të drejtat e konsumatorit në rast të mosfurnizimit të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital

Neni 160

(1) Nëse tregtari nuk e ka furnizuar konsumatorin me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital në përputhje me nenet 151 dhe 152 të këtij Ligji, konsumatori duhet të ketë të drejtë t'i kërkojë tregtarit ta furnizojë atë me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital.

(2) Nëse tregtari edhe pas kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e furnizon konsumatorin me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital pa prolongim të panevojshme ose afat plotësues të dakorduar shprehimisht nga palët, konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën.

(3) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën, kur:

1) tregtari deklaroi, ose nga rrethanat është po aq e qartë, se tregtari nuk do ta furnizojë atë me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital dhe

2) konsumatori dhe tregtari janë dakorduar ose rrethanat e lidhjes së kontratës është e dukshme, se koha e caktuar për furnizim është thelbësore për konsumatorin, ndërsa tregtari nuk e ka furnizuar atë me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital deri në atë kohë ose në atë kohë.

(4) Nëse konsumatori e ndërpret kontratën në përputhje me paragrafët (2) ose (3) të këtij neni, zbatohen nenet 164, 165 dhe 166 të këtij ligji.

Të drejtat e konsumatorit në rast moskonformitetit së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital

Neni 161

Në rast mospërputhjes së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital me kontratën, konsumatori ka të drejtë të:

- 1) kërkojë mënjanimin e mospërputhjes së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital;
- 2) kërkojë uljen proporcionale të çmimit të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital ose;
- 3) të ndërpresë kontratën për furnizim me përmbajtje digjitale dhe shërbim digjital, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

E drejta për të mënjeluar mospërputhjen e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital

Neni 162

(1) Konsumatori ka të drejtë të kërkojë mënjanimin falas të mospërputhjes së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital, përveç nëse kjo është e pamundur ose joadekuate.

(2) Kërkesa e konsumatorit për mënjanimin e mospërputhjes konsiderohet joadekuate nëse tregtari tërheqë shpenzime që janë të paarsyeshme në raport me kërkesat tjera eventuale të konsumatorit, e duke marrë parasysh vlerën e mallit nëse nuk ka ekzistuar mospërputhja, rëndësia e mospërputhjes së konsumatorit, si dhe ajo nëse kërkesa tjetër eventuale e konsumatorit do të mund të ishte e plotësuar pa pakëndshmëri të konsiderueshme për konsumatorin.

(3) Tregtari ose personi i përcaktuar nga ana e tij është i detyruar të mënjanojë mospërputhjen e përmbajtjeve digjitale ose shërbimit digjital, në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni, në afat të arsyeshëm nga koha kur konsumatori e ka informuar tregtarin për mospërputhjen, falas dhe pa pakëndshmëri të konsiderueshme për konsumatorin, duke marrë parasysh natyrën e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital dhe qëllimin për të cilin konsumatori e furnizon përmbajtjen digjitale ose shërbimin digjital.

E drejta e uljes proporcionale të çmimit të përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital

Neni 163

(1) Konsumatori ka të drejtë për ulje proporcionale të çmimit kur përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital furnizohet në këmbim të pagesës së çmimit, në rastet vijuese:

- 1) kur mënjanimi i mospërputhjes së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital është i pamundur ose disproporcional;
- 2) kur tregtari ose personi i caktuar prej tij nuk ka hequr mospërputhjen e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital;
- 3) kur mospërputhja shfaqet përkundër përpjekjes së tregtarit ose personit të përcaktuar nga ana e tij për të mënjeluar mospërputhjen e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital;
- 4) kur moskonformiteti është e një natyre aq serioze saqë mund të justifikojë ulje të menjëhershme të çmimit ose
- 5) tregtari ose personi i përcaktuar nga ana e tij ka deklaruar, ose është e qartë nga rrethanat, se ai nuk do të mënjanojë mospërputhjen e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital në afat të arsyeshëm ose pa shqetësime të konsiderueshme për konsumatorin.

(2) Ulja proporcionale e çmimit bëhet sipas proporcionit mes vlerës së përmbajtjes së përshtatshme digjitale ose shërbimit digjital dhe vlerës së përmbajtjes së papërputhshme digjitale ose shërbimit digjital në kohën e lidhjes së kontratës.

(3) Kur kontrata parashikon që përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital të furnizohen për një periudhë të caktuar kohore në këmbim të pagesës së çmimit, ulja proporcionale e çmimit i referohet periudhës gjatë së cilës përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital ka qenë i papërputhshëm.

E drejta për ndërprerjen e kontratës për furnizimin e përmbajtjes digjitale dhe shërbimit digjital

Neni 164

(1) Konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën për furnizimin e përmbajtjes digjitale dhe shërbimit digjital, kur përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital furnizohet në këmbim të pagesës së çmimit, në rastet vijuese:

1) kur mënjanimi e mospërputhjes së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital është i pamundur ose disproporcional;

2) kur tregtari ose personi i caktuar prej tij nuk ka mënjeluar mospërputhjen e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital;

3) kur mospërputhja shfaqet përkundër përpjekjes së tregtarit ose personit të caktuar nga ana e tij për të mënjeluar mospërputhjen e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital;

4) kur mospërputhja është e një natyre aq serioze sa që mund të justifikojë ndërprerjen e kontratës ose

5) tregtari ose personi i caktuar nga ai ka deklaruar, ose është e qartë nga rrethanat, se ai nuk do të mënjanojë mospërputhjen e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital në kohe të arsyeshme ose pa shqetësim të konsiderueshëm për konsumatorin.

(2) Kur përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital furnizohet në këmbim të pagesës së çmimit, konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën vetëm nëse mospërputhja nuk është e rëndësisë më të vogël.

(3) Barra e dëshmimit lidhur me atë nëse mospërputhja është me rëndësi më të vogël bie mbi tregtarin.

(4) Konsumatori realizon të drejtën për të ndërprerë kontratën për furnizimin e përmbajtjes digjitale dhe shërbimit digjital me deklarate për tregtarin me të cilën shpreh vendimin për ndërprerjen e kontratës.

Detyrimet e tregtarit në rast ndërprerjeje të kontratës për furnizimin e përmbajtjes digjitale dhe shërbimit digjital

Neni 165

(1) Në rast të ndërprerjes së kontratës për furnizimin me përmbajtje digjitale dhe shërbimit digjital, tregtari është i detyruar t'ia kompensojë konsumatorit të gjitha shumat e paguara nga konsumatori sipas kontratës.

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, në rastet kur kontrata parashikon furnizimin e përmbajtjes digjitale ose shërbimi digjital si zëvendësim për pagesën e çmimit dhe për periudhë të caktuar kohore, ndërsa përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital kanë qenë të përputhshme një periudhë të caktuar kohore para ndërprerjes së kontratës, tregtari është i detyruar që konsumatorit t'ia kompensojë vetëm pjesën e përputhshme të çmimit të paguar që përputhet me periudhën në të cilën përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital kanë qenë të papërputhshme, si dhe në çdo pjesë të çmimit të paguar nga konsumatori paraprakisht për cilëndo periudhë të kontratës që do të mbetej nëse kontrata nuk ka qenë e ndërprerë.

(3) Në raport me të dhënat personal të konsumatorit, tregtari është i detyruar t'i respektojë detyrimet që rezultojnë nga rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale.

(4) Tregtari nuk guxon të shfrytëzojë çfarëdo përmbytje tjetër përveç të dhënave personale, e që konsumatori e ka siguruar ose krijuar gjatë përdorimit të përmbytjes digjitale ose shërbimit digjital të ofruar nga tregtari, përveç kur kjo përmbytje:

1) është e papërdorshme jashtë kontekstit të përmbytjes digjitale ose shërbimit digjital të siguruar nga tregtari;

2) ka të bëjë vetëm me aktivitetin e konsumatorit kur përdoret përmbytjen digjitale ose shërbimi digjital i dhënë nga tregtari;

3) tregtari e ka bashkuar me të dhëna të tjera dhe nuk mund të ndahet ose për një ndarje të tillë do të nevojiteshin përpjekje joproporcionale ose

4) është krijuar bashkërisht nga konsumatori dhe persona të tjerë, ndërsa konsumatorë të tjerë janë në gjendje të vazhdojnë të përdorin përmbytjen.

(5) Me përjashtim të paragrafit (4) pikave 1), 2) dhe 3) të këtij neni, tregtari është i detyruar, me kërkesë të konsumatorit, t'ia vendosë në dispozicion çdo përmbytje që nuk përfshin të dhënat personale, e që konsumatori e ka siguruar ose krijuar gjatë përdorimit të përmbytjes digjitale ose shërbimit digjital të ofruar nga tregtari.

(6) Konsumatori ka të drejtë përmbytjen digjitale nga paragrafi (5) i këtij neni ta marrë pa pagesë, pa kufizime nga tregtari, në afat të arsyeshëm dhe në formatin e zakonshëm dhe të lexueshëm nga pajisjet informatike që përdoren zakonisht.

(7) Pa prekur zbatimin e paragrafit (6) të këtij neni, tregtari mund të parandalojë çdo përdorim të mëtejshëm të përmbytjes digjitale ose shërbimit digjital nga konsumatori, veçanërisht në atë mënyrë që do ta pamundësojë konsumatorin të ketë qasje në përmbytjen digjitale ose shërbimin digjital ose do të pamundësojë llogarinë e përdoruesit të konsumatorit.

Detyrimet e konsumatorit në rast të ndërprerjes së kontratës për furnizimin e përmbytjes digjitale dhe shërbimit digjital

Neni 166

(1) Pas ndërprerjes së kontratës për furnizim me përmbytje digjitale dhe shërbim digjital, konsumatori nuk duhet të përdorë përmbytjen digjitale ose shërbimin digjital, si dhe t'ia vendosë ato në dispozicion të palëve të treta.

(2) Në qoftë se përmbytja digjitale është furnizuar në bartës të përhershëm, konsumatori ka detyrim, me kërkesë dhe në shpenzim të tregtarit, të kthejë bartësin e përhershëm tek tregtari pa vonesë të panevojshme.

(3) Kërkesa për kthimin e bartësit të përhershëm nga paragrafi (2) i këtij neni parashtrohet nga tregtari në afat prej 14 ditëve nga dita në të cilën tregtari është njoftuar për vendimin e konsumatorit se dëshiron të ndërpresë kontratën.

(4) Konsumatori nuk është i detyruar të paguajë kompensim për çfarëdo përdorimi të përmbytjes digjitale ose shërbimit digjital për kohën para ndërprerjes së kontratës, e për të cilën kohë përmbytja digjitale ose shërbimi digjital kanë qenë të papërputhshme.

Afatet dhe mënyrat e kthimit të asaj që është paguar

Neni 167

(1) Tregtari është i detyruar çdo shumë që ia ka borxh konsumatorit, për shkak të uljes proporcionale të çmimit në përputhje me nenin 163 të këtij ligji ose ndërprerjen e kontratës në përputhje me nenin 164 të këtij ligji, të paguajë pa prolongim të panevojshëm, e më së voni në afat prej 14 ditëve nga dita kur tregtari është njoftuar për vendimin e konsumatorit se kërkon ulje të çmimit ose se dëshiron ta prishë kontratën.

(2) Tregtari është i detyruar kthimin e shumave të paguara nga konsumatori ta bëjë me shfrytëzimin e mjeteve të njëjta të pagesës që i ka shfrytëzuar konsumatori gjatë pagesës së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital, përveç nëse konsumatori shprehimisht nuk dakordohet ndryshe dhe me kusht që konsumatori të mos duhet të paguajë kurrfarë shpenzimesh plotësuese për kthimin e tillë.

(3) Tregtari nuk guxon të arkëtojë kurrfarë shpenzimesh plotësuese gjatë kthimit të shumave të paguara nga konsumatori në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni.

Ndryshimi i përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital

Neni 168

(1) Nëse me kontratën është parashikuar përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital të furnizohet ose të jetë e arritshme për konsumatorin për periudhë të caktuar kohore, tregtari mund ta ndryshojë përmbajtjen digjitale ose shërbimin digjital jashtë të nevojshmes për mirëmbajtjen e konformitetit së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital në përputhje me nenet 154 dhe 155 të këtij neni, nëse janë përmbushur kushtet si vijon:

1) kontrata parashikon ndryshimin e tillë dhe në të janë përcaktuar shkaqet e arsyeshme për këtë;

2) ndryshimi bëhet pa shpenzime plotësuese për konsumatorin;

3) konsumatori informohet në një mënyrë të qartë dhe të kuptueshme për ndryshimin dhe

4) në rastet e përmendura në paragrafin (2) të këtij neni, konsumatori në afat të arsyeshëm para ndryshimit dhe në bartës të përhershëm është i informuar për karakteristikat dhe kohën e ndryshimit dhe për të drejtën që të ndërpresë kontratën në përputhje me paragrafin (2) të këtij neni ose për mundësinë e mirëmbajtjes së përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital pa ndryshim të tillë në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni.

(2) Konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën nëse ndryshimi në rastet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni ndikon negativisht në qasjen e konsumatorit ose përdorimin e përmbajtjes digjitale ose shërbimit digjital, përveç në rastet kur kjo ndikon negativisht dhe është e rëndësishme dytësore.

(3) Në rastin e paragrafit (2) të këtij neni, konsumatori ka të drejtë të ndërpresë kontratën falas, në afat prej 30 ditëve nga pranimi i informacionit ose nga koha kur përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital është ndryshuar nga tregtari, që ka ndodhur më vonë.

(4) Nëse konsumatori e ndërpret kontratën në përputhje me paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni, zbatohen në përputhje me nenin 164 paragrafi (4) dhe nenet 165, 166 dhe 167 të këtij ligji.

(5) Dispozitat nga paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni nuk zbatohen nëse tregtari i ka mundësuar konsumatorit ta mbajë atë, pa shpenzime plotësuese, përmbajtjen digjitale ose shërbimin digjital pa ndryshim, ndërsa përmbajtja digjitale ose shërbimi digjital edhe më tutje janë të përputhshme.

Përgjegjësia kaskade

Neni 169

(1) Kur tregtarit të drejtpërdrejt i konvenon që konsumatorit për arsye se nuk e ka furnizuar me përmbajtjen digjitale ose shërbimin digjital ose për shkak të mospërputhjes që është pasojë e veprimit ose mosveprimit të tregtarit paraprak në zinxhirin e njëjtë të kontratave, tregtari i drejtpërdrejt ka të drejtë të parashtojë kërkesa në raport me subjektin përgjegjës ose subjektet përgjegjëse në zinxhirin kontraktual.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen në mënyrë përkatëse edhe dispozitat nga Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore për regres.

Pjesa e katërt
MBROJTJA E TË DREJTAVE TË KONSUMATORËVE

Kreu 1
KORNIZA INSTITUCIONALE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË
KONSUMATORËVE

Kapitulli 1
PROGRAMI PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE

Miratimi i programit

Neni 170

(1) Për mbrojtjen e konsumatorëve Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut me propozim të ministrit të Ekonomisë miraton Program për mbrojtjen e konsumatorëve për periudhë prej një viti.

(2) Punët lidhur me zbatimin e politikave për mbrojtjen e konsumatorëve për punët e kryera nga Programi për mbrojtjen e konsumatorëve i ushtron Ministria e Ekonomisë.

(3) Mjetet për realizimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

(4) Ministri i Ekonomisë, një herë në viti dorëzon raport për zbatimin e Programit për mbrojtjen e konsumatorëve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më së voni deri në shkurt të vitit të ardhshëm.

Lënda e Programit

Neni 171

Në Programin për mbrojtjen e konsumatorëve nga neni 170 i këtij ligji rregullohen:

- 1) politika për mbrojtjen e konsumatorit;
- 2) masat dhe aktivitetet për realizimin e politikës për mbrojtjen e konsumatorëve;
- 3) këshillimin, edukimin dhe informimin e konsumatorëve dhe
- 4) mjetet për realizimin e Programit.

Këshilli për mbrojtjen e konsumatorëve

Neni 172

(1) Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me propozim të ministrit të Ekonomisë, formon Këshillin për mbrojtjen e konsumatorëve (në tekstin e mëtejshëm: Këshilli).

(2) Këshilli përbëhet nga 13 anëtarë nga përfaqësuesit e organeve të administratës shtetërore, kompetencat e të cilëve kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve, shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe dhomat ekonomike, edhe atë:

- 1) dy përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë (kryetari dhe sekretari i Këshillit) dhe
- 2) nga një përfaqësues nga:
 - Ministria e Financave;
 - Ministria e Drejtësisë;
 - Ministria e Punës dhe E Politikës Sociale;
 - Sekretariati i Çështjeve Europiane;
 - Byroja e Zhvillimit të Arsimit;
 - Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;

- Inspektorati Shtetëror i Tregut;
- Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor;
- Agjencia për Komunikime Elektronike;
- shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe
- dhomat ekonomike.

(3) Anëtarët e Këshillit kanë të drejtë kompensimi për pjesëmarrje në punën e Këshillit.

(4) Lartësinë e kompensimit nga paragrafi (3) i këtij neni e përcakton Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në lartësi prej një të tretës së pagës mesatare në Republikën e Maqedonisë së Veriut për pjesëmarrje në seancë të mbajtur në muaj.

Aktivitetet e Këshillit

Neni 173

Këshilli ushtron aktivitetet vijuese:

1) kujdeset për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të konsumatorëve në raport me mbrojtjen e shëndetit, sigurisë, interesave ekonomike dhe për informimin e rregullt të tyre në realizimin e të drejtave të tyre;

2) studion rregullat e vlefshme aktuale juridike dhe i propozon Ministrisë së Ekonomisë ndryshimet përkatëse në fushën e mbrojtjes juridike të konsumatorëve;

3) i propozon Ministrisë së Ekonomisë ndërmarrjen e masave përkatëse për mbrojtjen e shëndetit, sigurisë dhe interesave ekonomike të konsumatorëve;

4) të vlerësojë gjendjen në treg për sa i përket shkallës së mbrojtjes së konsumatorëve dhe

5) bën kujdes të veçantë për mbrojtjen e konsumatorëve që janë të mitur, personave të moshuar dhe të lodhur, personave të rrezikuar socialë, analfabetëve, emigrantëve dhe personave, vendbanimet e të cilëve ndodhen në zona vështirë të kalueshme.

Puna e Këshillit

Neni 174

(1) Punën e Këshillit e udhëheqë kryetari i Këshillit.

(2) Puna e Këshillit është publike.

(3) Këshilli për punën e tij miraton rregullore.

(4) Mandati i anëtarëve të Këshillit arrin katër vjet me të drejtë rizgjedhjeje.

Mbrojtja e konsumatorëve në nivel të komunës, respektivisht Qytetit të Shkupit

Neni 175

(1) Mbrojtja e konsumatorëve në nivel të komunës, përkatësisht të Qytetit të Shkupit, sigurohet përmes këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve të komunës, respektivisht të Qytetit të Shkupit.

(2) Këshillat për mbrojtjen e konsumatorëve nga paragrafi (1) i këtij neni, do të konstituohen si trupa të përhershëm punues të këshillave të komunave, përkatësisht të Qytetit të Shkupit.

(3) Anëtarët e këshillave për mbrojtjen e konsumatorëve nga paragrafi (1) i këtij neni zgjidhen nga radhët e këshilltarëve, shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe nga shoqatat tjera të qytetarëve, dhomat ekonomike, ndërmarrjet publike me seli në territorin e komunës dhe organet e mbikëqyrjes së tregut që ushtrojnë mbikëqyrje inspektuese në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.

(4) Këshillat për mbrojtjen e konsumatorëve nga paragrafi (1) i këtij neni propozojnë programe njëvjeçare lokale për mbrojtjen e konsumatorëve, në përputhje me Programin për mbrojtjen e konsumatorëve nga neni 170 i këtij ligji, të cilin e miratojnë këshillat e komunave, respektivisht Këshilli i Qytetit të Shkupit.

(5) Këshillat për mbrojtjen e konsumatorëve nga paragrafi (1) i këtij neni realizojnë kontakte dhe bashkëpunim të rregullt me Këshillin për mbrojtjen e konsumatorëve të formuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në përputhje me nenin 172 të këtij ligji.

(6) Komunat, përkatësisht Qyteti i Shkupit në kuadër të buxheteve të tyre mund të planifikojnë mjete për mbështetje të shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve që veprojnë në nivel lokal.

Kapitulli 2

SHOQATA PËR MBROJTJEN E KONSUMATORËVE DHE TË DHOMAVE EKONOMIKE

Pjesa 1

Shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve

Themelimi i shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve

Neni 176

(1) Shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, si bartës të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve, i themelojnë konsumatorët me qëllim të avancimit, realizimit dhe mbrojtjes së të drejtave të tyre.

(2) Shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve themelohen si shoqata, në përputhje me Ligjin e Shoqatave dhe të Fondacioneve.

Aktivitetet e shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve

Neni 177

Shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve zbatojnë aktivitetet vijuese:

- 1) inicojnë miratimin e rregullave të reja dhe ndryshimin e rregullave të pavlefshme;
- 2) japin mendime për propozimet e ligjeve dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve;
- 3) të inicojë seanca dëgjimore para Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve nga neni 172 i këtij ligji dhe këshillave për mbrojtjen e konsumatorëve të komunave, përkatësisht Qytetit të Shkupit nga neni 175 i këtij ligji dhe palëve të interesuara për çështjet që kanë të bëjnë me interesat e konsumatorëve;
- 4) bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacione me organet e mbikëqyrjes së tregut dhe organeve të tjera të administratës shtetërore dhe vetëqeverisjes lokale për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e konsumatorëve;
- 5) i informojnë dhe këshillojnë konsumatorët përmes këshillimit falas;
- 6) punë në parandalimin dhe edukimin e konsumatorëve dhe ngritjen e vetëdijes dhe kulturës konsumatore;
- 7) marrin pjesë në zbatimin e Programit të mbrojtjes së konsumatorëve nga neni 170 i këtij ligji;
- 8) shqyrtojnë ankesa të konsumatorëve drejtpërdrejt ose në bashkëpunim me organet e mbikëqyrjes së tregut dhe organet tjera të administratës shtetërore që kanë kompetenca të lidhura me mbrojtjen e konsumatorëve dhe u ofrojnë ndihmë juridike dhe këshilla konsumatorëve për çështjet e rregullave për mbrojtjen e konsumatorëve;

9) ndërmjetësojnë mes konsumatorëve dhe tregtarëve të mallrave dhe ofruesve të shërbimeve me qëllim të zgjidhjes së kontesteve;

10) ndihmojnë konsumatorët ose grupin e caktuar të konsumatorëve në ngritjen e padive në gjykatat kompetente për mbrojtjen e të drejtave të tyre dhe mund të përfaqësojë interesat e konsumatorëve në kontestet kolektive para gjykatave kompetente, nëse ata kanë autorizimin e duhur për ta bërë këtë dhe

11) zbatojnë mbrojtje parandaluese të konsumatorëve me njoftim dhe këshillim, gjegjësisht me edukim të konsumatorëve.

Kushtet që duhet t'i plotësojnë trupat e autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve

Neni 178

(1) Që një shoqatë e caktuar, fondacion, institucion ose organizatë tjetër që është themeluar në përputhje me ligjin dhe që në kuadër të veprimtarisë së saj të regjistruar merret me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, të konsiderohet organ i autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, është e nevojshme që krahas kërkesave të përcaktuara në nenin 180 të këtij ligji, kërkohet t'i plotësojë edhe kushte vijuese:

1) fusha dhe qëllimi i veprimit është mbrojtja e të drejtave të konsumatorëve;

2) të punojë në mënyrë aktive në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve së paku tri vjet në përputhje me aktivitetet e përcaktuara në nenin 177 të këtij ligji;

3) të ketë kapacitete adekuate njerëzore, materiale dhe teknike të nevojshme për ushtrimin e veprimtarive për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe

4) shoqata, fondacioni, institucioni ose organizata tjetër ose përfaqësuesit e të njëjtave, të kenë përvojën, ekspertizën dhe aftësitë përkatëse për të ushtruar veprimtari në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit në nivel nacional dhe ndërnacional.

(2) Është e ndaluar që një shoqata e caktuar, fondacion, institucion ose organizatë tjetër nga paragrafi (1) i këtij neni të paraqitet si organ i autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve nëse nuk i plotëson kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Organi kompetent për dhënien e autorizimit për trupin për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve

Neni 179

(1) Organi kompetent për autorizimin e trupave për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut është Ministria e Ekonomisë.

(2) Ministri i Ekonomisë i autorizon trupat për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve nëse i plotësojnë kushtet nga neni 178 i këtij ligji.

Kërkesë për autorizim të trupit për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve

Neni 180

(1) Për marrjen e autorizimit për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, parashtuesit, përkatësisht shoqatat, fondacionet, institucionet ose organizatat tjera që janë themeluar në përputhje me ligjin dhe të cilat në kuadër të veprimtarisë së tyre të regjistruar merren me mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në përputhje me nenin 177 të këtij ligji dhe i plotësojnë kërkesat nga neni 178 i këtij ligji, parashtrojnë kërkesë në zyrën e Sekretarisë së Ministrisë së Ekonomisë.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni me dokumentacionin shoqëruar nga paragrafi (3) i këtij neni mund të dorëzohet edhe në formë elektronike duke përdorur mjetin e identifikimit elektronik përmes Portalit nacional për shërbime elektronike ose përmes ndërmjetësuesit për shërbimet administrative në mënyrë elektronike në Ministrinë e Ekonomisë, në përputhje me rregullat në fushën e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike dhe në fushën e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(3) Kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni i bashkëngjitet:

1) statuti i shoqatës, fondacionit, institucionit ose organizatës tjetër;
2) vendimi për regjistrim në Regjistrin e personave të tjerë juridik dhe certifikata për gjendjen rrjedhëse;

3) dëshmi se mbrojtja e të drejtave të konsumatorit është veprimtaria kryesore e përcaktuar në statutin e shoqatës, fondacionit, institucionit ose organizatës tjetër dhe në regjistrimin e saj në Regjistrin e personave të tjerë juridikë:

4) dëshmi për aktivitetet dhe aftësitë e realizuara në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve;

5) dëshmi se shoqata, fondacioni, institucioni ose organizata tjetër është kryesisht aktive në fushën e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve së paku tre vjet dhe

6) dëshmi se shoqata, fondacioni, institucioni ose organizata tjetër është aktive në nivel ndërnacional në fusha që janë pjesë e mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve dhe

7) dëshmi se shoqata, fondacioni, institucioni ose organizata tjetër ka kapacitete adekuate njerëzore, materiale dhe teknike të nevojshme për ushtrimin e aktiviteteve për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve.

(4) Dëshmia nga paragrafi (3) pika 2) e këtij neni mund të merret nga Ministria e Ekonomisë sipas detyrës zyrtare në formë elektronike përmes Platformës nacionale për interoperabilitet, në përputhje me rregullat nga fusha e menaxhimit elektronik dhe shërbime elektronike në afat prej tre ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës nga shoqata, fondacioni, institucioni apo organizatë tjetër.

(5) Me përjashtim nga paragrafët (2) dhe (4) të këtij neni, e në rast të ndërprerjes teknike të funksionalitetit të Portalit nacional për shërbime elektronike ose të Platformës nacionale të interoperabilitetit, kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni me dokumentacionin përcjellës nga paragrafi (3) i këtij neni dhe dëshmitë nga paragrafi (3) pika 2) e këtij neni të siguruara sipas detyrës zyrtare mund të parashtrohen dhe dorëzohen në formë të dokumentit elektronik përmes dërgesës elektronike të regjistruar të rekomanduar në adresën elektronike në Ministrinë e Ekonomisë, në përputhje me rregullat në fushën e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(6) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës për autorizimin e trupit për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri i Ekonomisë.

Procedura për autorizimin e trupit për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve

Neni 181

(1) Nëse konstatohet se me kërkesën nga neni 180 paragrafi (1) i këtij ligji janë dorëzuar dëshmit nga neni 180 paragrafi (3) i këtij ligji, si dhe kushtet nga neni 178 i këtij ligji, ministri i Ekonomisë në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit dhe grumbullimit të dëshmimeve nga neni 180 paragrafi (3) i këtij ligji, merr vendim për autorizimin e trupit për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve.

(2) Nëse kërkesa nga neni 180 paragrafi (1) i këtij ligji nuk përmban dëshmitë nga neni 180 paragrafi (3) pikat 1), 3), 4), 5), 6) dhe 7). të këtij ligji, Ministria e Ekonomisë do të njoftojë parashtruesin, përkatësisht shoqatën, fondacionin, institucionin ose organizatën tjetër për plotësimin e kërkesës dhe/ose sqarimin plotësues e së njëjtës në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit për nevojën e plotësimit. Nëse parashtruesi i kërkesësi i mënjanon mangësitë brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se parashtrimi ka qenë mjaft i qartë që në fillim. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk përgjigjet brenda afatit të caktuar, kërkesa do të refuzohet në afat prej shtatë ditëve me aktvendim refuzues të miratuar nga ministri i Ekonomisë.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni përmban emrin dhe selinë e trupit të autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorit dhe të dhënat për dëshmitë nga neni 180 paragrafi (3) i këtij ligji.

(4) Aktvendimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni mund të lëshohen edhe në formë të dokumenteve elektronike të dorëzuara në profilin e shoqatës, fondacionit, institucionit ose organizatës tjetër të Portalit nacional për shërbime elektronike, në përputhje me rregullat nga fusha e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike dhe nga fusha e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(5) Kundër aktvendimit nga paragrafi (2) i këtij neni parashtruesi i kërkesës mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit te organi kompetent për vendimmarrje në shkallën e dytë.

(6) Ankesa nga paragrafi (5) i këtij neni nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

(7) Ankesa nga paragrafi (5) i këtij neni mund të parashtrohet edhe në formë elektronike me anë të mjeteve të identifikimit elektronik përmes Portalit nacional për shërbime elektronike ose përmes ndërmjetësuesit për shërbime administrative në mënyrë elektronike në Ministrinë e Ekonomisë në përputhje me rregullat nga fusha e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike dhe nga fusha e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(8) Me përjashtim nga paragrafët (4) dhe (7) të këtij neni dhe në rast të ndërprerjes teknike të funksionimit të Portalit nacional për shërbime elektronike, aktvendimet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni dhe ankesa nga paragrafi (5) i këtij neni mund të dorëzohet dhe parashtrohet në formë të dokumenteve elektronike përmes dërgimit të rekomanduar elektronik të kualifikuar në adresën elektronike në shoqatë, fondacion, institucion ose organizatë tjetër, gjegjësisht te organi kompetenti vendimmarrës në shkallë të dytë, në përputhje me rregullat në fushën e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

Kontrolli dhe Lista e trupave të autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve

Neni 182

(1) Ministria e Ekonomisë udhëheqë Listën e trupave të autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve.

(2) Në listën e truave të autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve nga paragrafi (1) i këtij neni, përfshihen trupat e autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve që janë të autorizuar në përputhje me nenin 181 të këtij ligji.

(3) Ministria e Ekonomisë, listën e trupave të autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve nga paragrafi (1) i këtij neni e publikon në ueb faqen e vet dhe e azhurnon rregullisht.

(4) Grupat e autorizuarra për mbrojtjen e interesave kolektive dhe të drejtave të konsumatorëve që janë të autorizuarra në përputhje me nenin 181 të këtij ligji janë të detyruara që dëshmitë nga neni 180 paragrafi (3) t'i dorëzojnë së paku një herë në vit në afat prej një viti nga dita e pranimit të aktvendimit për autorizim nga ky ligj në Ministrinë e Ekonomisë për kontroll të plotësimin të kushteve në përputhje me nenin 178 të këtij ligji.

(5) Nëse në përputhje me paragrafin (4) të këtij neni konstatohet se organi i autorizuar për mbrojtjen e interesave kolektive dhe të drejtave të konsumatorit ka pushuar t'i plotësojë kushtet nga neni 178 i këtij ligji në përputhje me dëshmitë e parashtruara nga neni 180 paragrafi (3) i këtij ligji, ministri i Ekonomisë në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të dëshmimeve në përputhje me afatin e përcaktuar në paragrafin (4) të këtij neni me aktvendim do ta marrë autorizimin e dhënë me aktvendim për autorizimin e trupit për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve nga neni 181 paragrafi (1) i këtij ligji.

(6) Aktvendimi nga paragrafi (5) i këtij neni mund të lëshohet në formë të dokumentit elektronik i cili dorëzohet në profilin e shoqatës, fondacionit, institucionit ose organizatës tjetër në Portalin nacional për shërbime elektronike, në përputhje me rregullat nga fushën e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike dhe nga fusha e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(7) Kundër aktvendimit nga paragrafi (5) i këtij neni, shoqata, fondacioni, institucioni ose organizata tjetër të cilës i është hequr autorizimi për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve mund të parashtrorë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit tek organi kompetent vendimmarrës në shkallë të dytë.

(8) Ankesa nga paragrafi (7) i këtij neni nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

(9) Ankesa nga paragrafi (7) i këtij neni mund të parashtroet edhe në formë elektronike me anë të mjetit elektronik të identifikimit përmes portalit nacional për shërbime elektronike ose përmes ndërmjetësit për shërbime administrative në mënyrë elektronike në Ministrinë e Ekonomisë, në përputhje me rregullat nga fusha e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike dhe nga fusha e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(10) Me përjashtim të paragrafëve (6) dhe (9) të këtij neni, dhe në rast të ndërprerjes teknike të funksionimit të Portalit nacional për shërbime elektronike, aktvendimi nga paragrafi (5) i këtij neni dhe ankesa nga paragrafi (7) i këtij neni mund të parashtrohet dhe të dorëzohet në formë të dokumenteve elektronike përmes postës elektronike të rekomanduar në adresë elektronike në shoqatë, fondacion, institucion ose organizatë tjetër, përkatësisht organin kompetent vendimmarrës në shkallën e dytë, në përputhje me rregullat nga fusha e dokumenteve elektronike, identifikimi elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

Lista e përbashkët e trupave të autorizuarra për mbrojtjen e interesave kolektive dhe të drejtave të konsumatorëve të Bashkimit European

Neni 183

Ministria e Ekonomisë është e detyruar t'i dorëzojë Komisionit European listën e azhurnuar të trupave të autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, me qëllim përfshirjen e saj në Listën e përbashkët të trupave të autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve të Bashkimit European.

Detyrimi për dhënie e raporteve të trupave të autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve

Neni 184

(1) Trupat e autorizuarra për mbrojtjen e interesave kolektive dhe të drejtave të konsumatorëve të regjistruara në listën e trupave të autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve nga neni 182 i këtij ligji janë të detyruar të dorëzojnë në Ministrinë e Ekonomisë raport vjetor të punës, si dhe raport vjetor financiar, jo më vonë se tre muaj nga përfundimi i vitit përkatës kalendarik.

(2) Trupat e autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve e kanë obligim nga paragrafi (1) i këtij neni vetëm nëse në vitin kalendarik të cilit i referohen raportit vjetor dhe raportit financiar vjetor kanë ushtruar aktivitete të financuara me mjete buxhetore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Lidhja e shoqatave për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve

Neni 185

(1) Së paku tri shoqata për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve mund të bashkohen në shoqata për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, me qëllim të avancimit të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve dhe për realizimin e përbashkët të aktiviteteve të tyre.

(2) Lidhja e Shoqatave për Mbrojtjen e të Drejtave të Konsumatorëve ushtron punët e njëjta si edhe shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve në përputhje me nenin 177 të këtij ligji.

Pjesa 2

DHOMAT EKONOMIKE

Dispozita të përgjithshme

Neni 186

(1) Dhomat ekonomike si formë e bashkimit të tregtarëve dhe si bartëse të kodit të mirësjelljes zbatojnë aktivitete për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, me ç'rast bashkëpunojnë me shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve dhe me trupat e autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, e me qëllim të avancimit të realizimit të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve.

(2) Dhomat ekonomike në kuadër të kompetencave të tyre të përcaktuara me ligj dhe statutit, zbatojnë veprime për informimin dhe edukimin e tregtarëve për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, në përputhje me këtë ligj dhe me rregullat e veçanta.

Kodet e sjelljes

Neni 187

(1) Ministria e Ekonomisë, Dhomat Ekonomike dhe shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve janë të detyruara që t'i inkurajojnë bartësit e kodeve të mirësjelljes që të mbikëqyrin dhe ndjekin zbatimin, respektimin dhe/ose shkeljen e kodeve përkatëse të sjelljes që ata i kanë nënshkruar mes vete dhe janë qasur drejt tyre, me atë që kontrolli i zbatimit të Kodit të sjelljes është të rregullojë në mënyrë plotësuese mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit, e veçanërisht në aspektin e praktikave të padrejta tregtare, kontratat e shitjes dhe kontratat e shërbimeve, kontratat në distancë dhe kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit, kontratën

për përdorimin me afat të paluajtshmërisë, kontratat e produkteve afatgjata për pushim, kontratat e rishitjes ose kontratat e shkëmbimit, si dhe kontratat e furnizimit me përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale, duke përfshirë edhe mundësinë për kthimin ose ngritjen e procedurës ose kërkesës përkatëse për mbrojtje juridike nga trupat e autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

(2) Ministria e Ekonomisë, dhomat ekonomike dhe shoqatat për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve janë të detyruara që t'i nxisin tregtarët dhe bartësit e kodeve të sjelljes që t'i informojnë konsumatorët për ekzistimin dhe përmbajtjen e tyre.

Kapitulli 3

PROCEDURA PËR REALIZIMIN E MBROJTJES SË TË DREJTAVE TË KONSUMATORIT

Dispozitat e përbashkëta për procedurën e realizimit të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorit

Neni 188

Konsumatori mund të realizojë mbrojtjen e të drejtave të tij nëpërmjet:

- 1) kundërshtimit konsumator tek tregtarët;
- 2) ngritjes së kontestit konsumator në procedurë gjyqësore dhe
- 3) zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontestit konsumator.

Pjesa 1

KUNDËRSHTIMI KONSUMATOR PARA TREGTARËVE

Kundërshtimi konsumator

Neni 189

(1) Tregtari, përkatësisht tregtari i cili ofron shërbim publik, është i detyruar t'i mundësojë konsumatorit parashtrimin e ankesës konsumatore në rastet e shkeljes së të drejtave të konsumatorit që i njëjti i ka në bazë të këtij ligji ose kontratës.

(2) Tregtari, respektivisht tregtari i cili ofron shërbime publike është i detyruar të veprojë sipas kundërshtimit konsumator, në përputhje me këtë ligj, pa marrë parasysh nëse kundërshtimi konsumator është emërtuar si i tillë.

Detyrimi për njoftim

Neni 190

(1) Tregtari, gjegjësisht tregtari që ofron shërbimin publik, është i detyruar në hapësirat e tij afariste dhe kur kjo është e mundur, në faqen e tij të internetit, në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme, të theksojë se konsumatori është i autorizuar të parashtrijë kundërshtim konsumator, si dhe t'i theksojë mënyrat në dispozicion për parashtrimin e kundërshtimit konsumator.

(2) Kur tregtari, përkatësisht tregtari i cili ofron shërbime publike, është pajtuar që të jetë i detyruar me kodin e sjelljes, detyrimin nga paragrafi (1) i këtij neni e ka edhe bartësi përkatës i kodit të sjelljes.

(3) Tregtari i cili ofron shërbime publike, përveç detyrimit nga paragrafi (1) i këtij neni, është i detyruar që në llogarinë e dorëzuar në mënyrë të qartë, të dukshme dhe të lexueshme të theksojë se konsumatori është i autorizuar të parashtrijë kundërshtim konsumator për shërbime publike, si dhe të theksojë mënyrat në dispozicion për parashtrimin e kundërshtimit konsumator për shërbimet publike në përputhje me këtë ligj.

Mënyrat e parashtrimit të kundërshtimit konsumator

Neni 191

(1) Tregtari është i detyruar që t'i mundësojë konsumatorit të parashtojë kundërshtimin e tij konsumator gojarisht ose në letër, në hapësirat afariste të tregtarit, me ç'rast është i detyruar që të sigurojë praninë e personit i cili është i autorizuar për pranimin e kundërshtimeve konsumatore gjatë tërë orarit të punës ose të parashtojë kundërshtim konsumator përmes postës, faksit ose postës elektronike.

(2) Tregtari që ofron shërbime publike është i detyruar që t'i mundësojë konsumatorit të parashtojë kundërshtimin e tij konsumator për shërbime publike edhe përmes linjës telefonike sipas tarifës themelore të thirrjes që, në përputhje me këtë ligj, tregtarët që ofrojnë shërbime publike janë të detyruar t'ua sigurojnë konsumatorëve.

(3) Krahas mundësive të përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, tregtari përmes faqes së tij të internetit mund t'i vendosë në dispozicion të konsumatorit edhe opsionin e plotësimit elektronik dhe parashtrimit të ankesës konsumatore.

(4) Në rastin nga paragrafi (1) i këtij neni, kur është dorëzuar kundërshtim konsumator gojarisht ose në letër në hapësirat afariste të tregtarit, ai është i detyruar t'i lëshojë, në letër, vërtetim për pranimin e kundërshtimit konsumator pa prolongim, gjatë parashtrimit të tij.

(5) Në rastin nga paragrafi (3) i këtij neni, tregtari është i detyruar t'i dorëzojë konsumatorit vërtetim për pranimin e kundërshtimit konsumator në bartës të përhershëm.

(6) Është e ndaluar që tregtari të bëjë arkëtim për parashtrimin dhe veprimin ndaj kundërshtimit konsumator.

Detyrimi për përgjigje ndaj kundërshtimit konsumator

Neni 192

(1) Tregtari është i detyruar, më së voni në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të kundërshtimit, t'i përgjigjet konsumatorit ndaj kundërshtimit të tij konsumator.

(2) Në përgjigjen ndaj kundërshtimit konsumator, tregtari është i detyruar të tregojë:

- 1) nëse e respekton kundërshtimin konsumator;
- 2) arsyetim të shkurtër të vendimit të tij ndaj kundërshtimit konsumator dhe
- 3) aty ku është e zbatueshme, propozim konkret për një afat për zgjidhjen e kundërshtimit konsumator.

(3) Dispozitat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk zbatohen në rastet kur konsumatori dhe tregtari e kanë zgjidhur kundërshtimin e drejtpërdrejtë të parashtruar konsumator.

Veprim ndaj kundërshtimit konsumator

Neni 193

(1) Kur tregtari i bën propozim konkret konsumatorit për zgjidhjen e kundërshtimit konsumator, ai është i detyruar që për këtë të parashikojë afat që nuk mund të jetë më i gjatë se një muaj nga pranimi kundërshtimit konsumator.

(2) Tregtari është i detyruar të veprojë në përputhje me propozimin për zgjidhjen e kundërshtimit konsumator në përputhje me paragrafin (1) të këtij neni, nëse konsumatori është pajtuar për këtë paraprakisht.

(3) Nëse tregtari për shkaqe objektive nuk është në gjendje t'i plotësojë kërkesat e konsumatorit në afatin nga paragrafi (1) i këtij neni, është i detyruar që për këtë ta njoftojë konsumatorin dhe të caktojë afat plotësues që nuk mund të jetë më i gjatë se tetë ditë nga skadimi i afatit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Përcaktimin e afatit plotësues nga paragrafi (3) i këtij neni tregtari është i detyruar që ta evidentojë në evidencën e kundërshtimeve konsumatore nga neni 195 i këtij ligji.

(5) Përcaktimin e afatit shtesë nga paragrafi (3) i këtij neni, tregtari mund ta bëjë vetëm një herë.

(6) Tregtari është i detyruar të veprojë në përputhje me propozimin për zgjidhjen e kundërshtimit konsumator, në përputhje me paragrafin (3) të këtij neni, nëse konsumatori është pajtuar për këtë paraprakisht.

Fakultativiteti i kundërshtimit konsumator

Neni 194

Parashtrimi i kundërshtimit konsumator dhe veprimi ndaj kundërshtimit konsumator nuk mund të konsiderohet si heqje dorë nga masat dhe mjetet që i ka në dispozicion konsumatori për të përmbushur të drejtat e tij ose si parakusht apo supozim i tyre.

Evidenca e kundërshtimeve konsumatore

Neni 195

(1) Tregtari për kundërshtimet konsumatore mban evidencë të kundërshtimeve konsumatore dhe të njëjtën e azhurnon rregullisht.

(2) Me kërkesë të organeve të mbikëqyrjes së tregut, tregtari është i detyruar të dorëzojë certifikatë nga evidenca e kundërshtimeve konsumatore nga paragrafi (1) i këtij neni.

Dispozita të veçanta për kundërshtimet konsumatore për shërbimet publike

Neni 196

(1) Tregtarët që ofrojnë shërbime publike në përbërjen e tyre duhet të formojnë njësi për kundërshtime konsumatore për shërbime publike.

(2) Tregtarët që ofrojnë shërbime publike janë të detyruar, të dhënat për ekzistimin dhe punën e njësisë për kundërshtime konsumatore për shërbime publike paragrafi (1) i këtij neni t'i publikojnë në ueb-faqet e tyre së paku një herë në gjasht muaj.

Dispozita të tjera të veçanta për kundërshtimin konsumator

Neni 197

(1) Është e ndaluar që tregtari me rregullat e tij të brendshme, kushtet e përgjithshme ose në çfarëdo mënyre tjetër të parashikojë kërkesa plotësuese për parashtrimin e dhe/ose veprimin ndaj kundërshtimeve konsumatore, përveç nëse shprehimisht me këtë ligj është parashikuar ndryshe.

(2) Është e ndaluar që tregtari, në mënyrë të pavarur ose me anë të subjekteve të tjera, të shpallë, deklarojë ose në ndonjë mënyrë tjetër të njoftojë se u mundëson konsumatorëve të parashtrajnë dhe/ose të veprojnë ndaj kundërshtimeve konsumatore sipas dispozitave që janë të ndryshme nga dispozitat e përcaktuara me këtë ligj.

(3) Është e ndaluar çfarëdo subjekt i tretë që nuk është palë e marrëdhënies konsumatore të shpallë, deklarojë ose në ndonjë mënyrë tjetër të njoftojë se u mundëson konsumatorëve të ndërmjetësojnë në parashtrimin dhe/ose veprimin ndaj kundërshtimeve konsumatore, përveç nëse shprehimisht nuk është parashikuar ndryshe me këtë ligj.

Pjesa 2
KONTESTI KONSUMATOR NË PROCEDURËN KONTESTIMORE

Kontesti konsumator

Neni 198

- (1) Kontest konsumator është çdo kontest që shkaktohet në marrëdhëniet konsumatore.
(2) Tregtarët janë të detyruar të përpiqen ta zgjidhin kontestin konsumator me kontrata me konsumatorët, në mënyrë paqësore ose në ndonjë nga mënyrat për zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontesteve konsumatore.

Juridiksioni për kontestet konsumatore

Neni 199

Për zgjidhjen e kontesteve konsumatore janë kompetente gjykatat me juridiksion real.

Pjesa 3
ZGJIDHJA JASHTËGJYQËSORE E KONTESTIT KONSUMATOR

Vëllimi i zbatimit

Neni 200

Zgjidhja jashtëgjyqësore e kontesteve konsumatore nënkupton zgjidhjen e kontestit konsumator në bazë të kundërshtimeve të parashtruara konsumatore, ose kërkesë të parashtruar të konsumatorit ose të trupave të autorizuara për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, para mbajtësit të kodit, përmes ndërmjetësimit, arbitrazhit dhe mënyrave të tjera të zgjidhjes jashtëgjyqësore të kontesteve konsumatore në përputhje me rregullat e veçanta.

Kapitulli 4
MBROJTJA E INTERESAVE KOLEKTIVE DHE E TË DREJTAVE KONSUMATORE

Vëllimi i zbatimit

Neni 201

(1) Dispozitat e këtij neni dhe neneve 202, 203, 204, 205, 206, 207 dhe 208 të këtij ligji zbatohen në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji ose të rregullave të tjera, e lidhur me urdhrat me të cilat tregtarëve u shqiptohen ndalime në konteste konsumatore, si kërkesa të përshtatshme për mbrojtjen juridike në rast të shkeljes së interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve.

(2) Si shkelje e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, në kuptim të këtij ligji, nënkuptohet çdo veprim që bie ndesh me të drejtat e konsumatorëve që rezultojnë nga:

1) dispozitat e këtij ligji për kontratat në distancë dhe për kontratat e lidhura jashtë hapësirave afariste të tregtarit;

2) dispozitat e këtij ligji për përputhshmërinë e mallrave dhe për garantim tregtar për mallrat;

3) dispozitat e këtij ligji për dispozitat e padrejta kontraktual;

4) dispozitat e këtij ligji për praktikata e padrejta tregtare;

5) dispozitat e këtij ligji për kontratat për përdorimin e ndarë në aspektin kohor të paluajtshmërisë, për produktin afatgjatë për pushim, për rishitje dhe për shkëmbim;

6) dispozitat e këtij ligji për kontratat për furnizim me përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale;

7) dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së Konsumatorëve në kontratat për kredi konsumatore, nga rregullat e miratuara në bazë të tij dhe nga rregullat për kredi konsumatore hipotekare;

8) dispozitat e Ligjit të Shërbimeve Audio dhe Audiovizuele Mediatike;

9) dispozitat për e paket-aranzhimet turistike dhe aranzhimet e ndërlidhura për udhëtim nga Ligjit të Turizmit dhe Ligji i Marrëdhënieve Detyrimore;

10) dispozitat e Ligjit të Tregtisë Elektronike;

11) dispozitat e Ligjit të Barnave dhe të Pajisjeve Mjekësore;

12) dispozitat e Ligjit të Ofrimit të Shërbimeve Financiare në Largësi;

13) dispozitat e Ligjit të Shërbimeve;

14) rregullat për zgjidhjen jashtëgjyqësore të kontesteve konsumatore;

15) rregullat për zgjidhjen e kontesteve konsumatore në mënyrë elektronike (onlajn);

16) rregullat për kontratat për transport të udhëtarëve dhe/ose bagazhit;

17) dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së të Drejtave të Pacientëve;

18) dispozitat e Ligjit Kundër Konkurrencës së Pandershme, me përjashtim të reklamimit mashtruese dhe

19) dispozitat e rregullave të tjera me të cilat janë rregulluar të drejta të veçanta të konsumatorëve.

(3) Dispozitat e këtij neni dhe nenet 202, 203, 204, 205, 206, 207 dhe 208 të këtij ligji nuk e përjashtojnë të drejtën e konsumatorëve që të iniciojnë procedurë para gjykatës kompetente për realizimin e të drejtave për kompensimin e dëmit, për pavlefshmërinë e kontratës ose dispozitë të padrejta kontraktual, si dhe parashtrimin e kërkesës për mbrojtjen e të drejtave të tyre në marrëdhëniet konsumatore.

(4) Dispozitat e këtij neni dhe nenet 202, 203, 204, 205, 206, 207 dhe 208 të këtij ligji nuk e përjashtojnë të drejtën e konsumatorit që të parashtrorë kërkesë përkatëse për mbrojtje juridike, në kuptim të kërkesës për shqiptimin e ndalimit përkatës për tregtarin, e në rast të shkeljes së të drejtave dhe interesave individuale të tij, me përjashtim të rasteve kur tashmë është duke u zhvilluar procedurë me rastin e kërkesës përkatëse për mbrojtje juridike, në kuptimin e kërkesës për shqiptimin e ndalimit përkatës për tregtarin.

(5) Dispozitat e këtij neni dhe nenet 202, 203, 204, 205, 206, 207 dhe 208 të këtij ligji nuk e përjashtojnë zbatimin e rregullave ndërnacionale që kanë të bëjnë me përcaktimin e së drejtës në fuqi që, sipas rregullës, zbatohet ose të drejtën e shtetit ku ka ndodhur shkelja ose të drejtën e shtetit në të cilin kanë ndodhur pasojat e shkeljes.

Veprimi i trupave të autorizuara për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve

Neni 202

Nëse ka shkelje të interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, inicimin e procedurës para gjykatës kompetente ose organeve të mbikëqyrjes së tregut e kryen trupi i autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve në përputhje me rregulloret e veçanta.

Shkeljet ndërkufitare

Neni 203

(1) Kur shkelja ka ndodhur në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, çdo trup i autorizuar për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve nga një shtet tjetër anëtar i Bashkimit Europian mund të iniciojë procedurë para gjykatës kompetente ose organeve të mbikëqyrjes së tregut në Republika e Maqedonisë së Veriut, nëse shkelja ka të bëjë me interesat dhe të drejtat kolektive të konsumatorëve që ai trup është i autorizuar t'i mbrojë.

(2) Trupat e përmendura në Listën e përbashkët të trupave të autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve të Bashkimit Europian, në përputhje me nenin 183 të këtij ligji, autorizohen për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni.

Kërkesa për mbrojtje juridike në rast të shkeljes së interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve

Neni 204

(1) Trupat e autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, në procedurë para gjykatës kompetente ose para organeve të mbikëqyrjes së tregut, përveç kërkesave të përcaktuara me rregullore të veçanta, mund të parashtrojnë edhe kërkesa vijuese:

- 1) për ndalimin ose ndërprerjen e menjëhershme, në procedurë urgjente, të çfarëdo shkeljeje;
 - 2) për shpallje në mënyrën dhe formën përkatëse të vendimit, tërësisht ose pjesërisht, si dhe kërkesën për reklamimin e korrigjimit dhe/ose kërkim faljeje publike, e me qëllim të mënjanimin të pasojave të mëtejshme nga shkelja; dhe
 - 3) për pagesën e gjobave gjyqësore për shkak të mosrespektimit eventual të vendimit.
- (2) Kërkesat nga paragrafi (1) i këtij neni mund të vendosen në raport me tregtar të caktuar, në raport me disa tregtarë nga veprimtaria e njëjtë afariste, si dhe në raport me bartësin e kodit të sjelljes.
- (3) Kërkesat nga paragrafi (1) i këtij neni mund të vendosen vetëm si kërkesa kryesore, në mënyrë të pavarur ose pranë kërkesave të tjera në dispozicion.
- (4) Procedura me rastin e kërkesave përkatëse nga paragrafi (1) i këtij neni është urgjente.

Procedura të veçanta për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve në lidhje me praktikën e padrejta tregtare

Neni 205

(1) Trupat e autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, në lidhje me praktikën e padrejta tregtare, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, mund të iniciojnë procedurë para gjykatës kompetente ose organeve të mbikëqyrjes së tregut dhe me kërkesë për:

- 1) ndalimi i praktikës tashmë ekzistuese, përkatësisht të përdorur të padrejta tregtare;
 - 2) ndalimi i praktikës së padrejta tregtare që ende nuk është përdorur, por përdorimi i të cilës është i pashmangshëm dhe
 - 3) publikimin në mënyrë dhe formë përkatëse të vendimit që ndalon praktikën e padrejta tregtare, tërësisht ose pjesërisht, si dhe kërkesën për publikimin e korrigjimit dhe/ose faljes publike.
- (2) Gjatë vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesave përkatëse nga paragrafi (1) i këtij neni, merren parasysh interesat e të gjitha subjekteve të interesuara, si dhe interesi publik.
- (3) Gjatë vlerësimit të bazueshmërisë së kërkesave përkatëse nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk është i nevojshme përcaktimi i ekzistimit të dëmit të shkaktuar ose ekzistenca e fajit, në formë të qëllimi ose pakujdesisë, nga tregtari.
- (4) Disponueshmëria e kërkesave përkatëse nga paragrafi (1) i këtij neni për ekzistimin, përkatësisht përdorimin e praktikës së padrejta tregtare nuk mund të kushtëzohet me vendbanimin ose vendqëndrimin e konsumatorit, gjegjësisht nëse vendbanimi apo vendqëndrimi i konsumatorit. ndodhet në shtetin e selisë së tregtarit ose jo.

Procedura të veçanta për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve në lidhje me dispozitat e padrejta kontraktuale

Neni 206

(1) Organet e autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, në raport me dispozitat e padrejta kontraktuale në përputhje me dispozitat e këtij ligji, mund të iniciojnë procedurë para gjykatës kompetente ose organeve të mbikëqyrjes së tregut edhe me kërkesë për:

1) përcaktim se një dispozitë e caktuar kontraktual e përdorur në marrëdhëniet konsumatore është e padrejta dhe

2) ndalim të përdorimit të dispozitës së padrejtë kontraktuale.

(2) Dispozita nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet me rastin e përcaktimit të pandershmërisë dhe ndalimit të përdorimit të dispozitave të padrejta kontraktual të përfshira në kontratën formulare ose tipike (standarde) ose në kushtet e përgjithshme të kontratës.

(3) Kërkesat për përcaktimin e pandershmërisë dhe për ndalimin e përdorimit të dispozitave të padrejta kontraktuale mund të vendosen edhe në raport me dhomat ekonomike që udhëzojnë ose u rekomandojnë anëtarëve të tyre përdorimin e kontratave formulare ose tipike (standarde) ose kushteve të përgjithshme të kontratës.

(4) Me dispozitat e këtij ligji nuk përjashtohet mundësia trupat të autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve edhe të iniciojnë procedurë përkatëse para organeve përgjegjëse mbikëqyrëse të bartësit të kodit të sjelljes për zbatimin, respektimin dhe/ose shkëljen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve, për këto qëllime.

Procedurat e veçanta për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve në lidhje me furnizimin me përmbajtje digjitale ose shërbim digjital

Neni 207

Trupat e autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve mund të iniciojnë procedurë para gjykatës kompetente ose organeve të mbikëqyrjes së tregut me kërkesë për realizimin e të drejtave të konsumatorëve që rezultojnë nga dispozitat e neneve 149, 150, 160, 161, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168 dhe 169 të këtij ligji.

Procedurat ose veprimet paraprake

Neni 208

(1) Çfarëdo veprime ose procedura paraprake, duke përfshirë ato të mediacionit, ndërmjetësimit, konsultimit, negocimit, harmonizimit, adresimit të organeve përgjegjëse mbikëqyrëse të bartësve të kodit të sjelljes etj., nuk mund të konsiderohen si parakusht ose supozim për nisjen e procedurës për kërkesat përkatëse për shqiptimin e ndalimeve përkatëse për tregtarin.

(2) Çdo kontrata në kundërshtim me dispozitat e paragrafit (1) të këtij neni është e pavlefshme.

Pjesa e pestë MBIKËQYRJA

Kapitulli 1 KOMPETENCA PËR MBIKËQYRJE

Dispozita të përgjithshme

Neni 209

(1) Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe të rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji e bën Ministria e Ekonomisë.

(2) Mbikëqyrjen mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji që kanë të bëjnë me veprimet e subjekteve të mbikëqyrjes gjatë përpunimit të të dhënave personale dhe dispozitave për tregin e të dhënave personale e bën Agjencia për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me autorizimet nga rregullat e veçanta me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.

(3) Mbikëqyrjen inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe rregullave të miratuara në bazë të këtij ligji e bën Ministria e Ekonomisë - Inspektorati Shtetëror i Tregut (në tekstin e mëtejshëm: Inspektorati Shtetëror i Tregut).

(4) Mbikëqyrja inspektuese nga Inspektorati Shtetëror i Tregut dhe mbikëqyrjen e tregut nga organet e mbikëqyrjes së tregut mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji bëhen në përputhje me Ligjin e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe ligjet e veçanta.

(5) Inspektori ka të drejtë që gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese të kërkojë të dhëna nga organi shtetëror ose personi juridik që mban regjistër dhe ata janë të detyruar të bashkëpunojnë me inspektorin; të kërkojë praninë e personit të autorizuar zyrtar nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët e brendshme, i cili është i detyruar të marrë pjesë në zbatimin e mbikëqyrjes inspektuese, si dhe të kërkojë praninë e personit zyrtar nga organi profesional, njësia përkatëse organizative e komunës, komunës së Qytetit e Shkupit, përkatësisht qytetit të Shkupit, institucioneve tjera profesionale dhe personave juridikë, nëse për vërtetimin e fakteve apo rrethanave të rëndësishme nevojitet mendim i tillë profesional.

Kapitulli 2 MBIKËQYRJA INSPEKTUESE

Autorizimet e inspektorëve

Neni 210

(1) Në ushtrimin e mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët kanë të drejtat, detyrimet dhe autorizimet e parashikuara me këtë ligj dhe me kompetencat e veçante ku janë përcaktuar kompetencat e tyre.

(2) Gjatë ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët kontrollojnë nëse tregtari:

1) respekton detyrimet e përgjithshme në marrëdhëniet konsumatore në përputhje me dispozitat e nenit 6 paragrafi (2), nenit 7, nenit 8 paragrafët (4), (5) dhe (7) dhe nenet 9 dhe 10 të këtij ligji;

2) shënon çmimet në përputhje me dispozitat e neneve 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17 të këtij ligji;

3) respekton detyrimet në rast të nxitjeve të shitjes në përputhje me dispozitat e neneve 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28 të këtij ligji;

4) respekton detyrimet gjatë ofertave të përbashkëta të mallrave ose shërbimeve në përputhje me dispozitat e neneve 29 dhe 30 të këtij ligji;

5) respekton obligime për pagesë në përputhje me dispozitat e neneve 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36 të këtij ligji;

6) respekton detyrimet me rastin e dorëzimit të dokumenteve dhe obligime tjera të ndërlidhura në përputhje me dispozitat e neneve 37, 38 dhe 39 të këtij ligji;

7) respekton obligime lidhur me përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga produkti me defekt në përputhje me dispozitat e neneve 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47 dhe 48 të këtij ligji;

8) respekton detyrimet e përgjithshme lidhur me informimin e konsumatorëve për shërbimet në përputhje me dispozitat e nenit 50 të këtij ligji;

9) respekton detyrimet gjatë ofrimit të shërbimeve publike në përputhje me dispozitat e neneve 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64 dhe 66 të këtij ligji;

10) respekton detyrimet lidhur me praktikat e padrejta tregtare në përputhje me dispozitat e neneve 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77 dhe 78 të këtij ligji;

11) përdor dispozita të padrejta kontraktual në përputhje me dispozitat e neneve 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86 të këtij ligji;

12) respekton detyrimet e përgjithshme lidhur me kontratën e shitjes dhe kontratën për shërbime në përputhje me dispozitat e neneve 87, 88, 89, 90, 91, 92 dhe 93 të këtij ligji;

13) respekton detyrimet në lidhje me kontratat e shitjes në përputhje me dispozitat e neneve 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 109, 108, 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117 dhe 118 të këtij ligji;

14) respekton detyrimet në lidhje me kontratat në distancë dhe kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit në përputhje me dispozitat e neneve 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 132 dhe 133 të këtij ligji;

15) respekton obligime në lidhje me kontratat për përdorimin në pjesë në aspektin kohor të paluajtshmërive, për produktet afatgjata për pushim, për rishitje dhe për shkëmbim sipas dispozitave të neneve 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147 dhe 148 të këtij ligji;

16) respekton detyrimet në lidhje me kontratat për furnizim me përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale në përputhje me dispozitat e neneve 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 162, 163, 164, 165, 166, 167, 168 dhe 169 të këtij ligji

17) respekton detyrimet lidhur me kundërshtimet konsumatore në përputhje me dispozitat e neneve 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 196 dhe 197 të këtij ligji.

Paralajmërim dhe aktvendim

Neni 211

(1) Nëse gjatë ushtrimit të mbikëqyrje inspektuese inspektori te subjekti i mbikëqyrjes inspektuese konstaton parregullsi dhe mangësi në përputhje me nenin 210 paragrafi (2) pikat 1), 2), 3), 4) dhe 6) të këtij ligji, për gjendjen e përcaktuar faktike, parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara dhe përcaktuara, vërejtjet, deklaratat dhe faktet dhe rrethanat tjera relevante, inspektori përpilon procesverbal me shkrim në vendin e ushtrimit të mbikëqyrjes inspektuese dhe me aktvendim shqipton paralajmërim.

(2) Kopja e procesverbalit nga paragrafi (1) i këtij neni i dorëzohet për nënshkrim subjektit të mbikëqyrjes inspektuese mbi të cilin është ushtruar mbikëqyrja inspektuese. Në rast se në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të procesverbalit, subjekti i mbikëqyrjes inspektuese nuk jep deklaratë lidhur me procesverbalin e dorëzuar ose nuk e kthen të nënshkruar, konsiderohet se është dakord me përmbajtjen e tij.

(3) Me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, inspektori përcakton afatin në të cilin subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i detyruar t'i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara, me ç'rast ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 24 orë, as më i gjatë se 30 ditë.

(4) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, në rast se inspektori vlerëson se parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara mund të shkaktojnë ose shkaktojnë rrezik të menjëhershëm për jetën dhe shëndetin e njeriut ose dëm financiar ose dëmtim të pasurisë me vlerë më të madhe ose rrezikim të mjedisit jetësor ose rrezikim të interesit publik, me aktvendim shqipton masë tjetër inspektuese, si huamarrje, urdhër, ndalim dhe masë tjetër, nëse është përcaktuar me ligj të posaçëm, me të cilën më së miri do të arrihet qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese.

(5) Nëse subjekti i mbikëqyrjes inspektuese nuk vepron sipas paralajmërimit në aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, në afatin nga paragrafi (3) i këtij neni, inspektori do të shqiptojë masë tjetër inspektuese, siç është huazimi, urdhërimi, ndalimi dhe masat tjera, nëse është përcaktuar me ligj të veçantë, me të cilin më së miri do të arrihet qëllimi i mbikëqyrjes inspektuese.

(6) Me aktvendimin nga paragrafi (5) i këtij neni, inspektori përcakton afat në të cilin subjekti i mbikëqyrjes inspektuese është i detyruar t'i mënjanojë parregullsitë dhe mangësitë e konstatuara, me ç'rast ky afat nuk mund të jetë më i shkurtër se 24 orë, as më i gjatë se tetë ditë.

(7) Për parregullsitë e konstatuara nga neni 210 paragrafi (2) pikat 5), 7), 8), 9), 10), 11), 12), 13), 14), 15) dhe 16) të këtij ligji, inspektori me aktvendim do të urdhërojë subjektin e mbikëqyrjes inspektuese të bëjë kthimin e shumave të paguara.

(8) Aktvendimet nga paragrafët (1), (4), (5) dhe (7) të këtij neni mund të lëshohen edhe në formë të dokumenteve elektronike që dorëzohen në profilin e subjektit të mbikëqyrjes inspektuese në Portalin nacional të shërbimeve elektronike, në përputhje me rregullat nga fushën e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike dhe nga fusha e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(9) Kundër aktvendimeve nga paragrafët (1), (4), (5) dhe (7) të këtij neni, subjekti i mbikëqyrjes inspektuese mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit deri te organi kompetent vendimarrës në shkallën e dytë.

(10) Ankesa nga paragrafi (9) i këtij neni nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

(11) Ankesa nga paragrafi (9) i këtij neni mund të parashtrohet edhe në formë elektronike me anë të mjetit elektronik të identifikimit përmes portalit nacional për shërbime elektronike ose përmes ndërmjetësit për shërbime administrative në mënyrë elektronike në Ministrinë e Ekonomisë, në përputhje me rregullat nga fusha e menaxhimit elektronik dhe shërbimeve elektronike dhe nga fusha e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(12) Me përjashtim të paragrafëve (8) dhe (11) të këtij neni, dhe në rast të ndërprerjes teknike të funksionimit të Portalit nacional për shërbime elektronike, aktvendimet nga paragrafët (1), (4), (5) dhe (7) të këtij neni dhe ankesa nga paragrafi (9) i këtij neni mund të dorëzohet dhe parashtrohet në formë të dokumenteve elektronike përmes dërgesës së rekomanduar të kualifikuar elektronike në adresën elektronike të subjektit të mbikëqyrjes inspektuese, në përputhje me rregullat nga fusha e dokumenteve elektronike, identifikimit elektronik dhe shërbimeve konfidenciale.

(13) Inspektorati Shtetëror i Tregut mban evidencë për paralajmërimet e shqiptuara nga paragrafi (1) i këtij neni.

(14) Formën dhe përmbajtjen e evidencës për paralajmërimet e shqiptuara nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri i Ekonomisë.

Detyrimi për njoftim

Neni 212

(1) Inspektorati Shtetëror i Tregut është i detyruar të përpilojë raporte gjashtëmujore për punën e tij dhe t'i publikojë në ueb faqen e tij.

(2) Inspektorati Shtetëror i Tregut është i detyruar që raportet gjashtëmujore nga paragrafi (1) i këtij neni t'ia dorëzojë rregullisht Këshillit për mbrojtjen e konsumatorëve.

Kapitulli 3

DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE

Kompetenca

Neni 213

(1) Për kundërvajtjet e parashikuara nga neni 215 paragrafi (1) i këtij ligji, e në lidhje me nenin 215 paragrafët (3), (4), (5), (7), (8) dhe (9) të këtij ligji, procedurën për kundërvajtje udhëheqë dhe sanksione kundërvajtëse shqipton gjykata kompetente, në përputhje me Ligjin e Kundërvajtjes.

(2) Për kundërvajtjet nga neni 215 paragrafi (1) i këtij ligji, e në lidhje me nenin 215 paragrafët (2), (6) dhe (10) të këtij ligji, procedurë kundërvajtëse dhe sanksione kundërvajtëse shqipton Ministria e Ekonomisë nëpërmjet Komisionit të Vendimmarrjes ndaj Kundërvajtjes.

Kriteret e shqiptimit të gjobës për shkeljen e detyrimeve për mënyrën e shënimit të çmimeve, për përdorimin e praktikave të padrejta tregtare, për përdorimin e dispozitave të padrejta kontraktuale dhe për shkeljen e detyrimeve në kontratat në distancë dhe kontratat e lidhura jashtë hapësirave afariste të tregtarit

Neni 214

Gjatë shqiptimit të gjobës për shkelje të detyrimeve për mënyrën e shënimit të çmimeve nga neni 21 i këtij ligji, për përdorimin e praktikave të padrejta tregtare në kundërshtim me dispozitat e neneve 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77 dhe 78 të këtij ligji, për përdorimin e dispozitave të padrejta kontraktuale në kundërshtim me dispozitat e neneve 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86 të këtij ligji, si dhe për shkelje të detyrimeve në kontratat në distancë dhe kontratat e lidhura jashtë hapësirave afariste të tregtarit të referuara në nenet 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 130, 131, 132 të këtij ligji, organi kompetent nga neni 213 i këtij ligji do të mbajë llogari për:

- 1) natyrën, peshën, vëllimin dhe kohëzgjatjen e shkeljes;
- 2) aktivitetet që i ka ndërmarrë tregtari për të ulur ose mënjanuar dëmin që e kanë pësuar konsumatorët;
- 3) shkeljet paraprake të dispozitave të neneve 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86 të këtij ligji, që i ka bërë tregtari;
- 4) dobia materiale që e ka përvetësuar ose humbjet që i ka shmangur tregtari për shkak të shkeljes së bërë, nëse për këtë ekzistojnë të dhëna përkatëse;
- 5) gjobat që i janë shqiptuar tregtarit për shkeljen e njëjtë në vend anëtar të Bashkimit Europian në rastet ndërkufitare kur për këtë ekzistojnë të dhëna përmes mekanizmit për bashkëpunim të organeve kompetente shtetërore për zbatimin e mbrojtjes së konsumatorit dhe
- 6) çfarëdo rrethana tjera lehtësuese ose vështirësuese të zbatueshme për rastin.

Kundërvajtjet dhe gjobat

Neni 215

(1) Gjoha në shumën përkatëse të përcaktuar në paragrafët (2), (3), (4), (5), (6), (7), (8), (9) dhe (10) të këtij ligji do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- 1) nuk i respekton detyrimet e përgjithshme në marrëdhëniet konsumatore në përputhje me dispozitat e nenit 6 paragrafi (2), nenit 7, nenit 8 paragrafët (4), (5) dhe (7) dhe nenet 9 dhe 10 të këtij ligji;
- 2) shënon çmimet në kundërshtim me dispozitat e neneve 11, 12, 13, 14, 15, 16 dhe 17 të këtij ligji;
- 3) nuk i respekton detyrimet gjatë nxitjeve së shitjes në përputhje me dispozitat e neneve 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27 dhe 28 të këtij ligji;
- 4) nuk i respekton detyrimet në ofertat e përbashkëta të mallrave ose shërbimeve në përputhje me dispozitat e neneve 29 dhe 30 të këtij ligji;
- 5) nuk i përmbush detyrimet gjatë pagesës në përputhje me dispozitat e neneve 31, 32, 33, 34, 35 dhe 36 të këtij ligji;
- 6) nuk i respekton detyrimet me rastin e dorëzimit të dokumenteve dhe obligimeve tjera përkatëse në përputhje me dispozitat e neneve 37, 38 dhe 39 të këtij ligji;

7) nuk i respekton detyrimet lidhur me përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar nga produkti me defekt në përputhje me dispozitat e neneve 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47 dhe 48 të këtij ligji;

8) nuk i respekton detyrimet e përgjithshme lidhur me detyrimet për informimin e konsumatorëve për shërbimet në përputhje me dispozitat e nenit 50 të këtij ligji;

9) nuk i respekton detyrimet gjatë ofrimit të shërbimeve publike në përputhje me dispozitat e neneve 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64 dhe 66 të këtij ligji;

10) ushtron veprime të praktikës së padrejta tregtare në kundërshtim me dispozitat e neneve 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77 dhe 78 të këtij ligji;

11) përdor dispozita të padrejta kontraktual në përputhje me dispozitat e neneve 79, 80, 81, 82, 83, 84, 85 dhe 86 të këtij ligji;

12) lidhë kontrata për shitje ose kontrata për shërbime në kundërshtim me dispozitat e neneve 87, 88, 89, 90, 91, 92 dhe 93 të këtij ligji;

13) nuk respekton detyrimet në lidhje me kontratat e shitjes në përputhje me dispozitat e neneve 94, 95, 96, 97, 98, 99, 100, 101, 102, 103, 104, 105, 106, 107, 108, 110, 111, 112, 113, 114, 115, 116, 117 dhe 118 të këtij ligji;

14) te kontratat në distancë ose kontratat jashtë hapësirave afariste të tregtarit, vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve 119, 120, 121, 122, 123, 124, 125, 126, 127, 128, 129, 131, 130, 132 dhe 133 të këtij ligji;

15) në rastin e kontratave për përdorimin në pjesë në aspektin kohor të paluajtshmërisë, për produkt afatgjatë për pushim, për rishitje ose shkëmbim, vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve 134, 135, 136, 137, 138, 139, 140, 141, 142, 143, 144, 145, 146, 147 dhe 148 të këtij ligji;

16) në kontratat për furnizim me përmbajtje digjitale dhe shërbime digjitale vepron në kundërshtim me dispozitat e neneve 149, 150, 151, 152, 153, 154, 155, 156, 157, 158, 159, 160, 161, 161, 161, 164, 165, 166, 167, 168 dhe 169 të këtij ligji dhe

17) nuk i respekton detyrimet lidhur me kundërshtimet konsumatore në përputhje me dispozitat e neneve 189, 190, 191, 192, 193, 194, 195, 196 dhe 197 të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit juridik mikrotregtar për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 2.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit juridik tregtar i vogël për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Gjobë në shumë prej 2.000 deri në 5.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit juridik tregtar i mesëm për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(5) Gjobë në shumë prej 5.000 deri në 10.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet personit juridik tregtar i madh për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(6) Gjobë në shumë prej 150 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet Përgjegjësit në personin juridik që është mikrotregtar për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(7) Gjobë në shumë prej 250 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet Përgjegjësit në personin juridik që është tregtar i vogël për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(8) Gjobë në shumë prej 350 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet Përgjegjësit në personin juridik që është tregtar i mesëm për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(9) Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet Përgjegjësit në personin juridik që është tregtar i madh për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(10) Gjobë në shumë prej 50 euro në kundërvlerë në denarë do t'i shqiptohet personit fizik, përkatësisht tregtarit individual për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Sanksionet dhe masat e veçanta kundërvajtëse

Neni 216

(1) Personat juridikë nga neni 215 paragrafët (3), (4) dhe (5) i këtij ligji për kundërvajtjet nga neni 215 paragrafi (1) i këtij ligji do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim i përkohshëm për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar në kohëzgjatje prej tre muajve deri në dy vjet, nga gjykata kompetente.

(2) Personat juridikë nga neni 215 paragrafi (2) i këtij ligji për kundërvajtjet nga neni 215 paragrafi (1) i këtij ligji do t'i shqiptohet edhe sanksioni kundërvajtës ndalim i përkohshëm për ushtrimin e veprimtarisë së caktuar në kohëzgjatje prej 15 deri 30 ditë, nga Komisioni i Vendimmarrjes ndaj Kundërvajtjes.

(3) Përgjegjësit në personin juridik nga neni 215 paragrafët (7), (8) dhe (9) të këtij ligji për kundërvajtjet nga neni 215 paragrafi (1) i këtij ligji do t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej tre muajve deri në një vit, nga gjykata kompetente.

(4) Përgjegjësit në personin juridik nga neni 215 paragrafi (6) i këtij ligji dhe personit fizik, përkatësisht tregtarit-individ nga neni 215 paragrafi (10) i këtij ligji për kundërvajtjet nga neni 215 paragrafi (1) i këtij ligji do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej 15 deri në 30 ditë të Komisionit të Vendimmarrjes ndaj Kundërvajtjes.

(5) Për kundërvajtjet nga neni 215 paragrafi (1) i këtij ligji, personit juridik, personit fizik, përkatësisht tregtarit-individ do t'i shqiptohet edhe masë e veçantë e konfiskimit të sendeve.

Procedura për lëshimin e fletëpagesës për kundërvajtje

Neni 217

(1) Për kundërvajtjet nga neni 215 paragrafi (1) i këtij ligji, inspektori do të zbatojë procedurë për lëshimin e fletëpagesës për kundërvajtje, në përputhje me Ligjin e Kundërvajtjes.

(2) Inspektorati Shtetëror i Tregut mban evidencë për fletëpagesat e lëshuara për kundërvajtje dhe për epilogun e procedurës për lëshimin e fletëpagesës për kundërvajtje, në përputhje me Ligjin e Kundërvajtjes.

(3) Formën dhe përmbajtjen e fletëpagesës për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni, i përcakton ministri i Ekonomisë.

Zbatimi përkatës i Ligjit të Kundërvajtjeve

Neni 218

Në raport me matjen e sanksioneve për kundërvajtje dhe çështjeve tjera që nuk janë përfshirë me dispozitat e këtij ligji, në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e Ligjit të Kundërvajtjeve.

Pjesa e gjashtë

DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Afatet për miratimin e rregullave

Neni 219

(1) Rregullat nënligjore të përcaktuara me këtë ligj duhet të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të rregullave nënligjore nga paragrafi (1) i këtij neni, do të zbatohen rregullat që kanë qenë të vlefshme deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Zbatimi kohor

Neni 220

(1) Dispozitat e këtij ligji nuk do të zbatohen për marrëdhëniet konsumatore që janë krijuar para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Dispozitat e këtij ligji për përgjegjësinë për produktin me defekt nuk do të zbatohen për produktet e vendosura në treg deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Vazhdimi i punës së Këshillit të Mbrojtjes së Konsumatorit

Neni 221

Këshilli i Mbrojtjes së Konsumatorëve i formuar në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së Konsumatorëve (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 38/2004, 77/2007, 103/2008, 24/11, 164/13, 97/15, 152 /15 dhe 140/18) do të vazhdojë të punojë në përputhje me dispozitat e këtij ligji deri në skadimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit.

Zbatimi i vonuar i dispozitave për menaxhim elektronik, shërbime elektronike, dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe shërbime konfidenciale

Neni 222

Dispozitat e nenit 180 paragrafët (2), (4) dhe (5) të këtij ligji, nenit 181 paragrafët (4), (7) dhe (8) të këtij ligji, neni 182 paragrafët (6), (9) dhe (9) dhe (10) të këtij ligji dhe nenit 211, paragrafët (8), (11) dhe (12) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen një vit nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Zbatim i prolonguar i dispozitave për aktivitete shitesë për sigurimin e cilësisë së shërbimeve, për Listën e përbashkët të trupave të autorizuarra për mbrojtjen e interesave dhe të drejtave kolektive të konsumatorëve të Bashkimit Europian dhe për shkeljet ndërkufitare

Neni 223

Dispozitat e nenit 51 paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji, neni 183 i këtij ligji, neni 203 i këtij ligji dhe neni 214 pika 5) i këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga Dita e anëtarësimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.

Ndërprerja e dispozitave për menaxhimin elektronik, shërbimet elektronike, dokumentet elektronike, identifikimin elektronik dhe shërbimet konfidenciale

Neni 224

Dispozitat e nenit 180 paragrafët (2), (4) dhe (5) të këtij ligji, nenit 181 paragrafët (4), (7) dhe (8) të këtij ligji, neni 182 paragrafët (6), (9) dhe (9) dhe (10) të këtij ligji dhe nenit 211, paragrafët (8), (11) dhe (12) të këtij ligji pushojnë të vlejnjë me aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian.

Pushimi i vlefshmërisë së Ligjit

Neni 225

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji pushon të vlejë Ligji i Mbrojtjes së Konsumatorëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/04, 77/07, 103/08, 24/11, 164/13, 97/15, 152/15 dhe 140/18).

Hyrja në fuqi

Neni 226

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".